

SQ

SQ

SQ

**KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR
PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN**

Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2010-2011

{SEC(2010) 1326}
{SEC(2010) 1327}
{SEC(2010) 1328}
{SEC(2010) 1329}
{SEC(2010) 1330}
{SEC(2010) 1331}
{SEC(2010) 1332}
{SEC(2010) 1334}
{SEC(2010) 1335}

KOMUNIKATË NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE KËSHILLIN EVROPIAN

Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2010-2011

1. HYRJE

Procesi i zgjerimit të BE-së ka fituar vrull të ri që nga koha kur Komisioni miratoi raportet e fundit të progresit, pavarësisht nga shumë sfida të tjera, me të cilat përballlet Bashkimi Evropian. Hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës siguron që BE-ja mund të ndjekë agjendën e saj të zgjerimit, përderisa ruan ritmin e integritimit Evropian.

Negociatat me Kroacinë kanë hyrë në fazën e tyre përfundimtare, duke iu demonstruar të gjitha vendeve të zgjerimit, që pranimi mund të bëhet realitet, me kusht që janë plotësuar kushtet e nevojshme. Serbia ka aplikuar për anëtarësim. Komisioni sot lëshon opinionet e veta mbi aplikimet nga Mali i Zi dhe Shqipëria. Islanda ka filluar negociatat e pranimit në korrik. Kapituj të rinj janë hapur në negociatat me Turqinë dhe ky vend i ka hyrë një rishikimi të plotë të kushtetutës së saj, duke lëvizur më afër standardeve Evropiane. Liberalizimi i vizave për Ballkanin Perëndimor ka përparuar. Nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme në dallimet e vjetra bilaterale në mes të Sllovenisë dhe Kroacisë dhe një dialog në mes të Serbisë dhe Kosovës¹ është në përgatitje e sipër. Pajtimi pas konfliktit ndërmjet popujve ka përparuar dhe vetë vendet kanë filluar të marrin përgjegjësi më të madhe për bashkëpunim rajonal.

Megjithatë, shumë sfida vazhdojnë të mbesin. Në disa vende të zgjerimit vrulli i reformave është ngadalësuar. Të gjithë duhet të përqendrohen në qeverisjen e mirë, përmirësimin e sundimit të ligjit, përshpejtimin e reformave ekonomike dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të miratuar dhe të zbatuar *acquis*. Mbështetja e lirisë së shprehjes është një shqetësim në shumicën e vendeve. Disa probleme komplekse mbeten për t'u zgjidhur, duke përfshirë qeverisjen e Bosnjë-Hercegovinës dhe çështjen e emrit lidhur me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kanë mbetur çështje të hapura dypalëshe, si dhe dallimet lidhur me statusin e Kosovës kanë vonuar bashkëpunimin rajonal. Sa i përket çështjes së Qipros, negociatat mbi një marrëveshje të plotë kanë përparuar, por ende nuk janë përfunduar.

Përkushtimi i BE-së në procesin e zgjerimit reflekton bindjen e Shteteve Anëtare se ai është në interes të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe vendeve candidate. Ky mesazh i drejtpërdrejtë duhet të paraqitet dhe shpjegohet qartë për publikun në mënyrë që të forcojë mirëkuptimin dhe përkrahjen për zgjerimin. Procesi i zgjerimit të BE-së kontribuon në stabilitetin në Evropë dhe në sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Ai ofron nxitje të veçantë për reforma politike dhe ekonomike në vendet e zgjerimit. Është në interes të përbashkët të vendeve të BE-së dhe atyre në zgjerim për të hapur diskutime mbi kapitujt e vështirë të bisedimeve në fillim të procesit. Ky proces ka për qëllim t'i ngritë vendet e zgjerimit në nivel të standardeve evropiane në të gjitha fushat që mbulohen nga traktatet e BE-së dhe në këtë mënyrë të ndihmojë BE-në për të arritur objektivat e saj. Këto objektiva tani përfshijnë përballjen me krizën ekonomike dhe të qeverisjes, rivendosjen e rritjes së vendeve të punës përmes Agjendës së reformës së vitit 2020, duke e bërë BE-në një vend më të sigurt dhe duke pozicionuar peshën tonë në skenën botërore. Programi i Punës së Komisionit për vitin 2011 përfshinë një sërë iniciativash duke pasur parasysh këto synime.

Zgjerimi duhet të mbetet i besueshëm për të gjithë ata që janë të përfshirë. Vendet candidate dhe

¹ Nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99.

qytetarët e tyre kanë nevojë për një perspektivë të qartë të pranimit pasi të jenë plotësuar kushtet, dhe duhet të shohin përfitime të prekshme gjatë rrugës. Shtetet Anëtare dhe opinioni publik i BE-së, duhet të jetë i sigurt që pranimet e reja janë të përgatitura mirë përmes kushtëzimeve të rrepta. Arritja e një suksesi të zgjerimit kërkon angazhim politik të vendosur të të gjitha palëve të interesuara. Konsensusi i ripërtërirë për zgjerimin, i miratuar nga Këshilli Evropian në dhjetor të vitit 2006, mbetet korniza për arritjen e këtyre objektivave. Kjo politikë është e bazuar në parimet e konsolidimit të angazhimeve, kushtëzimin e drejtë dhe rigoroz dhe komunikimin e mirë me publikun, kombinuar me kapacitetet e BE-së për të integruar anëtarë të rinj.

Procesi i zgjerimit ofron mekanizma dhe nxitje, që kulmojnë në anëtarësim, në mënyrë që vendet kandidatë të inkurajohen për të punuar së bashku me BE-në në realizimin e objektivave të përbashkëta. Përderisa qeverisja ekonomike në kuadër të BE-së është përforcuar, dialogu ekonomik me vendet e zgjerimit do të intensifikohet, duke bërë të mundur që ne, së bashku, të përqendrohemi për vënien e krizës pas nesh dhe krijimin e vendeve të punës. Aftësia konkurruese e përgjithshme e BE-së përfiton nga integrimi më i afërt me vendet që kanë një numër të avantazheve krahasuese. Ky është njëri ndër përfitimet e qëndrueshme të zgjerimit të pestë, i cili solli BE-në nga 15 në 27 Shtete Anëtare në mes të viteve 2004 dhe 2007. Tregtia ndërmjet Shteteve Anëtare 'të vjetra' dhe 'të reja' është trefishuar prej rreth 150 miliardë € në 450 miliardë € gjatë dekadës gjer në vitin 2008. Procesi i zgjerimit ka siguruar mjetet financiare që BE-ja të ndërhyjë, së bashku me institucionet financiare ndërkombëtare, për ruajtjen e stabilitetit ekonomik në kohëra të krizave kur është e nevojshme. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat gjenerojnë dy nga tri vende pune të sektorit privat në BE, paraqesin një nxitës të madh për risi, ato përfitojnë nga një treg i brendshëm i zgjeruar dhe përbëjnë një përqendrim të rëndësishëm të ndihmës para pranimit.

Integrimi më i ngushtë përmes procesit të zgjerimit të BE-së ndihmon për të arritur objektivat e saj në një sërë fushash të cilat janë kyçe për rimëkëmbje ekonomike dhe rritje të qëndrueshme, duke përfshirë energjinë, transportin, mbrojtjen e mjedisit dhe përpjekjet për ndryshimin e klimës. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë tërësisht të rrethuara nga Shtetet Anëtare. Turqia është fqinje e Bashkimit Evropian si në tokë ashtu edhe në det. Ndërtimi i korridoreve trans-Evropiane të transportit, diversifikimi i burimeve të energjisë, zbutja dhe përshtatja me ndryshimet klimatike dhe reduktimi i ndotjes ndërkufitare të ajrit dhe ujit janë ndër qëllimet e BE-së, arritja e të cilave kërkon angazhimin e plotë të vendeve të zgjerimit.

Ato gjithashtu përfitojnë nga përparimi në fusha të tilla, perspektiva e pranimit atyre iu jep nxitje për t'i dhënë prioritet qëllimeve të përbashkëta me BE-në. Grante nga Instrumenti i Para-Anëtarësimin (IPA) dhe kreditë nga Banka Evropiane për Investime dhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare, të cilat IPA-ja ndihmon për t'i ngritur, për të siguruar mjetet praktike të mbështetjes. Kandidati më i fundit i cili ka filluar negociatat e pranimit, Islanda, është një udhëheqës botëror në forma të ndryshme të energjisë së ripërtëritëse dhe ka shumë për të kontribuar në përpjekjet novatore të BE-së në këtë dhe fusha të tjera të përparuara.

Shndërrimi i Evropës në një vend më të sigurt është çështje që gjendet lartë në agjendën e BE-së të përcaktuar në Programin e Stokholmit. Nga vendet e zgjerimit kërkohet të marrin përsipër *acquis* të Bashkimit Evropian dhe të demonstrojnë aftësitë e tyre për t'i zbatuar ato plotësisht. Për këtë arsye, Komisioni ka shtuar përpjekjet për të mbështetur vendet e zgjerimit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin dhe për të forcuar aftësitë e tyre për zbatimin e ligjit. Prokurorët, gjyqtarët dhe ekspertët tjerë të BE-së në fushën e zbatimit të ligjit, menaxhimit të kufijve dhe migrimit tani ndihmojnë homologët e tyre nga vendet e zgjerimit duke dhënë ekspertizën e tyre dhe duke vërtetuar përparimin. Përmbushja e standardeve, gjë që përcakton ritmin në të cilën një vend kandidat përparon drejt anëtarësimin në BE në negociatat e pranimit, kërkon një prapavijë bindëse në administrimin e drejtësisë në mënyrë të pavarur dhe efikase.

Përvoja e liberalizimit të vizave për Ballkanin Perëndimor tregon se sa shumë mund të arrihet duke kombinuar kushtëzimin rigoroz me dhënien e përfitimeve të veçanta të ndërlidhura me përparimin drejt anëtarësimit në BE. Ajo gjithashtu thekson rëndësinë e përpjekjeve të vazhdueshme nga qeveritë përkatëse për të siguruar që kufijtë dhe kushtet e bashkangjitura me lëvizjen më të lirë të personave respektohen.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, BE-ja i ka dhënë vetës mjetet për të zënë vendin e vet në skenën globale. Roli i BE-së në miratimin e Rezolutës së Përgjithshme të OKB-së për Kosovën është një shembull i këtij potenciali. Në një botë ku kompetencat e reja janë duke luajtur një rol vazhdimisht më të madh, zgjerimi i jep peshë më të madhe BE-së dhe forcon zërin e saj në forumet ndërkombëtare. Zgjerimi i pestë i dha një nxitje të re marrëdhënieve të BE-së me fqinjët e saj lindorë dhe jugorë dhe e nxiti atë për të shqyrtuar metoda të zhvillimit të iniciativave në rajonet e detit Baltik dhe detit të Zi. Procesi i pranimit për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe i Turqisë i jep BE-së një interes dhe ndikim akoma më të madh në rajonet e detit Mesdhe dhe të Zi si dhe në pellgun e Danubit. Me kusht që roli i Turqisë në rajonin e vet zhvillohet si një plotësues për procesin e saj të pranimit dhe në koordinim me BE-në, kjo mund të forcojë peshën e të dyja palëve në çështje botërore gjithashtu edhe në Lindjen e Mesme dhe Kaukazin Jugor. Duke vepruar së bashku, BE-ja dhe Turqia mund të përforcojnë sigurinë e energjisë, të adresojnë konflikte rajonale, dhe të parandalojnë zhvillimin e ndasive në baza etnike apo fetare. Islanda dhe BE-ja së bashku mund të luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e energjisë, mjedisit detar, si dhe çështjeve të sigurisë në detin Arktik. Për të qenë të sigurt, potenciali i plotë i sinergjive të tilla mund të realizohet vetëm përmes angazhimit të përbashkët për një strategji të besueshme të zgjerimit.

Pesha e BE-së në botë në një masë të konsiderueshme varet nga atraktiviteti i modelit të saj rregullues. Vitaliteti i tregut të brendshëm dhe miratimi i normave dhe standardeve të BE-së nga vende të botës paraqesin një nxitës të madh për tregtinë, investimet dhe rritjen ekonomike. Akti i tregut unik i paraqitur nga Komisioni synon për të hequr shumë pengesa dhe për të liruuar potencialin e ri të rritjes. Nëpërmjet procesit të zgjerimit, vendet kandidatë do të miratojnë në mënyrë progresive *acquis*, duke zgjeruar zonën në të cilën një grup i vetëm i standardeve zbatohet. Kjo duhet të nxisë investime të reja, inovacion dhe kohezion social si dhe të forcojë atraktivitetin e modelit rregullator të BE-së në vendet fqinje dhe në sistemin më të gjerë ndërkombëtar.

Shumë gjëra janë në pyetje në procesin e zgjerimit si për BE-në ashtu edhe për vendet kandidatë. Në të njëjtën kohë perceptimet publike mbi rëndësinë e këtij programi ndikohen nga shqetësimet e përditshme që shpesh mund të duken çështje më të ngutshme. Pakoja e raporteve të këtij viti, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet shoqëruese tregojnë që procesi i zgjerimit është pjesë e zgjidhjes për shumë nga shqetësimet e qytetarëve tanë, qoftë në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit apo në krijimin e rritjes dhe vendeve të punës. Institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare të saj duhet të punojnë krah për krah për të forcuar mirëkuptimin dhe ofruar mbështetje për procesin e zgjerimit dhe për të shpjeguar se si mund të na ndihmojnë për të arritur objektivat tona të përbashkëta. Duke arritur suksese të mtejshme të zgjerimit, BE-ja do të jetë në pozitë më të mirë të adresojë sfida tjera të shumta me të cilat ajo përballlet.

2. SFIDAT KYÇE

2.1. Tejkalimi i krizës ekonomike

Kriza ekonomike ka prekur të gjitha vendet e zgjerimit. Ndikimi i saj, megjithatë ka qenë i ndryshëm në varësi të strukturës ekonomike të çdo vendi. Shqipëria, Kosova dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë janë prekur më pak, pasi ato varen më pak nga eksportet dhe tregjet e tyre vendase janë mbajtur mirë. Kroacia, Serbia dhe Turqia, të cilat janë më të integruara në tregun global janë goditur

rëndë. Mali i Zi u godit rëndë për shkak të vartësisë nga financimi i jashtëm dhe një numër i kufizuar i sektorëve. Në Bosnjë dhe Hercegovinë ndikimi i krizës është përkeqësuar për shkak të politikave fiskale pro-ciklike me një përqindje të lartë të subvencioneve dhe transfereve sociale në buxhet.

Në vitin 2010, ka shenja modeste të rimëkëmbjes në Ballkanin Perëndimor. Kërkesa e brendshme është ende e dobët, duke reflektuar kushtet e shtrënguara të kreditimit dhe papunësinë e vazhdueshme. Rikuperimi me një normë të fuqishme të rritjes është në rrugë të mirë në Turqi, e cila ka përfituar nga konsolidimi fiskal dhe ristrukturimi i sektorit të saj bankar në fillim të dekadës. Islanda është ende duke vuajtur nga ndikimet e krizës financiare dhe kolapsi i sistemit të saj bankar.

Financat publike mbeten nën presion në disa vende. Pavarësisht nga borxhi mesatar publik relativisht i ulët, zgjerimi fiskal në periudhën e ekspansionit ka ngritur ndjeshmërinë dhe ekspozimin e vendeve të zgjerimit ndaj krizës globale financiare, me përjashtim të Turqisë. Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor nuk kanë pasur margjinë për manovrim fiskal dhe kapacitete të nevojshme për të prioritetizuar shpenzimet publike për stimulime fiskale si përgjigje ndaj krizës. Masat shtrënguese fiskale, përfshirë rebalancimin e buxhetit janë zbatuar në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, kjo nuk ka qenë e mjaftueshme për të parandaluar zgjerimin e deficiteve fiskale. Islanda, Serbia, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina kanë shfrytëzuar mbështetjen nga FMN-ja.

BE-ja, së bashku me institucionet financiare ndërkombëtare, ka ndihmuar lehtësimin e ndikimit të krizës. Asistenca IPA është riprogramuar për të mbështetur investimet në infrastrukturë dhe konkurrencë. Mbështetja buxhetore dhe asistenca makro-financiare u janë vënë në dispozicion disa vendeve. Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor luan një rol të rëndësishëm në mobilizimin e fondeve për projektet e mëdha të infrastrukturës (*shih pjesën 3 më poshtë*).

Arritja e normave të qëndrueshme të rritjes dhe konvergencës reale do të kërkojë reforma strukturore të mëtejme si dhe politika të matura fiskale. Burimet e brendshme të zhvillimit duhet të jenë më të efektshme në mënyrë që shfrytëzohen për të përmirësuar kapacitetin prodhues, krijimin e vendeve të punës dhe konkurrencën. Vëllime më të larta të investimeve vendase dhe të huaja janë të nevojshme tani në projektet Greenfield, veçanërisht në aktivitetet e orientuara nga eksporti. Kjo do të kontribuojë në rritjen e prodhimit dhe produktivitetit, gjë që shpie drejt punësimit më të lartë dhe ekuilibrimit më të qëndrueshëm tregtar. Kjo gjithashtu do të ndihmojë në trajtimin e problemeve të ngutshme sociale të rajonit.

Për të rritur investimet e huaja dhe vendore qeveritë duhet të përmirësojnë mjedisin biznesor. Kjo nënkupton rritje të efikasitetit të administratës publike dhe pavarësi të gjyqësorit, heqje të pengesave formale të tregtisë dhe forcimin e sundimit të ligjit. Një treg funksional rajonal në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe vazhdimi i shtrirjes së *acquis* janë me rëndësi për të tërhequr investime. Liberalizimi i planifikuar i tregtisë për produktet dhe shërbimet bujqësore në tërë rajonin dhe hapja e tregjeve të prokurimit publik do të rrisë edhe më tepër potencialin e rajonit për rritje.

Sigurimi i financave publike të shëndosha dhe të qëndrueshme është vendimtar për vendet e zgjerimit. Kjo është gjithashtu një çështje kyçe në përgatitjen për anëtarësim në BE. Përvoja e fundit ka treguar ndërvarësinë e ekonomisë evropiane dhe potencialin destabilizues nga pabarazitë e mëdha edhe në ekonominë e vogla.

Komisioni do të vazhdojë të përdorë në mënyrë të plotë instrumentet e para-anëtarësimit dhe mbikëqyrjes ekonomike për të monitoruar ecurinë ekonomike dhe fiskale të vendeve të zgjerimit. BE-ja zhvillon një dialog të rregullt me vendet kandidatë, duke i njoftuar me sistemin e koordinimit të politikave ekonomike dhe mbikëqyrjes brenda BE-së. Një proces i ngjashëm është krijuar edhe me

kandidatë të mundshëm. Janë gjithashtu duke u përdorur dialogje ekonomike ndërmjet Komisionit dhe vendeve të zgjerimit për mbikëqyrjen e politikave sipas Procesit të Asociimit ekonomik.

Aktualisht, janë marrë hapa për të përmirësuar qeverisjen ekonomike brenda BE-së. Pasi të definohet dhe formalizohet në mënyrë të plotë kjo reformë makroekonomike, buxhetore dhe strukturore, Komisioni do të shqyrtojë se si disa prej dispozitave të saj mund të shtrihen në vendet e zgjerimit.

Përveç dialogut dhe mbikëqyrjes, BE-ja në mënyrë aktive mbështet përpjekjet e vendeve të zgjerimit drejt rimëkëmbjes ekonomike, stabilizimit makroekonomik dhe konsolidimit fiskal. Një asistencë e konsiderueshme e IPA-së është synuar në përmirësimin e menaxhimit të financave publike, rritjen e cilësisë së statistikave dhe forcimin e sektorit të mbikëqyrjes bankare.

Procesi i zgjerimit kontribuon në objektivat e strategjisë Evropa 2020 duke zgjeruar zonën e kornizës rregulluese të BE-së dhe krijuar mundësi të reja tregtare. Komisioni mirëpret dëshirën e shumë vendeve të zgjerimit për të reflektuar strategjinë Evropa 2020 në prioritetet e reformave të tyre kombëtare. Komisioni do të ndërlihdë vendet e zgjerimit me iniciativat e ndërmarra në nivel të BE-së për të përmbushur objektivat e rritjes së menduar mirë, të qëndrueshme dhe përfshirëse, duke rezultuar në nivele të larta të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit shoqëror. Në fushën e arsimit, Komisioni do të shqyrtojë mundësitë për të përfshirë të gjitha vendet e zgjerimit në kornizën "Arsimimi dhe Trajnimi 2020" si dhe për t'i përfshirë në Aktivitetet e mësimin nga homologët.²

Vendet e zgjerimit kanë filluar të marrin iniciativa në grupet rajonale, ku ata mund të vlerësojnë progresin së bashku dhe të vendosin objektiva specifike për rajonin. Akti për bizneset e vogla në Evropë, që paraqet një sërë masash për të përmirësuar mjedisin e biznesit për NVM-të, është një shembull i një iniciative të tillë. Komisioni do t'i propozojë Këshillit për Bashkëpunim Rajonal që të krijojë platforma për dialog dhe vlerësim nga kolegët në fusha tjera në përputhje me prioritetet e Evropës 2020. Me rastin e programimit të asistencës IPA, Komisioni do të marrë në konsideratë prioritetet e strategjisë së Evropës 2020.

2.2. Përfshirja sociale

Kriza ekonomike ka pasur ndikim negativ në mirëqenien sociale në vendet e zgjerimit. Grupet e cenueshme, duke përfshirë edhe pakicat, komunitetet e pafavorizuara dhe njerëzit me aftësi të kufizuara janë prekur në veçanti. Nivelet e larta të papunësisë, sidomos papunësia e të rinjve, normat e ulëta të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe varfëria janë përhapur në gjithë rajonin. Romët përbëjnë një pakicë veçanërisht të pambrojtur, ata janë të prekur nga diskriminimi, varfëria dhe veçimi gjatë qasjes në arsim, punësim, strehim dhe shërbime sociale, duke përfshirë kujdesin shëndetësor. Një numër i madh i romëve ende kanë mungesë të regjistrimit civil ose dokumenteve personale. Shumë prej tyre ende jetojnë në kampe si Persona të zhvendosur brenda vendit si pasojë e luftërave të fundit.

Komisioni është i angazhuar për të ndihmuar vendet e zgjerimit për të përmirësuar kushtet për grupet e cenueshme, duke përfshirë edhe përfshirjen sociale dhe ekonomike të romëve. Komisioni siguron mbështetje substanciale IPA për grupet e pambrojtura përmes arsimimit dhe fuqizimit të shërbimeve sociale dhe të punësimit me qëllim për të integruar në tregun e punës njerëzit që janë në disavantazh. Ajo gjithashtu financon përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet e romëve. Kjo mbështetje do të përforcohet me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës në shumicën e këtyre vendeve, duke i ndihmuar ato për të zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse për problemet e përfshirjes sociale. Në rastin e Kroacisë, tanimë është përfunduar një Memorandum mbi përfshirjen e përbashkët, duke siguruar një kuadër politik në këtë fushë. Vendet e zgjerimit kanë marrë disa masa për të trajtuar sfidat e përshkruara

² Kroacia, Turqia dhe Islanda tanimë marrin pjesë në kornizën "Arsimimi dhe Trajnimi 2020".

më lart, por ka nevojë për t'u bërë më tepër. Komisioni i inkurajon ata që të punojnë drejt uljes së varfërisë dhe përjashtimit social në përputhje me prioritetet e strategjisë Evropa 2020, dhe të shfrytëzojnë më mirë mundësitë e ofruara nga Dekada e përfshirjes së Romëve. Vendet e zgjerimit duhet të marrin parasysh caktimin e objektivave të qarta dhe ambicioze në arsim, punësim dhe zvogëlim të varfërisë së komuniteteve në nevojë, në veçanti për romët.

2.3. Forcimi i sundimit të ligjit dhe administratës publike

Forcimi i sundimit të ligjit, në veçanti gjyqësorit dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është një sfidë thelbësore për shumicën e vendeve në procesin e zgjerimit. Rezultatet e prekshme, sjellja e përmirësimeve të qëndrueshme ndaj sundimit të ligjit, janë një element i rëndësishëm për lëvizjen drejt fazave të ardhme të procesit të pranimit në BE.

Koncensusi i ripërtërirë për zgjerimin mbi të cilin është rënë dakord në vitin 2006, bën thirrje që çështjet që lidhen me sundimin e ligjit të adresohen në një fazë të hershme të procesit të pranimit. Komisioni i ka dhënë prioritet të lartë trajtimit të këtyre çështjeve duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion. Përdorimi i standardeve në negociatat e pranimit shërben si një katalizator i rëndësishëm për reformat dhe jep një mesazh të qartë që sundimi i ligjit duhet të trajtohet seriozisht para pranimit. Liberalizimi i vizave ka shfaqur efikasitetin e një qasjeje e cila ka përcaktuar kërkesa specifike për reforma duke lejuar që vendet të përqendrohen më mirë në përpjekjet e tyre. Vlerësimi i homologëve dhe misionet e tjera janë intensifikuar, duke sjellë gjyqtarë, prokurorë dhe ekspertë të tjerë në zbatimin e ligjit, menaxhimin e kufijve dhe migrimin nga Shtetet Anëtare në kontakt të drejtpërdrejtë me homologët e tyre. Bashkëpunimi intensiv gjyqësor dhe policor brenda rajonit me Shtetet Anëtare të BE-së si dhe me Europol Eurojust dhe Frontex, sigurojnë mjetet për të luftuar krimin trans-nacional gjatë periudhës së para-pranimit.

Duke marrë parasysh këtë përvojë, Komisioni do të rrisë dhe intensifikojë më tej punën e vet dhe dialogun mbi sundimin e ligjit me vendet candidate dhe vendet që janë candidate të mundshme. Vendet duhet të punojnë për arritjen e rezultateve konkrete dhe të qëndrueshme si dhe për të themeluar një prapavijë bindëse dhe të besueshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe reformën e gjyqësorit. Arritja e një kornize të qëndrueshme ligjore dhe zbatimi i saj është çështje kyçe. Përdorimi i misioneve të homologëve dhe krahasimit do të vazhdojë. Opinionet e Komisionit mbi aplikimet për anëtarësim nga Mali i Zi dhe Shqipëria kanë përcaktuar prioritetet në fushën e sundimit të ligjit.

Komisioni është duke monitoruar në mënyrë të afërt progresin, në veçanti përmes organeve të përbashkëta sipas Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit ose Marrëveshjeve të Përkohshme si dhe misionet e vlerësimit. Rezultatet e këtij dialogu janë pasqyruar në Raportin e Progresit. Asistenca IPA ka një përqendrim kyç në sundimin e ligjit. TAIEX organizon më shumë se 100 trajnime në vit të ndërlidhura me sundimin e ligjit për vendet në zgjerim.

Ka pasur zhvillime pozitive kohëve të fundit në bashkëpunimin gjyqësor në disa vende të Ballkanit Perëndimor. Marrëveshje të reja dypalëshe për bashkëpunimin policor, sidomos në mes të Serbisë dhe Shqipërisë, për ndihmën e ndërsjellë ligjore dhe zbatimin e përbashkët të dënimeve në çështjet penale kanë përfunduar. Kroacia dhe Serbia kanë shkuar edhe më tej duke nënshkruar një marrëveshje që iu bën të mundur atyre të ekstradojnë shtetasit e tyre ndërmjet njëri-tjetrit për procedurë penale ose ekzekutim të dënimeve me burgim në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Komisioni inkurajon vendet e tjera në rajon që të ndjekin këtë shembull. Bashkëpunimi gjyqësor do të përmirësohet më tej duke zgjeruar mundësinë për të ekstraduar shtetasit në të gjitha rastet e krimeve të rënda, duke përfshirë rastet e krimeve të luftës. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal bën përpjekje për të rritur bashkëpunimin në mes të policisë, shërbimeve të prokurorisë dhe gjyqësorit.

Një shërbim profesional dhe jo i politizuar civil është thelbësor për sundimin e ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes. Reforma në administratën publike është një përparësi në vendet e zgjerimit shumica e të cilave janë në faza të ndryshme të ndërtimit të shtetit. Në mënyrë që të jenë të qëndrueshme, reformat duhet të jenë të përfshira brenda strukturave shtetërore ekzistuese dhe duke marrë parasysh kontekstin specifik shoqëror dhe të qeverisjes. Komisioni do të vazhdojë të mbështesë reformat e qeverisjes publike në vendet e zgjerimit, në bashkëpunim të ngushtë me SIGMA³.

2.4. Liria e shprehjes dhe mediet

Liria e shprehjes dhe e medieve, e cila është pjesë përbërëse e çdo sistemi demokratik, mbetet një shqetësim i madh në vendet e zgjerimit. Në Turqi, korniza ligjore ende nuk e ka mjaft të garantuar lirinë e shprehjes. Në disa vende të Ballkanit Perëndimor vazhdojnë kërcënimet dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve. Në disa vende shpifja mbetet vepër penale ose i nënshtrohen gjobave të larta në mënyrë joproporcionale. Në disa vende është problem ndërhyrja politike në pavarësinë e medias, duke përfshirë edhe shërbimet publike të transmetimit. Pavarësia editoriale është e minuar nga presione të panevojshme politike dhe ekonomike. Këto çështje duhet të adresohen nga vendet në fjalë si çështje urgjente.

Komisioni do të monitorojë nga afër progresin në këtë fushë. Përqendrimi kryesor do të jetë në fusha të tilla siç është ajo e kornizës ligjore dhe pajtueshmëria e saj me standardet evropiane, në veçanti në lidhje me shpifjen, përgjegjësinë e autoriteteve për të sanksionuar siç duhet të gjitha rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, themelimin e organeve vetë-rregulluese dhe kontributin e tyre për të rritur profesionalizmin, rolin e transmetuesit të shërbimit publik në demokracitë pluraliste, rrjetet ndër-kufitare për përmirësimin e raportimit në të gjithë rajonin duke kontribuar për mirëkuptim më të mirë të ndërsjellë. Komisioni do të organizojë një konferencë mbi lirinë e shprehjes dhe medias në vende të zgjerimit në pranverë të vitit 2011 që do të ofrojë një mundësi për të vlerësuar progresin në këto fusha. Mbështetja e IPA-s do të ofrohet si një përforsim i konferencës, në rastet kur është e përshtatshme.

2.5. Pajtimi, bashkëpunimi rajonal dhe çështjet bilaterale në Ballkanin Perëndimor

Gjatë dekadës së fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim të konsiderueshëm drejt stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal. Megjithatë, një numër i çështjeve që dalin nga konfliktet në rajon mbeten të hapura dhe ndikojnë si funksionimin e brendshëm të shteteve ashtu edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. BE-ja është duke punuar me partitë në rajon për të kapërcyer këtë trashëgimi të së kaluarës.

Përparimi në çështjen e pajtimit është element kyç për stabilitetin në Kosovë, ku është hapur një fazë e re pas Opinionit Këshillimor nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Pas miratimit të Rezolutës së Përgjithshme të Kuvendit të OKB-së, BE-ja është e gatshme për të lehtësuar një proces të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit me qëllim të promovimit të bashkëpunimit, për të arritur progres në rrugën drejt BE-së dhe përmirësim të jetës së njerëzve. Përparimi në çështjen e pajtimit është gjithashtu thelbësor në Bosnje-Hercegovinë, gjë që ka ndikim edhe në funksionimin e shtetit. Zbatimi i plotë i marrëveshjes së Ohrit në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë, respektimi dhe mbrojtja e pakicave etnike në tërë rajonin, kthimi i refugjatëve dhe bashkëpunimi me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavi (ICTY), si dhe kryerja në mënyrë të duhur e gjykimeve të brendshme për krime lufte janë të rëndësishme për pajtim.

³ Ndihmë afat-shkurtër në fushën e çështjeve të qeverisjes horizontale dhe reformimit të administratës publike jepet përmes SIGMA-s (Përkrahja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit), një program i OBEZH-së i përkrahur nga Komisioni në kontekst të zgjerimit.

Pajtimi i qëndrueshëm kërkon përpjekje në të gjitha nivelet – të qeverisë, gjyqësorit dhe shoqërisë civile. Kjo gjithashtu është e lidhur edhe me adresimin e varfërisë dhe përjashtimin shoqëror. Kohëve të fundit ka pasur një sërë sinjalesh pozitive. Parlamenti i Serbisë miratoi një deklaratë që dënon krimin në Srebrenicë, si dhe duke iu referuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Srebrenicë. OJQ-të kanë filluar një iniciativë për krijimin e një komisioni rajonal për të vërtetën - kërkimin dhe zbulimin e së vërtetës. E ashtuquajtura iniciativa KOMRA është mbështetur nga presidentët e Kroacisë dhe Serbisë, nga parlamenti i Malit të Zi dhe komunitetet fetare. Një mbështetje më e gjerë rajonale do të kontribuonte drejt pajtimit. Samiti i Majit të vitit 2010 i Iniciativës Igman në Sarajevë u ndoq nga presidentët e Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë dhe Mal të Zi, më shumë se 140 OJQ-të janë të përfshira me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të bashkëpunimit lokal dhe rajonal. Këto përpjekje të ndryshme duhet të jenë të mbështetura nga prokuroria gjyqësore e krimeve të luftës nëpërmjet bashkëpunimit të plotë me ICTY dhe trajtimin e duhur dhe të shpejtë të rasteve të krimeve të luftës në gjykatat e vendit. Bashkëpunimi i plotë me ICTY, në veçanti nga Serbia dhe Kroacia, mbetet kyçe.

Ka pasur zhvillime pozitive në çështjen e kthimit të refugjatëve siç është iniciuar nga Procesi i Sarajevës. Një konferencë ministrore, e mbajtur në muajin mars në Beograd, ka rihapur dialogun në mes të qeverive përkatëse. Komisioni është i gatshëm të marrë në konsideratë kontribute shtesë financiare të BE-së për këtë proces dhe për të mbështetur mbajtjen e një konference të donatorëve pasi këto vende të kenë arritur marrëveshje për veprime konkrete për zgjidhjen e problemeve të mbetura. Ende janë 14.631 (bazuar në të dhënat e muajit gusht 2010) persona të zhdukur si rezultat i konflikteve të armatosura në rajon, kurse procesi i zgjidhjes së rasteve të mbetura është shumë i ngadalshëm. Vendet përkatëse duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të zgjidhur rastet e mbetura brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Bashkëpunimi rajonal kontribuon drejt pajtimit, marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe një klime të favorshme për adresimin e çështjeve të hapura dypalëshe. Në Ballkanin Perëndimor është gjithashtu e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe zgjidhjen e problemeve të përbashkëta të tilla si krimi i organizuar, menaxhimi i kufijve, ndryshimi i klimës apo ndotja e mjedisit. Bashkëpunimi rajonal është thelbësor për të arritur progres në agjendën e integritetit të BE-së në fusha të tilla si siguria e qytetarëve, energjia apo transporti.

Rajoni ka ndërmarrë hapa për të forcuar strukturat në pronësi rajonale. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR) ka një rol kyç në udhëheqjen dhe monitorimin e bashkëpunimit rajonal. KBR-ja ka miratuar një strategji ambicioze dhe programin e punës për 2011-2013 e cila tani duhet të zbatohet, me një fokus në aktivitetet e orientuara në rezultat ku KBR-ja mund shtojë vlerë reale. Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) është e domosdoshme për përfundimin e zonës rajonale të tregtisë së lirë. Komuniteti i Energjisë është duke punuar drejt një tregu rajonal të energjisë dhe për përgatitjet për integrim në tregun e BE-së për energji. Marrëveshja Evropiane e Hapësirës së Përbashkët Ajrore do të përmirësoj standardet në fushën e sigurisë, sigurimit dhe menaxhimit të trafikut ajror si dhe të shpie drejt kushteve më konkurruese për pasagjerët e trafikut ajror.

Komisioni siguron mbështetje të konsiderueshme financiare për bashkëpunim rajonal. Në vitin 2011 fondet e IPA-së do të mobilizohen për të lehtësuar pjesëmarrjen e rajonit në marrëveshje të mëdha ndërkombëtare siç janë Traktati i Transportit. Shkolla Rajonale për Administratë Publike (ReSPA) është tani plotësisht operative dhe aktualisht është duke ligjëruar rreth 2.500 ditë trajnimi në vit. Marrëveshja Ndërkombëtare për krijimin e personalitetin e vet ligjor u ratifikua në korrik 2010. Hapja zyrtare e objekteve të saj në Danilovgrad (Mali i Zi), pritet të zhvillohet më 11 nëntor 2010.

Komisioni do të vazhdojë të mbështesë rehabilitimin e trashëgimisë kulturore, në kontekstin e procesit të Lubjanës. KBR-ja do të krijojë një Grup Punues për Kulturë dhe shoqëri, i mbështetur nga një sekretariat i përhershëm që do të jetë përfutues i asistencës financiare para-pranimit të BE-së. Detyra e saj do të jetë menaxhimi i procesit të Lubjanës, në bashkëpunim me Këshillin dhe Komisionin e Evropës.

Komisioni është duke përfunduar një Strategji të Danubit, duke sjellë së bashku Shtetet Anëtare, vendet e zgjerimit dhe të partneritetit lindor. Pjesëmarrja dhe përfshirja aktive e vendeve të Ballkanit Perëndimor për ndarjen e pellgut të Danubit me fqinjët e tyre të BE-së është thelbësore për suksesin e strategjisë. Strategjia është një mundësi për investime reciprokisht të dobishme në sektorët e transportit, energjisë dhe mjedisit dhe për zhvillim socio-ekonomik.

Bashkëpunimi rajonal është përmbajtur për shkak të dallimeve rreth Kosovës. Në veçanti janë prekur çështje siç janë funksionimi i CEFTA-s, zgjerimi i sistemit Pan-Euro-Med i akumulimit diagonal dhe nënshkrimi i marrëveshjes së Komunitetit të Transportit. Në disa raste është dëshmuar të jetë e pamundur për të zhvilluar takime me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve rajonal. Komisioni inkurajon të gjitha palët e interesuara për të kërkuar zgjidhje praktike dhe pragmatike për të siguruar përfshirjen e bashkëpunimit rajonal, pa paragjykuar pozicionet e ndryshme në lidhje me statusin e Kosovës.

Slovenia dhe Kroacia nënshkruan dhe ratifikuan një Marrëveshje për arbitrazhin e kufirit e cila hap rrugën për një zgjidhje përfundimtare. Kjo marrëveshje tregon se çështjet dypalëshe mund të zgjidhen në frymën e fqinjësisë së mirë. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosovës ka përfunduar demarkacionin e kufirit të tyre. Megjithatë, një numër çështjesh tjera bilaterale, në veçanti lidhur me kufijtë, mbeten të pazgjidhura, siç është çështja e emrit midis Greqisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Çështjet e hapura dypalëshe, duke përfshirë kontestet kufitare, duhet të zgjidhen nga palët e interesuara me një frymë të fqinjësisë së mirë dhe duke marrë parasysh interesat e përgjithshme të BE-së. Ato kërkojnë një vullnet të ripërtërirë politik nga ana e palëve të interesuara. Komisioni pret që ato të bëjnë çdo përpjekje në drejtim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kufitare në përputhje me parimin e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë nëse është i nevojshme juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Çështjet dypalëshe nuk duhet të mbajnë peng procesin e pranimit. BE-ja qëndron e gatshme për të lehtësuar krijimin e nxitjes së nevojshme politike në kërkim të zgjidhjeve dhe për të mbështetur iniciativat e lidhura.

3. INSTRUMENTET E PARA PRANIMIT QË I SHËRBEJNË POLITIKËS SË ZGJERIMIT

Ndihma financiare – qasja strategjike

Asistenca financiare në kuadër të Instrumentit të Para-aderimit (IPA) është dizajnuar për të ndihmuar vendet kandidatë dhe vendet që janë kandidatë potenciale në përpjekjet e tyre për të përmbushur kriteret e pranimit lidhur me politikat dhe standardet e BE-së dhe për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik. Ndihma e tillë nëpërmjet buxhetit të BE-së jep vlerë të qartë të shtuar. Asistenca për vendet në zgjerim është një investim në të ardhmen e BE-së, duke mbështetur anëtarët e saj të ardhshëm për t'u përgatitur në mënyrë adekuate për anëtarësim, vetë BE-ja do të vendoset në pozicion më të mirë për të përmbushur qëllimet e saj strategjike. 11.6 miliardë € janë në dispozicion nga IPA për periudhën 2007-2013 për të ndihmuar vendet e zgjerimit të përgatiten për anëtarësim. Një ndarje indikative është dhënë në kornizën e rishikuar shumë-vjeçare treguese financiare për vitet 2011-2013.

IPA është dizajnuar për të mundësuar planifikimin strategjik të asistencës përmes Dokumenteve treguese planifikuese shumë-vjeçare (DTPSH) tri-vjetore. Këto dokumente përcaktojnë prioritetet kryesore për ndihmë gjatë viteve të ardhshme dhe përbëjnë bazën për programimin vjetor ose shumë-vjetor. DTPSH-të janë bazuar në nevojat e identifikuara në raportet e partneritetit dhe progresit.

Komisioni ka marrë një sërë hapash për të rritur natyrën strategjike të këtij procesi dhe për të forcuar lidhjen në mes të prioritetëve të përcaktuara në Anëtarësimin apo Partneritetin Evropian dhe raportet e progresit si dhe programimin e asistencës. Kjo ka shpie drejt një rritjeje që përqendrohet në fusha kyçe

themelore, siç janë qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit. Për ta ilustruar më mirë këtë fokus, dhe për të forcuar pronësinë nga vendet përfituese, Komisioni vazhdimisht do të përdorë një qasje të bazuar në sektor për planifikimin e ndihmës së para-pranimit.

Për këtë arsye vendet e zgjerimit inkurajohen për të zhvilluar programe të hollësishme strategjike, në sektorët kryesorë që janë identifikuar si thelbësore për të përparuar drejt BE-së. Prioritetet e pranimit duhet të integrohen plotësisht në këto programe që janë në pronësi të shteteve. DTPSH-ja e ardhme që mbulon vitet 2011-2013 do të përcaktojë objektivat për asistencë IPA brenda këtyre sektorëve.

Fusha të tjera që do të vazhdojnë të jenë të përfshira në DTPSH si prioritet do të jenë ato të lidhura me zhvillimin rajonal, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin rural, veçanërisht për vendet kandidatë. Duke mësuar se si të menaxhojnë ndihmën e para-pranimit në mënyrë efektive dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të mirëfilltë financiar, qeveritë e vendeve të zgjerimit mund të përgatisin veten për menaxhimin e fondeve të BE-së si vende anëtare të ardhmen.

Sidoqoftë, sfidat mbesin kur është fjala për zbatimin efikas të programeve të IPA-s në disa vende. Vendet përfituese duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të siguruar kapacitetet e mjaftueshme administrative dhe ekspertizën për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve të qëndrueshme të orientuara drejt rezultateve, në mënyrë që të optimizohet absorbimi i fondeve në dispozicion para-pranimit. Komisioni do të mbështesë përfituesit për të përmirësuar kapacitetet e tyre dhe do të monitorojë ciklin financiar IPA, duke identifikuar mangësitë në faza të hershme.

Komisioni gjithashtu gjithnjë do të programojë në baza shumë-vjeçare, duke mundësuar prioritetizim më të mirë dhe sekuencim të masave të planifikuara, si dhe më tepër parashikueshmëri të ndihmave financiare për vendet përfituese.

Qasja e bazuar në sektor do të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet donatorëve dhe përfituesve, duke eliminuar dyfishimin e përpjekjeve dhe duke çuar drejt efikasitetit dhe efektivitetit më të madh. Kjo nga ana tjetër duhet të lejojë të gjitha palët e interesuara që të përqendrohen gjithnjë e më tepër në rezultatet e pritura dhe ndikimin e përpjekjeve tona të kombinuara.

Madhësia e investimeve të nevojshme në mënyrë që vendet e zgjerimit të përgatiten për anëtarësim dhe konvergencë të vërtetë, kërkon një kontribut të rëndësishëm nga buxhetet kombëtare, mbështetje nga donatorë të tjerë, Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN), dhe mobilizimin e investitorëve privatë. Partneritetet publiko-private janë veçanërisht të vlefshme për afrimin e granteve nga buxhetet publike dhe kredive nga bankat private. Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor (KIBP), Fondi Evropian për Evropën Juglindore (FEEJ) dhe Fondi për Rritje të Gjellbër (FRGj) janë shembuj të mirë të sigurimit të një niveli të lartë të kapitalit hyrës me burime të kufizuara publike.

KIBP u krijua në dhjetor të vitit 2009 si një iniciativë e përbashkët e Komisionit dhe IFN-ve partnere. Ky është një mjet kyç për kanalizimin e investimeve infrastrukturore në rajon. Mundëson hua të rëndësishme nga IFN-të me grantet e IPA-së. 137 milion € në formë të granteve janë atribuar, që mund të mundësojnë investime në një vlerë të parashikuar prej 6.6 miliardë €. KIBP-ja do të përqendrohet në rritjen e numrit të projekteve të ujit dhe mbeturinave në rajon, duke nxitur mbështetje për efikasitet të energjisë, përshpejtim të investimeve në rrjetin e transportit bazë, dhe duke mbështetur zhvillimin e NVM-ve dhe mekanizmave për të nxitur rritjen ekonomike pas krizës financiare. Projektet nën KIBP mbulojnë disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe forcojnë bashkëpunimin rajonal. KIBP-ja do të favorizojë investime të mëdha të rëndësishme rajonale siç është Rrjeti transportues kyç rajonal i Evropës Jug-lindore, që mund të konsiderohet shenjë paralajmëruese e rrjetit të ardhëm transportues trans-Evropian (TEN-T) në rajon.

Ndihma financiare për bashkëpunim rajonal e IPA-s ka për qëllim të sigurojë stabilitetin e rajonit, rritjen e flukseve ndër-rajonale të tregtisë, dhe mbështetjen e nismave të bashkëpunimit rajonal si dhe strukturat në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Këshillin për Bashkëpunim Rajonal si dhe Shkollën Rajonale për Administratë Publike. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal ka një rol të rëndësishëm për të monitoruar nëse IPA dhe fondet tjera të donatorëve reflektojnë prioritetet e bashkëpunimit rajonal.

Pjesëmarrja në Programet dhe Agjencitë e BE-së

Pjesëmarrja e vendeve të zgjerimit në programet e BE-së dhe agjencive synon të rrisë bashkëpunimin me vendet anëtare si dhe familjarizimin e vendeve me politikat dhe metodat e punës së BE-së. Vendet kandidate dhe kandidate potenciale mund të marrin pjesë në programet e BE-së mbi bazën e marrëveshjeve kornizë dhe mund të marrin pjesë në agjencitë e BE-së bazuar në shqyrtimet e rasteve individuale. Pjesëmarrja mund të financohet pjesërisht përmes asistencës financiare të IPA-së. Vendet inkurajohen të përqendrojnë pjesëmarrjen e tyre në programe apo agjenci ku përfshirja mbështet sektorët kyç për reformim dhe ku ato mund të përfitojnë më së tepërmi.

Informacioni dhe komunikimi

Një politikë e suksesshme e zgjerimit kërkon mbështetje të fortë publike. Shtetet Anëtare dhe vendet e zgjerimit kanë një rol qendror në përpjekjet e informacionit dhe të komunikimit që mund të ndihmojnë ruajtjen e kësaj mbështetjeje publike. Komisioni është i angazhuar për përmirësimin e rrjedhjes së informacioneve objektive për procesin e zgjerimit, të paraqitura në formë të përshtatshme për publikun, nëpërmjet medieve të ndryshme të komunikimit që janë në dispozicion. Është veçanërisht me rëndësi që ky informacion të arrijë tek të rinjtë, përvoja jetësore e të cilëve mund të mos iu japë atyre një botëkuptim të qartë mbi rëndësinë e sigurisë dhe stabilitetit në Evropë. Varet nga liderët politikë në BE, ata kombëtar, të nivelit rajonal dhe lokal për të shfrytëzuar këtë informacion në mënyra që janë më të kuptueshme për zgjedhësit e tyre.

Përvoja nga zgjerimi i pestë ka treguar që hendeku i komunikimit është mbushur shpejt me informata çorientuese. Hendeku duhet të tejkalohet përmes informatave që janë lirshëm në dispozicion dhe të sakta. Kjo është esenciale në mënyrë që publiku të kuptojë plotësisht se për çfarë bëhet fjalë. Në vitin 2010 Bashkimi Evropian është duke u përballur me sfida të reja lidhur me krizën ekonomike, mjedisin, vendet e punës, sigurinë e qytetarit, ndryshimet klimatike dhe migracionin. Këto janë çështje që kanë të bëjnë me publikun si në Shtetet Anëtare ashtu edhe në vendet e zgjerimit. Sfidë për udhëheqësit është që të shpjegojnë se si ndjekja e agjendës së zgjerimit mund të ndihmojë BE-në për të arritur objektivat e saj në këto fusha të rëndësishme, dhe mund të përshpejtojë programin e reformave dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në vendet e zgjerimit. Rezultatet e prekshme dhe reale të procesit janë reklamat më të mira për zgjerimin. Liberalizimi i vizave për Ballkanin Perëndimor është një shembull i fuqishëm.

Zhvillimi i shoqërisë civile

Aktivitetet e shoqërisë civile janë thelbësore për një demokraci të pjekur, respektim të të drejtave të njeriut dhe sundim të ligjit. Aktivitetet e tilla rrisin përgjegjshmërinë politike, nxisin dhe zgjerojnë hapësirën për biseda mbi zgjedhjet shoqërore dhe forcimin e konsensusit për shoqëri pluraliste. Duke kontribuar për një demokraci më të hapur, pjesëmarrëse dhe dinamike, një shoqëri civile aktive dhe energjike është gjithashtu ndihmuese për tolerancë dhe pajtim. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e para-anëtarësimit kontribuon në cilësinë dhe mbështetjen publike për reformat e ndërlydhura me pranimin.

Një kulturë e pranimit dhe vlerësimit të rolit të luajtur nga shoqëria civile duhet të vendoset që të lejojë organizatat e shoqërisë civile për t'u angazhuar në një dialog për politika efikase. Konsultimi publik për

iniciativat e politikave dhe ligjeve duhet të shndërrohet në një parim të përgjithshëm. Qasja e shoqërisë civile në mbështetje nga qeveria shpesh pengohet nga mungesa e transparencës dhe kritereve dobët të zhvilluara të alokimit.

Fasilitimi/lehtësimi i shoqërisë civile i ndihmon organizatat e shoqërisë civile për të forcuar kapacitetet dhe profesionalizimin e tyre, duke i lejuar ata që të angazhohen në një dialog të frytshëm me aktorët publik dhe privat dhe për të monitoruar zhvillimet në fusha të tilla siç janë sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave themelore. Fasilitimi financon iniciativat në nivel lokal, rrjetet rajonale dhe vizitat afatshkurtra për në BE.

Komisioni ka shqyrtuar fasilitimin për t'iu qasur më mirë organizatave lokale të bazuara në komunitet, duke marrë parasysh informatat prapavajtëse nga organizatat e shoqërisë civile. Komisioni do të synojë më mirë nevojat në çdo vend dhe do të sigurojë financim fillestar më afatgjatë për OJQ-të. Organizatat më të fuqishme, të vendosura mund të bëhen mentorë dhe lehtësues për organizata më të vogla.

4. PROGRESI NË VENDET E ZGJERIMIT DHE AGJENDA PËR VITET 2010-2011

4.1. Shtyrja përpara e Ballkanit Perëndimor drejt Anëtarësimit në BE

Në takimin Ministror të Sarajevës, BE-Ballkani Perëndimor më 2 qershor 2010, BE-ja ripërsëriti angazhimin e saj të plotë ndaj perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin Evropian.

Ballkani Perëndimor ka lëvizur më afër BE-së gjatë viteve të kaluara përderisa rajoni ka arritur progres, megjithëse të pabarabartë, në reformat dhe në përmbushjen e kritereve dhe kushteve të përcaktuara. Përparimi i Kroacisë vërteton që Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit për Ballkanin Perëndimor është një politikë që shpie drejt pranimit në BE. Progresi i vendeve tjera të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE varet gjithashtu nga ritmi i reformave të tyre politike dhe ekonomike.

Progres thelbësor është bërë në drejtim të liberalizimit të vizave. Gjatë vitit të kaluar, BE-ja ka hequr vizat për Serbinë, Malin e Zi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kur ata demonstuan aftësinë e tyre për të përmbushur standardet të cilat janë vendosur në fusha të tilla si siguria e dokumenteve të udhëtimit, menaxhimi i kufijve, migrimi, azili, rendi dhe siguria publike, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Kërkesat e vizave do të hiqen së shpejti për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Shqipërinë, në bazë të dëshmimeve të qarta se edhe ata kanë përmbushur këto standarde. Është e rëndësishme që vendet e interesuara të intensifikojnë përpjekjet e tyre për të informuar qytetarët e tyre në lidhje me qëllimet dhe kufizimet e regjimit pa viza. Kosova ka miratuar një ligj mbi riatdhesimin dhe ka rritur përpjekjet për ri-integrimin e personave të riatdhesuar, duke hapur rrugën për dialogun e liberalizimit të vizave.

Kroacia

Kroacia ka bërë përparim të qëndrueshëm drejt përmbushjes së kritereve për anëtarësim nga fillimi i negociatave të pranimit në tetor të vitit 2005. Kroacia i përmbush kriteret politike të Kopenhagës. Sa i përket kritereve ekonomike, Kroacia është një ekonomi funksionale e tregut. Ajo duhet të jetë në gjendje të përballet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian, me kusht që zbaton programin e saj të plotë të reformës me vendosmëri, për të reduktuar dobësitë strukturore.

Sa i përket kritereve të *acquis*, Kroacia ka arritur përparim të mirë në negociatat e pranimit. 33 kapitujt janë hapur, dhe 25 janë mbyllur përkohësisht. Kroacia ka bërë përparim të mirë në përmbushjen e kushteve për mbylljen e kapitujve negociues me implikime financiare (bujqësi dhe zhvillim rural; politikë rajonale dhe koordinim të instrumenteve strukturore, dispozita financiare dhe buxhetore).

Kroacia ka nevojë për të mbështetur përpjekjet për të plotësuar krijimin e strukturave administrative të nevojshme për menaxhimin dhe kontrollin e fondeve të BE.

Kroacia ka nevojë për të përmbushur standardet e mbetura përmbys në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, në veçanti për zhvillimin e prapavijës së nevojshme lidhur me pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve, duke përfshirë kthimin e refugjatëve, gjykimet për krime lufte dhe bashkëpunimin e plotë me ICTY, duke përfshirë zgjidhjen e çështjes së qasjes në dokumente për ICTY-në. Sa i përket konkurrencës, Kroacia duhet të miratojë planet e ristrukturimit për kantieret detare, në përputhje me *acquis*. Kroacia pritet të vazhdojë të luajë një rol aktiv në bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe për të mbështetur vendet e tjera të rajonit në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Duke pasur parasysh prapavijën e Kroacisë në rrugën e përmbushjes së standardeve dhe në zbatimin e angazhimeve të dhëna në negociatat e pranimit, Kroacia është në rrugë të mbarë për përmbushje të kriterëve të *acquis*. Kjo është shfaqur në tabelat monitoruese të cilat Komisioni i ka vendosur për kapituj të mbyllur përkohësisht.

Komisioni do të vazhdojë të monitorojë zbatimin e angazhimeve deri në rastin e pranimit duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, përfshirë vlerësimet e homologëve dhe strukturave në bazë të Stabilizim-Asociimit. Raporte të monitorimit do të paraqiten rregullisht nga Komisioni.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdon të përmbushë në masë të mjaftueshme kriteret politike. Pas reformave të konsiderueshme në vitin 2009, është arritur progres i mëtjshëm, edhe pse me një ritëm të pabarabartë sa i përket reformës së kuvendit, policisë, gjyqësisë, administratës publike si dhe respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve. Vendi duhet të arrijë progres të mëtjshëm në lidhje me dialogun midis aktorëve politikë dhe gjyqësor, si dhe në reformën e administratës publike, luftën kundër korrupsionit, lirinë e shprehjes dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit. Zbatimi i legjislacionit është çështje thelbësore.

Vendi vazhdon të përmbushë angazhimet e veta në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Komisioni ka propozuar të lëvizet në fazën e dytë të Asociimit, siç parashikohet nga MSA.

Këshilli ende nuk ka ndërmarrë ndonjë pozicion lidhur me rekomandimin e Komisionit nga tetori i vitit 2009 për të hapur negociatat e anëtarësimit.

Çështja e emrit me Greqinë mbetet e pazgjidhur. Të dy vendet janë të angazhuara në bisedime nën patronazhin e OKB-së për gjetje të zgjidhjes, kanë ndodhur një sërë kontaktesh dypalëshe, duke përfshirë edhe në nivelin e kryeministrit, edhe pse kjo ende nuk ka shpie drejt rezultateve konkrete. Veprimet dhe deklaratat që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore duhet të shmangen. Është thelbësore ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, duke përfshirë edhe një zgjidhje të negociuar dhe të pranuar reciprokisht për çështjen e emrit nën kujdesin e OKB-së.

Mali i Zi

Paralelisht me këtë Dokument Strategjik, Komisioni ka miratuar Opinionin e vet mbi aplikimin e Malit të Zi për anëtarësim në BE. Konkluzionet dhe rekomandimet e Opinionit janë paraqitur në Shtojcën e këtij komunikimi.

Shqipëria

Paralelisht me këtë Dokument Strategjik, Komisioni ka miratuar Opinionin e vet mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Konkluzionet dhe rekomandimet e Opinionit janë paraqitur në Shtojcën e këtij komunikimi.

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim të kufizuar në trajtimin e reformave kryesore. Zgjedhjet e tetorit të vitit 2010 kanë qenë në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mospërputhshmëritë ndërmjet kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk janë mënjeluar pavarësisht nga vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Respektimi i parimeve demokratike të mishëruara në KEDNj dhe i së drejtës për trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues përbën element thelbësor të Marrëveshjes së Përkohshme.

Zhvillimi i një vizioni të përbashkët nga ana e udhëheqësve mbi drejtimin e përgjithshëm të vendit dhe reformat kyçe lidhur me BE-në mbetet çështje thelbësore për përparimin e mëtejshëm drejt anëtarësimit në BE. Vendi ka nevojë për të ngritur përpjekjet për të krijuar një prapavijë të kënaqshme për zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes së Përkohshme.

Urgjentisht duhet të ndërmerren hapat fillestar nga Bosnja dhe Hercegovina për të ndërlidhur Kushtetutën e saj me Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj) dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe funksionimin e institucioneve të saj. Vendi duhet të jetë në gjendje të miratojë, implementojë dhe zbatojë ligjet dhe rregullat e BE-së. Sa i përket detyrimeve ndërkombëtare, arritja e përparimit në përmbushjen e objektivave dhe kushteve të vendosura për mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (ZPL) mbeten thelbësore. BE-ja, përmes një pranije të përforcuar do të ndihmojë Bosnjën dhe Hercegovinën në zbatimin e objektivave të agjendës së BE-së.

Serbia

Serbia ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2009 dhe ka shfaqur një angazhim të përtërirë drejt përmbushjes së kriterëve të Kopenhagës. Në tetor të vitit 2010 Këshilli ftoi Komisionin të paraqesë opinionin e vet mbi këtë kërkesë. Në shkurt të vitit 2010 Marrëveshja e Përkohshme ka hyrë në fuqi dhe në qershor të vitit 2010 shtetet anëtare kanë rënë dakord për ta paraqitur Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në parlamentet e tyre për ratifikim.

Serbia ka vazhduar të zbatojë agjendën e saj të reformave politike. Disa rezultate pozitive janë arritur në luftën kundër krimit të organizuar. Përpjekje shtesë janë të nevojshme lidhur me reformën e gjyqësorit dhe të administratës publike si dhe për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Serbia ka vazhduar të krijojë një prapavijë të zbatimit të Marrëveshjes së Përkohshme dhe është vendosur në pozitë të mirë për të përmbushur kërkesat e MSA-së. Serbia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt pajtimit në rajon, në veçanti me Kroacinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën. Serbia ka vazhduar të bashkëpunojë në mënyrë aktive me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Megjithatë, dy të kërkuarit e mbetur nga ICTY janë ende të lirë. Bashkëpunimi i plotë me Tribunalin mbetet një kusht thelbësor për anëtarësim në BE, siç është përcaktuar në konkluzionet e Këshillit të datës 25 tetor të vitit 2010.

Serbia duhet të demonstrojë një qëndrim më konstruktiv ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në tregun rajonal si dhe ndaj bashkëpunimit. Ajo duhet t'i njohë vullat doganore të Kosovës të cilat UNMIK-u dy herë i ka vërtetuar në përputhje me rezolutën 1244. Bashkëpunimi me misionin e EULEX-it për sundimin e ligjit në lidhje me veriun e Kosovës duhet të përforcohet. Pas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të

OKB-së, BE-ja është e gatshme për të lehtësuar një proces të dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës për të nxitur bashkëpunim, arritur përparim në rrugën drejt BE-së dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve.

Kosova

Në Kosovë zgjedhjet lokale në fund të vitit 2009 u zhvilluan në mënyrë të rregullt dhe me pjesëmarrje të të gjitha komuniteteve. Pjesëmarrja në votime ishte shumë e ulët në pjesën veriore të Kosovës. Procesi i decentralizimit është avancuar në mënyrë të konsiderueshme. Bashkëpunimi me EULEX-in është përmirësuar. Qeveria ka përmirësuar kapacitetet e saj për zbatimin e agjendës Evropiane të Kosovës dhe politikat e reformës. Sidoqoftë, sfida të mëdha mbeten sa i përket reformës së administratës publike dhe sundimit të ligjit, duke përfshirë gjyqësorin. Më shumë duhet të bëhet për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe pastrimin e parave. Dialogu dhe pajtimi ndërmjet komuniteteve si dhe mbrojtja dhe integrimi i minoriteteve, veçanërisht të serbëve të Kosovës, mbesin fusha që paraqesin shqetësime. Autoritetet duhet të sigurojnë një qasje konstruktive ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në forumet e bashkëpunimit rajonal për të mbetur në hap me zhvillimet rajonale.

Në dhjetor të vitit 2009, Këshilli mirëpriti Komunikimin e Komisionit ‘Kosova - Përbushja e Perspektivës së saj Evropiane’⁴ Këshilli ftoi Komisionin për të ndërmarrë masat e nevojshme për mbështetje të përparimit të Kosovës drejt BE-së, në përputhje me perspektivën Evropiane të rajonit si dhe për të raportuar mbi progresin në këtë drejtim. Këshilli theksoi rëndësinë e masave që lidhen me tregtinë dhe vizat, pa paragjykuar qëndrimet e Shteteve Anëtare mbi statusin.

Në shkurt, Komisioni propozoi vazhdimin e masave autonome të tregtisë për Kosovën. Në korrik Komisioni ka ndërmarrë një mision ekspertësh për të vlerësuar gatishmërinë e Kosovës për të përbushur kërkesat në lidhje me një marrëveshje të mundshme tregtare me BE-në. Do të nevojiten përpjekje lidhur me rregullimin teknik të produkteve, kontrollin e origjinës, pronësinë intelektuale, rregullat e konkurrencës dhe të prokurimit publik. Komisioni do të shtojë përpjekjet për të ndihmuar Kosovën në adresimin e mangësive të identifikuar. Pasi Kosova t’i plotësojë kërkesat përkatëse, Komisioni do të propozojë direktivat negociuese për një marrëveshje të tregtisë.

Komisioni do të përkrahë pjesëmarrjen e Kosovës në programet përkatëse të Bashkimit Evropian. Së bashku me autoritetet e Kosovës, Komisioni filloi Procesin e dialogut të Stabilizim-Asociimit me Kosovën në janar. Është përmbyllur një cikël i plotë i takimeve.

Komisioni mbështet pjesëmarrjen e Kosovës në programet e IPA-së për bashkëpunim ndër-kufitar me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërinë. Që nga viti 2011, mbështetja do të përfshijë gjithashtu edhe programet me Malin e Zi.

Komisioni do të vazhdojë të çojë përpara iniciativat që i ka përshkruar në komunikimin e saj mbi Kosovën në përputhje me konkluzionet e Këshillit.

4.2. Shtyrja përpara e negociatave të pranimit me Turqinë

Turqia ka vazhduar procesin e saj të reformave politike. Ajo ka ndryshuar kushtetutën duke kryer reforma kyçe në sistemin e saj politik dhe juridik lidhur me një sërë prioritetesh në fushat e gjyqësisë dhe të të drejtave thelbësore. Reformat kanë kufizuar kompetencat e gjykatave ushtarake; kanë ristrukturuar gjykatën kushtetuese, kanë zgjeruar përbërjen e këshillit të lartë të gjykatësve dhe prokurorëve publikë duke e bërë gjyqësorin më përfaqësues në përgjithësi, kanë zgjeruar të drejtat e sindikatave në sektorin publik, kanë dhënë bazë për miratimin e masave të posaçme për mbrojtjen e të

⁴ COM(2009) 534 finale, 14.10.2009.

drejtave të grave dhe fëmijëve, kanë garantuar mbrojtjen e të dhënave personale, dhe kanë dhënë të drejtat për të aplikuar tek avokati i popullit duke siguruar bazën ligjore për themelimin e institucionit të Ombudspersonit.

Ndryshimet kushtetuese janë një hap i rëndësishëm në drejtim të duhur. Megjithatë, konsultimi i publikut të gjerë me përfshirje të të gjitha partive politike dhe të shoqërisë civile, me angazhimin e tyre të plotë është i nevojshëm për të forcuar mbështetjen për reformat kushtetuese. Tani nevojitet të sigurohet zbatimi i përshtatshëm i këtyre reformave nëpërmjet legjislacionit përkatës. Një kushtetutë e re civile do të ofronte bazë solide për një forcim të mëtejshëm të demokracisë në Turqi, në përputhje me standardet evropiane dhe kriteret për praninë në BE.

Lidhur me të drejtat themelore të njeriut, në Turqi duhet të fuqizohet liria e shprehjes dhe e medieve si përmes ligjit ashtu edhe në praktikë. Një sërë të metash mbeten në ushtrimin e lirisë së fesë. Progres nevojitet edhe për të drejtat e grave dhe për barazinë gjinore dhe nevojitet siguri i të drejtave të plota sindikale. 'Hapja demokratike' që synon veçanërisht trajtimin e çështjes Kurde ka dhënë rezultate të kufizuara. Situata e sigurisë në Jug-lindje është përkeqësuar, me një rigjallërim të sulmeve nga ana e organizatës terroriste PKK / Kongra-Gel. Disa përparime janë arritur në luftën kundër korrupsionit.

Negociatat e anëtarësimit kanë përparuar, edhe pse mjaft ngadalë. Ato kanë arritur një fazë që kërkon mjaft shumë nga Turqia për të ngritur përpjekjet e saj në përmbushjen e kushteve të përcaktuara. Duke avancuar në plotësimin e standardeve dhe të kërkesave të përcaktuara në Kornizën Negociuese, Turqia do të jetë në gjendje të përshpejtojë tempin e negociatave. Gjatë muajve të ardhshëm, Turqia duhet t'i japë prioritet të veçantë *politikës së konkurrencës, prokurimeve publike dhe politikës sociale* si dhe kapitujve të punësimit.

Politika e jashtme e Turqisë është bërë më aktive në spektrin e fqinjësisë së saj më të gjerë. Kjo çështje është aset për Bashkimin Evropian, me kusht që zhvillohet si plotësuese në procesin e pranimit të Turqisë dhe në koordinim me BE-në. Turqia ka bërë një sërë propozimesh për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet BE-së dhe Turqisë në aspektin e politikës së jashtme. Përparim i konsiderueshëm është arritur në negociatat për një marrëveshjeje riatdhesimi me Turqinë.

Turqia ka vazhduar të shprehë mbështetje publike për negociatat nën patronazhin e OKB-së midis krerëve të komuniteteve Qipriot Greke dhe Qipriot Turke për të arritur një zgjidhje të plotë për problemin e Qipros. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë përparim për normalizim të marrëdhënieve dypalëshe me Republikën e Qipros. Turqia nuk ka zbatuar plotësisht protokollin shtesë të Marrëveshjes së Asociimit dhe nuk ka hequr të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë kufizimet mbi lidhjet e transportit të drejtpërdrejta me Qipron. Është urgjente që Turqia të përmbush detyrimin e vet të zbatimit të plotë jo-diskriminues të Protokollit Shtesë dhe të arrijë progres drejt normalizimit të marrëdhënieve dypalëshe me Republikën e Qipros. BE-ja do të vazhdojë të ndjekë dhe të shqyrtojë progresin e arritur në çështje që mbulohen nga Deklarata e 21 shtatorit e vitit 2005, në pajtim me konkluzionet e Këshillit, duke përfshirë konkluzionet e dhjetorit të vitit 2006 dhe dhjetorit të vitit 2009. Në mungesë të progresit, Komisioni rekomandon që BE-ja të mbajë në funksion masat e saj nga viti 2006, gjë që do të ketë ndikim të vazhdueshëm në përparimin e përgjithshëm të negociatave.

Turqia duhet të shtojë përpjekjet për të zgjidhur çështjet e hapura dypalëshe, duke përfshirë kontestet kufitare me fqinjët e saj. Ekziston një shtytje e re për të përmirësuar marrëdhëniet me Greqinë. Një numër i konsiderueshëm ankesash zyrtare janë bërë nga Greqia në lidhje me shkeljet e vazhdueshme të hapësirës së saj ajrore nga Turqia, duke përfshirë fluturimet mbi ishujt grekë. Greqia gjithashtu ka bërë ankesa për shkelje të ujërave territoriale të saj. Protokollin për normalizimin e marrëdhënieve me Armeninë i nënshkruar në vitin 2009 nuk është ratifikuar.

4.3. Lansimi i procesit të pranimit me Islandën

Procesi i pranimit të Islandës ka nisur. Pas rekomandimit të Komisionit në Opinionin e vet të shkurtit të vitit 2010 dhe vendimit të Këshillit Evropian të qershorit, negociatat e pranimit janë hapur në korrik të vitit 2010 dhe kontrollimi i *acquis* të BE-së me Islandën është gati për të filluar. Islanda ka të drejtë tani për asistencë IPA e cila është në dispozicion për të mbështetur përpjekjet e vendit drejt përgatitjes për t'u bërë anëtare e plotë e BE-së.

Progres i mirë është arritur për të përmirësuar më tej kornizën ligjore në lidhje me konfliktin e interesave dhe financimin e partive politike. Rregullat për emërimin e gjyqtarëve janë ndryshuar me qëllim të forcimit të mëtejshëm të pavarësisë së gjyqësorit. Hapat të rëndësishëm për stabilizim ekonomik janë ndërmarrë. Progres është arritur në konsolidimin e financave publike dhe rivendosjen e sistemit financiar. Programi i FMN-së është në rrugë të duhur. Megjithatë, pasiguria ekonomike dhe sfidat vazhdojnë të mbesin. Islanda do të ketë nevojë për të adresuar detyrimet ekzistuese, të tilla si ato të identifikuar nga Autoriteti i EFTA-s për Mbikëqyrje (ESA) nën Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane. Përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për t'u siguruar që qytetarët në Islandë janë të informuar mbi çështjen se çfarë do të sjellë anëtarësimi në BE.

5. KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET

Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni paraqet **konkluzionet** dhe rekomandimet e mëposhtme:

1. Zgjerimi përforcon paqen dhe stabilitetin në Evropë. Është në interes **strategjik të BE-së** për të ecur përpara me procesin e zgjerimit mbi bazën e parimeve dhe kushteve të akorduara dhe konsensusit të ripërtërirë mbi zgjerimin e miratuar nga Këshilli Evropian në dhjetor të vitit 2006. Angazhimi i fuqishëm politik i të gjithë aktorëve është i nevojshëm për të arritur një sukses në zgjerim. Zgjerimi duhet të mbetet i besueshëm për të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë çështje. Vendet candidate duhet të jenë të përgatitura mirë përmes kushtëzimeve rigorozë dhe duhet të ekzistojë një perspektivë e qartë dhe e prekshme Evropiane pasi të jenë plotësuar kushtet.
2. Procesi i zgjerimit ndihmon BE-në për të arritur më mirë objektivat e saj të politikave në një sërë fushash të cilat janë kyçe për rimëkëmbje ekonomike dhe rritje të qëndrueshme, përfshirë konvergjencën rregullative dhe tregun e brendshëm, energjinë, transportin, mbrojtjen e mjedisit dhe përpjekjet për të kufizuar ndryshimin e klimës, si dhe duke e bërë BE-në një vend më të sigurt.
3. Komisioni do të forcojë më tej monitorimin e politikave makro-ekonomike të vendeve të zgjerimit, gjithashtu duke marrë në konsideratë zhvillimet e reja në qeverisjen ekonomike të BE-së. Komisioni pret që vendet candidate të ndjekin reformat lidhur me BE-në, dhe të përmirësojnë mjedisin e biznesit, duke ndihmuar kështu në tejkalimin e krizës ekonomike dhe për të arritur rritje të qëndrueshme. Komisioni pret që vendet e zgjerimit të shoqërojnë zgjerimin me iniciativa të ndërmarrë në nivel të BE-së për të përmbushur qëllimet e strategjisë Evropa 2020. Ajo fton vendet e zgjerimit për të reflektuar objektivat 2020 në prioritetet e tyre politike kombëtare, për t'u angazhuar në grupet e politikës rajonale me qëllim të shqyrtimit të rregullt të rezultateve të këtyre

reformave si dhe për të vendosur objektiva të veçanta për ndonjë rajon kur një gjë e tillë është e përshtatshme.

4. Komisioni inkurajon vendet e zgjerimit që të punojnë për përmirësimin e kushteve për grupet e cenueshme, duke përfshirë edhe përfshirjen sociale dhe ekonomike të romëve. Komisioni është i angazhuar për të mbështetur ata në këtë përpjekje.
5. Komisioni do t'i japë përparësi të vazhdueshme gjyqësorit dhe reformës së administratës publike, luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe intensifikimit të mëtejshëm të sundimit të ligjit dhe dialogut me vendet kandidatë. Shumica e vendeve të zgjerimit duhet të arrijnë përparim të konsiderueshëm për të konsoliduar shtetin e së drejtës dhe, në veçanti, për të krijuar një prapavijë të besueshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.
6. Liria e shprehjes dhe e medieve mbetet një shqetësim në shumicën e vendeve të zgjerimit, problemet e identifikuar duhet të trajtohen si çështje me prioritet. Përparimi në këtë fushë është esencial dhe do të monitorohet nga afër prej Komisionit. Komisioni do të vazhdojë të mbështesë organizatat e shoqërisë civile dhe do të përdorë në mënyrë të plotë mundësitë e shoqërisë civile.
7. Bashkëpunimi rajonal është një element thelbësor i procesit të Stabilizim-Asociimit. Ballkani Perëndimor ka arritur përparim të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal, gjë që nuk duhet të dëmtohet për shkak të dallimeve lidhur me Kosovën. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal duhet të përqendrohet në zbatimin e strategjisë së vet të orientuar drejt rezultateve.
8. Progres i konsiderueshëm është bërë në drejtim të liberalizimit të vizave. Detyrimi i vizave për qytetarët e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë është hequr. Kërkesat e vizave do të hiqen së shpejti edhe për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Shqipërinë, në bazë të dëshmiave të qarta se edhe këto vende kanë përmbushur standardet. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme nga vendet e interesuara për të informuar qytetarët e tyre në lidhje me qëllimin dhe kufizimet e regjimit pa viza, për të monitoruar nga afër zbatimin e tij dhe, kur kërkohet, ndërmarrjen e masave adekuate korrigjuese.
9. Çështjet dypalëshe duhet të zgjidhen nga palët e interesuara, në një frymë të fqinjësisë së mirë dhe duke marrë parasysh interesat e përgjithshme të BE-së. Ato nuk duhet të mbajnë peng procesin e pranimin. BE-ja është e gatshme për të lehtësuar kërkimin e zgjidhjeve dhe për të mbështetur iniciativa të ndërlidhura. Ka ardhur koha që rajoni të tejkalojë trashëgiminë e konflikteve të së kaluarës, duke ndërtuar mbi zhvillimet e fundit pozitive në lidhje me pajtimin. Marrëdhëniet e mira fqinjësore mbeten çështje kyçe.
10. Komisioni rikujton që kapitujt negociues për të cilët kanë përfunduar përgatitjet teknike duhet të mbesin të hapur apo të mbyllën përkohësisht në bazë të *acquis* në fjalë, në përputhje me Kornizat negociuese dhe në përputhje me masat e miratuara nga Këshilli. Është në interes të BE-së për të hapur diskutime mbi kapitujt e vështirë në fillim të negociatave, duke përfshirë kapitullin për gjyqësorin dhe të drejtat bazë, gjë që kërkon krijimin e një prapavije bindëse dhe të besueshme dhe që rrjedhimisht këta të jenë ndër kapitujt e fundit që mbyllën.

11. Ndhurma para-pranimit është pjesë përbërëse e strategjisë së zgjerimit dhe është projekt për të ndihmuar përmbushjen e prioriteteve të identifikuara në raportet e partneritetit dhe të progresit. Vendet përfituese duhet të forcojnë kapacitetet e tyre për të përdorur fondet e BE-së në mënyrë efektive.
12. Komisioni fton shtetet anëtare që të punojnë me institucionet e BE-së për forcimin e mirëkuptimit dhe për mbështetje të procesit të zgjerimit si dhe për të shpjeguar se si mund të ndihmojnë për të arritur objektivat tona të përbashkëta. Komisioni është i angazhuar për përmirësimin e rrjedhjes së informatave objektive për procesin e zgjerimit, të paraqitura në formë të pranueshme për publikun nëpërmjet medieve të ndryshme të komunikimit që janë në dispozicion.
13. Kroacia ka arritur përparim të mirë drejt përmbushjes së kriterëve për anëtarësim dhe negociatat e anëtarësimit kanë arritur në fazën përfundimtare. Bashkëpunimi i plotë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë mbetet një kërkesë për përparimin e Kroacisë gjatë gjithë procesit të anëtarësimit në përputhje me Kornizën Negociuese. Komisioni konsideron se negociatat duhet të përfundojnë pasi Kroacia të ketë përmbushur standardet e mbetura të mbylljes, në veçanti në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit, duke mënjanuar nevojën që BE-ja të marrë parasysh një mekanizëm bashkëpunimi dhe verifikimi pas pranimit. Komisioni do të monitorojë nga afër progresin e Kroacisë në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore dhe do të analizoj situatën në tremujorin e parë të vitit 2011.
14. Turqia ka vazhduar procesin e reformave politike, në veçanti përmes reformës së kushtetutës së saj. Rezultate të mëtejshme nevojiten në lidhje me të drejtat themelore, 'hapjen demokratike' dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve në procesin e reformimit. Sigurimi i lirisë së shprehjes në praktikë është veçanërisht i vështirë. Negociatat e pranimit kanë avancuar edhe pse mjaft ngadalë. Duke avancuar në përmbushjen e standardeve dhe të kërkesave të përcaktuara në Kornizën Negociuese, Turqia do të jetë në gjendje të përshpejtojë tempin e negociatave. Tani është urgjente që Turqia të përmbush detyrimin e vet të zbatimit të plotë dhe jo-diskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit dhe të ecë drejt normalizimit të marrëdhënieve dypalëshe me Republikën e Qipros. BE-ja do të vazhdojë të ndjekë dhe të shqyrtojë progresin e bërë në çështjet e mbuluara nga Deklarata e 21 shtatorit të vitit 2005 në pajtim me konkluzionet e Këshillit, duke përfshirë konkluzionet e dhjetorit të vitit 2006 dhe dhjetorit të vitit 2009. Në mungesë të progresit, Komisioni rekomandon që BE-ja të mbajë në veprim masat e saj nga viti 2006, gjë që do të ketë ndikim të vazhdueshëm në përparimin e përgjithshëm të negociatave.
15. Në lidhje me çështjen e Qipros, udhëheqësit e komuniteteve Greke Qipriote dhe Turke Qipriote janë duke vazhduar negociatat mbi një marrëveshje të plotë nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara. Komisioni mbështet përpjekjet e tyre dhe ofron këshilla teknike për çështjet brenda kompetencave të BE-së. Ai i bën thirrje të dy liderëve për të forcuar përpjekjet e tyre për të arritur zgjidhje, në mënyrë që bisedimet të kenë një përfundim të suksesshëm sa më shpejt që është e mundur, dhe gjithashtu përsërit thirrjen e vet për Turqinë që të kontribuojë në mënyrë konkrete për një zgjidhje të plotë të çështjes së Qipros.

16. Procesi i pranimit për Islandën ka nisur. Pas rekomandimit të Komisionit në Opinionin e tij të shkurtit të vitit 2010 dhe vendimit të Këshillit Evropian të qershorit, negociatat e pranimit janë hapur në korrik të vitit 2010 dhe kontrollimi i nënshtrimit ndaj *acquis* të BE-së nga ana e Islandës është gati për të filluar. Islanda do të ketë nevojë për të adresuar detyrimet ekzistuese, siç janë ato të identifikuar nga Autoriteti EFTA i Mbikëqyrjes (ESA), sipas Marrëveshjes së Hapësirës Ekonomike Evropiane. Përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për të siguruar që qytetarët në Islandë janë të informuar si duhet për atë që sjell anëtarësimi në BE.
17. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdon të përmbushë në masë të mjaftueshme kriteret politike. Progres i mëtijshëm është bërë në fushat kyçe të reformave, ndonëse me një ritëm të pabarabartë. Përpjekje nevojiten në veçanti sa i përket gjyqësorit dhe administratës publike. Komisioni rithekson rekomandimin e vet që negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian duhet të hapen me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore është thelbësore për një zgjidhje të negociuar dhe të pranuar reciprokisht për çështjen e emrit nën patronazhin e OKB-së.
18. Në Opinionet e saj të miratuara sot Komisioni rekomandon që negociatat e pranimit duhet të hapen me Malin e Zi dhe Shqipërinë pasi këto vende kanë arritur shkallën e nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit të përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagë në vitin 1993. Në veçanti, Mali i Zi dhe Shqipëria kanë nevojë për të përmbushur prioritetet specifike kryesore të përcaktuara në çdo Opinion. Komisioni rekomandon që Këshilli t'ia japë statusin e vendit kandidat Malit të Zi. Ai e nxit Shqipërinë që të bëjë përpjekje të mëtijshme për të punuar mbi progresin e arritur gjer më tani. Raporti i Komisionit mbi përparimin në të dy vendet në paketën e zgjerimit të vitit 2011 do të përqendrohet në mënyrë të veçantë në zbatimin e prioritetëve kryesore të cilat duhet të adresohen me qëllim të hapjes së negociatave të pranimit.
19. Serbia ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2009 dhe në tetor të vitit 2010 Këshilli ftoi Komisionin të paraqesë opinionin e vet. Serbia ka vazhduar të zbatojë agjendën e saj të reformave politike dhe të krijojë një prapavijë të zbatimit të Marrëveshjes së Përkohshme. Ajo është në pozitë të mirë për të përmbushur kërkesat e MSA-së. Serbia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt pajtimit në rajon. Përpjekje shtesë janë të nevojshme lidhur me reformën gjyqësore dhe të administratës publike si dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Serbia ka vazhduar bashkëpunimin me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Megjithatë, dy të kërkuarit e mbetur të ICTY-së janë ende të lirë. Bashkëpunimi i plotë me Tribunalin mbetet një kusht thelbësor për anëtarësim në BE siç është përcaktuar në konkluzionet e Këshillit të datës 25 tetor 2010. Serbia duhet të demonstrojë një qëndrim më konstruktiv ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në tregun rajonal dhe sa i përket bashkëpunimit. Bashkëpunimi me misionin e EULEX-it për mbizotërimin e ligjit në lidhje me veriun e Kosovës duhet të forcohet.
20. Pas Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, BE-ja do të lehtësojë procesin e dialogut midis Beogradit dhe Prishtinës për të nxitur bashkëpunim dhe arritje të përparimit në rrugën drejt BE-së si dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve.
21. Procesi i decentralizimit në Kosovë ka përparuar në mënyrë të konsiderueshme dhe bashkëpunimi me EULEX-in është ngritur. Qeveria ka përmirësuar kapacitetet e saj për zbatimin

e agjendës Evropiane të Kosovës dhe për politikat e reformës. Sidoqoftë, sfida të mëdha mbeten sa i përket sundimit të ligjit, duke përfshirë reformën e administratës publike dhe gjyqësorit, si dhe trajtimin e korrupsionit, krimin të organizuar dhe pastrimin e parave. Dialogu dhe pajtimi mes komuniteteve si dhe mbrojtja dhe integrimi i pakicave, veçanërisht i serbëve të Kosovës ende mbesin fusha që paraqesin shqetësime. Autoritetet duhet të sigurojnë një qasje konstruktive ndaj pjesëmarrjes së Kosovës në forumet e bashkëpunimit rajonal për të mbajtur ritmin me zhvillimet rajonale.

Komisioni është duke shtyrë përpara iniciativat e veta të përshkruara në Komunikimin për Kosovën në tetor të vitit 2009, në përputhje me konkluzionet e Këshillit të dhjetorit të vitit 2009. Komisioni mirëpret progresin e fundit të Kosovës të arritur me miratimin e legjislacionit mbi riatdhesimin si dhe me hartimin e një Plani të Veprimit për ri-integrimin e të kthyerve që mbështetet me resurse të rezervuara. Duke u mbështetur në vazhdimin e zbatimit të kësaj çështjeje, Komisioni është i zotuar për të nisur një dialog për liberalizimin e vizave së shpejti. Komisioni është duke ndihmuar Kosovën që të krijojë kushtet e nevojshme për një marrëveshje të mundshme tregtare me BE-në. Pasi Kosova të plotësojë kërkesat përkatëse, Komisioni do të propozojë direktivat negociuese për një marrëveshje tregtare. Komisioni do të propozojë hapjen e mundësisë për pjesëmarrjen e Kosovës në programe të Bashkimit Evropian siç janë *Evropa për Qytetarët* dhe *Kultura*. Komisioni do të propozojë direktivat negociuese për një marrëveshje kornizë për këtë qëllim.

22. Bosnja dhe Hercegovina ka nevojë për të formuar një qeveri të angazhuar për të ardhmen e vendit në BE dhe për të përshpejtuar reformat përkatëse. Duhet të ndërmerren hapat fillestar si çështje urgjente nga Bosnja-Hercegovina për ta lidhur Kushtetutën e saj me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe për të përmirësuar funksionimin e institucioneve të saj. Vendi duhet të jetë në gjendje të miratojë, implementojë dhe zbatojë ligjet dhe rregullat e BE-së. Sa i përket detyrimeve ndërkombëtare, arritja e përparimit në përmbushjen e objektivave dhe kushteve të cilat kanë qenë të vendosura për mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (ZPL) mbeten thelbësore. BE-ja, përmes një pranije të përforcuar të saj do të ndihmojë Bosnjën dhe Hercegovinën në zbatimin e objektivave të agjendës së BE-së.
23. Në përgjithësi, raportet e progresit të vitit 2010 tregojnë që procesi i zgjerimit të BE-së është duke lëvizur përpara me një ritëm i cili është përcaktuar kryesisht nga kapacitetet e dëshmuara të vendeve candidate për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Kjo kërkon reforma të qëndrueshme si dhe përshtatje legjislative dhe institucionale që janë të besueshme dhe bindëse. Përderisa shtetet anëtare plotësojnë standardet e vendosura, duke përfshirë sidomos standardet që lidhen me demokracinë, sundimin e ligjit si dhe të drejtat dhe liritë themelore, BE-ja është e përkushtuar për të punuar me ato vende për të ecur drejt hapave të ardhshëm të këtij procesi.

SHTOJCA 1

Konkluzionet dhe rekomandimet e Opinioneve të Komisionit mbi aplikimet për anëtarësim nga Mali i Zi dhe Shqipëria

Mali i Zi

Mali i Zi ka arritur progres në përmbushjen e kriterëve që lidhen me stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave të vendosura nga Këshilli Evropian i Kopenhagës në vitin 1993, si dhe kushtet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme.

Sa i përket kriterëve ekonomike, Mali i Zi ka arritur një shkallë të caktuar të stabilitetit makroekonomik. Megjithatë, për të vendosur një ekonomi funksionale të tregut, siç është përcaktuar nga Këshilli Evropian i Kopenhagës në vitin 1993, Mali i Zi ka nevojë për të adresuar pabarazitë e brendshme dhe të jashtme si dhe dobësitë ekzistuese, sidomos në sektorin financiar dhe funksionimin e tregjeve të punës, si dhe duhet të forcojë sundimin të ligjit. Në mënyrë që të mund të përballojë në aspektin afat-mesëm presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian, Mali i Zi ka nevojë për të forcuar infrastrukturën fizike dhe të kapitalit njerëzor dhe për të vazhduar zbatimin e reformave strukturore.

Prapavija e Malit të Zi në rrugën e zbatimit të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është pozitive në përgjithësi.

Mali i Zi do të jetë në pozitë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në një periudhë afat-mesme në shumicën e fushave të *acquis*, me kusht që procesi i rreshtimit të vazhdojë dhe nëse përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme të mëtejshme bëhen për të siguruar implementimin dhe zbatimin e legjislacionit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fushës së lëvizjes së lirë të mallrave, të drejtës së pronësisë intelektuale, bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë së ushqimit, politikave veterinare dhe fito-sanitare, peshkimit, statistikave, politikave sociale dhe punësimit, politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore, gjyqësorit dhe të drejtave themelore, lirisë, drejtësisë dhe sigurisë si dhe kontrollit financiar. Përputhje e plotë ndaj *acquis* në fushën e mjedisit mund të arrihet vetëm në aspektin afat-gjatë dhe një gjë e tillë kërkon rritjen e investimeve, rrjedhimisht përpjekjet në këtë fushë duhet të përshpejtohen.

Pranimi i Malit të Zi në përgjithësi do të ketë ndikim të kufizuar në politikat e Bashkimit Evropian dhe nuk do të ndikojë në kapacitetin e Bashkimit Evropian për të ruajtur dhe ngritur zhvillimin e vet.

Komisioni konsideron që negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian duhet të hapen me Malin e Zi pasi vendi të ketë arritur shkallën e nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti kriteret politike të Kopenhagës që kërkojnë stabilitet të institucioneve të cilat në veçanti garantojnë sundimin e ligjit. Në këtë drejtim Mali i Zi në veçanti ka nevojë të përmbushë prioritetet e mëposhtme kryesore:

- Përmirësimi i kornizës ligjore për zgjedhjet në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR-së dhe të Komisionit të Venedikut, forcimi i rolit legjislativ dhe mbikëqyrës të Parlamentit.

- Hapa të plotë thelbësor në reformën e administratës publike, duke përfshirë ndryshimet në ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjin për punonjësit civilë dhe punonjësit e shtetit si dhe forcimin e autoritetit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Kontrollin Shtetëror, duke synuar rritjen e profesionalizmit dhe de-politizimin e administratës publike për të përforcuar një qasje transparente, të bazuar në merita për emërimet dhe promovimet.

- Forcimi i sundimit të ligjit, në veçanti përmes emërimeve të depolitizuara dhe i bazuar në merita të anëtarëve të këshillave gjyqësore dhe të prokurorisë si dhe të prokurorëve të shtetit, si dhe me përforcimin e pavarësisë, autonomisë, efikasitetit, dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

- Përmirësimi i kornizës ligjore kundër korrupsionit dhe zbatimi i strategjisë së qeverisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit, krijimi i një prapavije të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet.

- Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe hetimeve proaktive, rritja e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe të BE-së, përpunimi efikas i inteligjencës penale dhe zgjerimi i kapaciteteve për zbatimin e ligjit dhe bashkërendimin. Zhvillimi i një prapavije të fuqishme në këtë fushë.

- Ngritja e lirisë së medieve në masë të theksuar duke u iu përshtatur ligjit zakonor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi shpifjen dhe duke forcuar bashkëpunimin me shoqërinë civile.

- Zbatimi i kornizës ligjore dhe të politikave për anti-diskriminimin në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, garantimi i statusit ligjor të personave të zhvendosur, në veçanti atyre Romë, Ashkali dhe Egjiptianë për të siguruar respektimin e të drejtave të tyre. Kjo përfshinë miratimin dhe zbatimin e një strategjie të qëndrueshme për mbylljen e kampit Konik.

Mali i Zi inkurajohet të vazhdojë angazhimin e vet konstruktiv në bashkëpunimin rajonal dhe në forcimin e marrëdhënieve bilaterale me vendet fqinje. Çështjet dypalëshe të pazgjidhura duhet të adresohen. Duhet të vazhdohet zbatimi i MSA-së pa vështirësi, në këtë kontekst vëmendje e duhur nevojitet për të adresuar mangësitë e identifikuara në fusha të ndihmave të tilla të shtetit dhe transitit të trafikut. Përveç kësaj, vendi inkurajohet fuqishëm që të vazhdojë përmirësimin e kapaciteteve të veta administrative në të gjitha aspektet. Përpjekje të veçanta janë të nevojshme në lidhje me efektivitetin dhe paanshmërinë e administratës shtetërore në fusha të ndjeshme të tilla siç është mbrojtja e mjedisit. Rastet e dhunës dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe të aktivistëve të OJQ-ve duhet të ndiqen penalisht. Çështjet e dhunës në familje, keqtrajtimi dhe kushtet nën standarde të burgjeve duhet të adresohen.

Duke marrë parasysh përparimin e arritur gjer më tani, Komisioni rekomandon që Këshilli duhet t'i japë Malit të Zi statusin e vendit kandidat.

Komisioni do të monitorojë progresin e reformave të nevojshme brenda kornizës institucionale të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të vazhdojë të mbështesë përpjekjet përmes instrumentit financiar IPA. Komisioni do të paraqesë një raport mbi përparimin e Malit të Zi në paketën e zgjerimit të

vitit 2011. Ky raport do të përqendrohet në veçanti në zbatimin e prioriteteve kryesore të cilat duhet të adresohen me qëllim të hapjes së negociatave të pranimit.

Shqipëria

Shqipëria ka arritur progres drejt përmbushjes së kritereve që lidhen me stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave të përcaktuara nga Këshilli Evropian i Kopenhagës në vitin 1993, si dhe kushtet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme të mëtejshme janë të nevojshme.

Sa i përket kritereve ekonomike, Shqipëria ka arritur një shkallë të caktuar të stabilitetit makroekonomik. Megjithatë, që të bëhet një ekonomi e tregut funksionale, siç është përcaktuar nga Këshilli Evropian i Kopenhagës i vitit 1993, Shqipëria duhet të forcojë më tej qeverisjen, përmirësojë performancën e tregut të punës, të sigurojë njohjen e të drejtave të pronësisë dhe të forcojë sundimin e ligjit. Për të mundur përballjen në periudhën afatmesme me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian, Shqipëria duhet të forcojë infrastrukturën e saj fizike dhe kapitalin njerëzor dhe të ndjekë reforma të mëtejshme strukturore.

Prapavija e Shqipërisë në rrugën e zbatimit të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është pozitive në përgjithësi.

Shqipëria do të jetë në pozitë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në afat të mesëm në shumicën e fushave të *acquis*, me kusht që procesi i shtrirjes vazhdon dhe se përpjekje të konsiderueshme dhe të vazhdueshme të mëtejshme bëhen për të siguruar implementimin dhe zbatimin e legjislacionit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet fushave të lëvizjes së lirë të mallrave, të drejtës së pronësisë intelektuale, shoqërisë së informacionit dhe medieve, bujqësisë dhe zhvillimit rural, sigurisë së ushqimit, politikave veterinare dhe fito-sanitare, peshkimit, politikës së transportit, politikës sociale dhe të punësimit, politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore, gjyqësorit dhe të të drejtave themelore të njeriut, drejtësisë, lirisë dhe sigurisë së kontrollit financiar. Përputhje e plotë me *acquis* në fushën e mjedisit mund të arrihet vetëm në afat të gjatë dhe do të kërkojë shkallë të konsiderueshme të investimeve, megjithatë përpjekjet në këtë fushë duhet të përshpejtohen.

Anëtarësimi i Shqipërisë do të ketë një ndikim të kufizuar të përgjithshëm mbi politikën e Bashkimit Evropian dhe nuk do të ndikojë në kapacitetin e Bashkimit Evropian për të ruajtur dhe rritur zhvillimin e vet.

Komisioni konsideron që negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian duhet të jenë të hapura me Shqipërinë pasi vendi të ketë arritur shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti kriteret politike të Kopenhagës që kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë veçanërisht demokracinë dhe sundimin e ligjit. Në këtë drejtim, Shqipëria ka nevojë në veçanti për të përmbushur prioritetet e mëposhtme kryesore:

- Sigurimi i funksionimit të duhur të Parlamentit në bazë të një dialogu konstruktiv dhe të qëndrueshëm politik midis të gjitha partive politike.

- Miratimi i ligjeve në pritje që kërkojnë një shumicë të përforcuar në Parlament.

- Emërimi i Avokatit të Popullit, dhe sigurimi i një seance të rregullt të dëgjimit dhe procesit të votimit në Parlament për emërimet e gjykatës kushtetuese dhe të lartë.

- Ndryshimi i kornizës legislative për zgjedhjet në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR

- Të siguruarit që zgjedhjet janë kryer në përputhje me standardet Evropiane dhe ndërkombëtare.

- Të gjithë hapat thelbësor në reformën e administratës publike, duke përfshirë edhe amendamentet për ligjin e shërbimit civil dhe forcimin e Departamentit të Administratës Publike, me qëllim të rritjes së profesionalizimit dhe depolitizimit të administratës publike dhe për të përforcuar një qasje transparente, të bazuar në merita për emërimet dhe promovimet.

- Sundimi i forcimit të ligjit nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të një strategjie të reformës për gjyqësorin, duke siguruar pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e institucioneve gjyqësore.

- Zbatimi efikas i strategjisë dhe planit të veprimit të qeverisë kundër korrupsionit, mënjanimi i pengesave ndaj hetimeve, në mënyrë të veçantë për gjyqtarët, ministrat dhe anëtarët e parlamentit, zhvillimi i një prapavije solide të hetimeve proaktive, ndjekja penale dhe dënimet në rastet e korrupsionit në të gjitha nivelet.

- Forcimi i luftës kundër krimit të organizuar, bazuar në vlerësimin e kërcënimit dhe hetimin proaktiv, rritjen e bashkëpunimit me partnerët rajonalë dhe të BE-së dhe koordinimi më i mirë i agjencive të zbatimit të ligjit. Zhvillimi i një prapavije solide në këtë fushë.

- Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i një strategjie kombëtare dhe planit të veprimit për të drejtat e pronësisë pas konsultimeve të gjera të palëve të interesuara dhe duke marrë parasysh ligjin zakonor të GjEDNj-së, kjo duhet të mbulojë kostot e proceseve të rivendosjes, kompensimit dhe legalizimit.

- Marrja e masave konkrete për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sidomos për gratë, fëmijët dhe Romët, dhe për zbatimin efikas të politikave anti-diskriminuese.

- Ndërmarrja e masave shtesë për të përmirësuar trajtimin e të ndaluarve në stacionet e policisë, në paraburgim dhe në burgje. Forcimi i gjyqësorit për ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit dhe për të përmirësuar zbatimin e rekomandimeve të Ombudspersonit në këtë fushë.

Shqipëria inkurajohet që të vazhdojë angazhimin e saj konstruktiv në bashkëpunim rajonal dhe në forcimin e marrëdhënieve bilaterale me vendet fqinje. MSA-ja duhet të vazhdohet të zbatohet pa probleme, në këtë kontekst, është e nevojshme vëmendje e duhur për respektimin e afateve për zotimet e saj. Përveç kësaj, vendi inkurajohet fuqishëm që të vazhdojë forcimin e kapaciteteve të saja administrative në të gjitha fushat. Bashkëpunimi me shoqërinë civile ka nevojë të përmirësohet. Shqipëria ka nevojë për shpërndarjen e burimeve të përshtatshme për të garantuar funksionimin efikas të institucioneve për të drejtat e njeriut dhe për të përmirësuar përpjekjet në fushën e mbrojtjes së minoriteteve. Nevojitet forcimi i lirisë së medie dhe i pavarësisë së saj, si dhe adresimi i përhapjes së ndikimeve politike.

Komisioni do të monitorojë progresin e reformave të nevojshme brenda kornizës institucionale të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet përmes instrumentit

financiar IPA. Komisioni do të paraqesë një raport mbi progresin e Shqipërisë në paketën e zgjerimit të vitit 2011. Ky raport do të përqendrohet në veçanti në zbatimin e prioriteteve kryesore që duhet të adresohen për hapjen e negociatave për anëtarësim.

SHTOJCA 2

Konkluzionet e Raportit të Progresit për Kroacinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Serbinë dhe Kosovën, Turqinë dhe Islandën

Kroacia

Kroacia vazhdon të përmbushë kriteret politike. Progres është arritur në shumë fusha, duke përfshirë fushën e sundimit të ligjit. Megjithatë, përpjekjet duhet të vazhdojnë dhe intensifikohen më tej në mënyrë të veçantë në fushën e reformës gjyqësore dhe administrative, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve si dhe kthimin e refugjatëve.

Demokracia dhe sundimi i ligjit janë forcuar më tej. Qeveria dhe parlamenti kanë vazhduar të funksionojnë në mënyrë efektive. Megjithatë, kapacitetet e parlamentit për të shqyrtuar procesin legjislativ kanë nevojë për zhvillim. Reforma gjyqësore ka vazhduar, por sfida të mëdha mbeten, sidomos në lidhje me pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit.

Ka pasur progres të kufizuar në fushën e reformës së administratës publike. Ligji mbi procedurat e përgjithshme administrative ka hyrë në fuqi si dhe është miratuar strategjia e zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe plani i veprimit për shërbimin civil. Megjithatë, administrata publike, vazhdon të vuajë nga disa mangësi, duke përfshirë edhe procedurat e ndërlikuara administrative, politizimin dhe menaxhimin e dobët të burimeve njerëzore. Në mënyrë që të arrihen rezultate konkrete, nevojitet angazhim më i fuqishëm politik dhe përmirësim i koordinimit midis aktorëve kyç në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

Reforma gjyqësore ka vazhduar. Rastet e pazgjidhura janë reduktuar në gjykata dhe pavarësia e gjyqësorit është përforcuar me anë të ndryshimeve kushtetuese. Megjithatë, rezultatet kryesore të pritshme të procesit të reformës ende nuk kanë dalë në pah. Sfidat qëndrojnë në veçanti në lidhje me zbatimin e kriterëve transparente për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, reduktimin e mëtejshëm të numrit të rasteve, kohëzgjatjen e procedurave dhe zbatimin e vendimeve. Është arritur një progres në trajtimin e rasteve të krimeve të luftës, përfshirë rishikimin e vendimeve të diskutueshme nga vitet 1990. Megjithatë, problemi i mosndëshkimit mbetet prezent, sidomos për krimet e kryera kundër serbëve etnikë, shumë prej të cilave nuk janë hetuar siç duhet.

Ka pasur progres të mirë në *luftën kundër korrupsionit*. Zbatimi dhe koordinimi i përgjithshëm i përpjekjeve kundër korrupsionit është përmirësuar. Zyra për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar vazhdon të jetë aktive dhe është duke u vazhduar me paraqitjen e padive në disa raste të rëndësishme. Numri i vendimeve gjyqësore është rritur. E drejta e qasjes në informata nga organet publike është përfshirë në kushtetutë. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha. Strukturat rishtazi të përmirësuar ligjore dhe administrative duhet të testohen plotësisht në praktikë, veçanërisht aftësia e gjykatave për të përballuar numrin në rritje dhe kompleksitetin e çështjeve. Prapavija efikase e hulumtimeve, ndjekjeve penale dhe vendimeve gjyqësore mbetet për t'u krijuar, veçanërisht për korrupsionin në nivelin e lartë. Ka pasur pak progres në parandalimin e konflikteve të interesit. Ka pasur

përmirësim të kufizuar në zbatimin e qasjes në legjislacionin e informacionit. Mbesin mangësi në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

Disa përparime janë arritur në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve. Mbrojtja e të drejtave të njeriut është siguruar në përgjithësi, por disa sfida të caktuara të rëndësishme mbeten sa i përket zbatimit. Sa i përket qasjes në drejtësi, ka filluar një reformë e konsiderueshme e sistemit të drejtësisë administrative. Tani është duke u dhënë ndihmë ligjore falas që financohet nga shteti. Megjithatë, procedurat janë të komplikuar dhe niveli i përgjithshëm i ndihmës së dhënë është i ulët. Sa i përket sistemit të burgjeve, masa legjislative janë ndërmarrë për të përmirësuar kushtet e burgjeve nëpërmjet vendosjes së parashikuar të një sistemi të provës. Burgjet mbeten të mbipopulluara dhe ofrojnë mbrojtje joadekuate shëndetësore. Sa i përket keqtrajtimit, Ombudspersoni vazhdon të pranojë ankesa në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës nga policia.

Liria e shprehjes, duke përfshirë lirinë dhe pluralizmin e medieve është parashikuar me ligji dhe respektohet në përgjithësi. Megjithatë, redaktorët dhe gazetarët vazhdojnë të raportojnë presion politik. Problemet me pavarësinë e medieve lokale mbeten.

Ka pasur progres të kufizuar në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Pozita e gruas në tregun e punës nuk ka ndryshuar dukshëm dhe niveli i papunësisë së femrave mbetet i lartë. Ombudspersoni për Femijët është bërë më aktiv në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, ky organ ka mungesë të resurseve të përshtatshme për të zbatuar në tërësi mandatin e vet.

Ka pasur pak progres në lidhje me shtresat në nevojë dhe personat me aftësi të kufizuara. Kapacitetet e Zyrës së Ombudspersonit për Personat me Aftësi të Kufizuara janë duke u forcuar, sidomos në pikëpamje të shtrirjes së përfaqësimit në rajone. Megjithatë, ka mungesë të informacionit për të drejtat dhe detyrimet në fushën e mirëqenies sociale si dhe të kujdesit shëndetësor dhe të pensioneve. Kriteret për krijimin e të drejtave nuk janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtat e veçanta janë të fragmentuara. Tranzicioni prej kujdesit institucional drejt shërbimeve të përkujdesit të bazuara në komunitet kanë përparuar ngadalë.

Disa hapa janë ndërmarrë për të rritur ndërgjegjësimin për ligjin e ri kundër diskriminimit. Megjithatë, njohuritë lidhur me mundësitë e këtij ligji për autoritetet dhe qytetarët janë të kufizuara dhe vetëm një numër i vogël i ankesave mbi diskriminimin kanë arritur në gjykata. Nuk ka pasur ndonjë progres sa i përket legjislacionit të krimit të urrejtjes, edhe pse implementimi është në një fazë të hershme.

Ka pasur pak progres në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave kulturore. Fokus më i madh në çështjet e pakicave mund të raportohet në një kontekst të përmirësimit të marrëdhënieve në rajon, sidomos ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë. Dispozitat kushtetuese mbi pakicat janë forcuar. Vëmendja vazhdon të përqendrohet në minoritetin Rom sidomos me përmirësime në arsimin parashkollor. Niveli i financimit në dispozicion për organizatat e minoriteteve është reduktuar pak, pavarësisht nga masat e kursimeve financiare. Megjithatë, për pakicat mbetin shumë probleme. Kroacia ka nevojë të vazhdojë të nxisë frymën e tolerancës ndaj pakicës serbe. Kroacia gjithashtu duhet të ndërmarrë masat e duhura për të mbrojtur personat të cilët ende mund t'iu nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës. Minoriteti Rom përballet me kushte veçanërisht të vështira të jetesës dhe sfida mbetin në fushat e arsimit, mbrojtjes sociale, kujdesit shëndetësor, punësisimit dhe qasjes në dokumente personale. Pakicat vazhdojnë të përballen me vështirësi në fushën e punësisimit,

si në aspektin e nën-përfaqësimit në administratën shtetërore, gjyqësor dhe polici, si dhe në sektorin e gjerë publik.

Ka pasur pak progres në lidhje me refugjatët. Refugjatët vazhdojnë të kthehen në Kroaci. Ka vazhduar sigurimi i strehimit për mbajtësit paraprak të të drejtave të banimit dhe qiramarrjes. Një plan i reviduar i veprimit është miratuar për të zbatuar në mënyrë të përshtetshme planet e vonuara të qeverisë të vitit 2009 për kujdesin e strehimit, kjo është bërë me qëllim të zbatimit të plotë në vitin 2011. Është arritur progres në rindërtimin e shtëpive të dëmtuara. Është zvogëluar në masë të konsiderueshme numri i ankesave të grumbulluara kundër kërkesave të refuzuara për ndihma të rindërtimit. Zbatimi i vendimit për validim të të drejtave ndaj pensionit ka vazhduar. Megjithatë, progresi drejt plotësimit të objektivave të strehimit 2009 ka qenë i ngadalshëm. Disa mijëra aplikacione për kujdesin e strehimit mbetet të përpunohen në tërësi si dhe njësitë e banimit të vihen në dispozicion të refugjatëve të kthyer. Një numër i lartë i ankesave për rindërtimin e shtëpive kanë mbetur pezull. Përpjekje duhet të bëhen për të krijuar kushtet e përshtatshme për kthimin e përhershëm të refugjatëve.

Sa i përket çështjeve rajonale dhe detyrimeve ndërkombëtare, Kroacia vazhdon të bashkëpunojë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY). Forca e posaçme e ngritur nga qeveria duhet të vazhdojë punën e saj për të gjetur ose për të përcaktuar fatin e dokumenteve të artillerisë së humbur që kërkohet nga Zyra e Prokurorit të ICTY-së. Një nxitje e re është dhënë në procesin e deklarimit të Sarajevës, pas takimit Ministror të mbajtur në Beograd në mars të vitit 2010. Kjo ka sjellë së bashku Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi dhe Serbinë të cilat kanë rënë dakord të punojnë së bashku për të sqaruar statistikat e refugjatëve. Vendet janë angazhuar edhe vetë për të punuar drejt zgjidhjes së një numri të çështjeve të pazgjidhura deri në fund të vitit.

Kroacia ka vazhduar të marrë pjesë aktive në nismat rajonale, duke përfshirë Procesin e Evropës Juglindore (SEECP), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR) dhe Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Presidenti Kroat ka marrë një qasje pro-aktive në lidhje me bashkëpunimin rajonal. Vazhdojnë të zhvillohen marrëdhëniet bilaterale me vendet e tjera në zgjerim dhe fqinjët e shteteve anëtare të BE-së duke përfshirë edhe Serbinë. Marrëdhëniet me Slloveninë janë përmirësuar me nënshkrimin e Marrëveshjes për arbitrazhin ndërkombëtar të kufijve.

Ekonomia e Kroacisë është prekur rëndë nga kriza globale ekonomike dhe financiare. Vendi ka rënë në recesion në tremujorin e parë të vitit 2009 dhe nuk ka pasur shenja të qarta të një rikuperimi gjer në mesin e vitit 2010. Papunësia, deficitin publik dhe borxhet janë rritur ndjeshëm. Borxhi i jashtëm u rrit më tej dhe mbetet një dobësi kryesore e ekonomisë. Stabiliteti monetar është ruajtur nga politikat e bankës qendrore dhe sektori financiar relativisht mirë i ka bërë ballë krizës.

Sa i përket kritereve ekonomike, Kroacia është një ekonomi funksionale e tregut. Kroacia duhet të jetë në gjendje të përballet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian, me kusht që zbaton në mënyrë të plotë programin e saj të reformës me vendosmëri për të reduktuar dobësitë strukturore.

Është ruajtur konsensusi i gjerë politik në bazat e një ekonomie të tregut. Programi i rivendosjes ekonomike i ka dhënë politikave ekonomike një orientim afat-mesëm. Dobia e programit për rritje dhe konkurrencë ndërkombëtare varet nga zbatimi i tij efektiv. Duke pasur parasysh kufizimet ekzistuese, politika makroekonomike në përgjithësi ka qenë e përshtatshme për të trajtuar pasojat e krizës globale

ekonomike dhe financiare. Politika monetare arriti të ruajë kursin e këmbimit dhe stabilitetin financiar, ndërsa janë zbutur presionet e likuiditetit. Deficiti i llogarisë rrjedhëse është pakësuar si pasojë e recesionit dhe presionet inflacioniste janë ulur edhe më tej. Sektori bankar mbetet rezistues ndaj tronditjeve.

Megjithatë, reformat strukturore në përgjithësi kanë avancuar me një ritëm shumë të ngadalshëm, ngjashëm ka ndodhur në lidhje me privatizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve që kanë shkaktuar humbje. Tregu i punës ka mbetur shumë i ngurtë, me punësim të ulët dhe norma të pjesëmarrjes në rënie të mëtejme gjatë recesionit. Në fushën fiskale, autoritetet kanë bërë përpjekje të kufizuara për të përmbajtur deficitin në rritje dhe për të rritur efikasitetin e shpenzimeve publike. Transferimi i pagesave sociale ka mbetur i lartë dhe jo mjaft i qëlluar ku një numër i ndërmarrjeve shtetërore ka vazhduar të marrë mbështetje nga shteti përmes subvencioneve direkte dhe indirekte si dhe garancive. Për arritjen e qëndrueshmërisë fiskale afat-mesme, sfida kryesore mbesin përmirësimi i procesit dhe disiplinës buxhetore si dhe rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike. Klima e investimeve ka vazhduar të vuajë nga një barrë e rëndë rregulluese dhe e taksave të shumta para-fiskale.

Kroacia ka përmirësuar aftësinë e vet për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Përgatitjet për përmbushjen e kërkesave të BE-së kanë vazhduar të përparojnë mirë dhe ekziston një shkallë e lartë e nënshtrimit ndaj rregullave të BE-së në sektorët më të mëdhenj. Në shumicën e fushave ka pasur progres të mëtijshëm, përfshirë edhe kapitujt për të cilët niveli i nënshtrimit tashmë është i lartë. Përpjekje shtesë janë të nevojshme në zona të caktuara për forcimin e kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e duhur të *acquis*.

Progres i mirë është arritur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, përafrimi me *acquis* në këtë kapitull është i avancuar. Megjithatë, përpjekje të mëtijshme janë të nevojshme, veçanërisht për vlerësimin e konformitetit, metrologjinë dhe mbikëqyrjen e tregut. Kroacia ka nevojë për të përfunduar harmonizimin me *acquis* dhe forcimin e kapaciteteve të zbatimit. Progres i mirë mund të raportohet në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve, dhe një nivel i kënaqshëm i nënshtrimit në aspektin ligjor është arritur. Përpjekje shtesë janë të nevojshme për të forcuar, në veçanti, koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Është arritur progres në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, në mënyrë të veçantë për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe për shërbime postare. Nënshtrimi i përgjithshëm ndaj *acquis* është i kënaqshëm. Rritja e përpjekjeve është e nevojshme për të përfunduar nënshtrimin, në mënyrë të veçantë në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale dhe transpozimin e Direktivës së Shërbimeve. Puna në përmirësimin e kapaciteteve administrative duhet të jetë e vazhdueshme.

Progres i mëtijshëm është arritur në përafrimin me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të kompletuar liberalizimin e lëvizjeve të kapitalit dhe për të konsoliduar zbatimin e legjislacionit kundër pastrimit të parave.

Progres i mirë mund të raportohet në prokurimet publike, në veçanti në përmirësimin e kapaciteteve të aktorëve kryesorë për të bashkërenduar dhe zbatuar politikën publike të prokurimit. Duhet të përmirësohet më tutje mundësia për të zbatuar ligjin në mënyrë efikase në të gjitha nivelet e sistemit të prokurimit.

Disa përparime mund të raportohen në kapitullin e ligjit mbi shoqëritë tregtare. Harmonizimi me *acquis* është në rrugën e duhur. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në fushën e auditimit.

Progres mund të raportohet në fushën e së drejtës së pronësisë intelektuale. Harmonizimi me *acquis* ka arritur një nivel shumë të lartë dhe mund të raportohet progres gjatë zbatimit. Vetëdija e përgjithshme për të drejtat e pronësisë intelektuale mbetet për t'u forcuar.

Përparim i konsiderueshëm është arritur në politikën e konkurrencës, në veçanti për finalizimin e procedurave të tenderimit për ristrukturimin e ndërtimit. Në përgjithësi, është arritur një nivel i mirë i nënshtrimit. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme janë ende të nevojshme për të miratuar në përputhje me *acquis* planet e ristrukturimit të ndihmës shtetërore për kantieret detare në vështirësi, për të përmirësuar prapavijën dhe gjithashtu për të përmirësuar prapavijën e zbatimit të Agjencisë Kroate për Konkurrencën kundrejt karteleve si dhe për të përmirësuar kapacitetet e saj administrative në veçanti në fushën e anti-trustit. Duhet të përfundohet nënshtrimi ndaj Aktit Kroat mbi Transmetimin. Ristrukturimi Kombëtar për industrinë e çelikut gjithashtu duhet të azhurnohet.

Progres thelbësor mund të raportohet në fushën e shërbimeve financiare, si për rreshtimin e legjislacionit ashtu edhe për forcimin e resurseve administrative. Megjithatë, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative të rregullatorëve është i nevojshëm.

Kroacia ka bërë përparim të rëndësishëm në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias dhe ka arritur një nivel të lartë të harmonizimit me *acquis*. Megjithatë, përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të forcuar kapacitetet e dy rregullatorëve kombëtar për të zbatuar kornizën ligjore të saktë. Liberalizimi i të gjitha segmenteve të tregjeve të komunikimeve elektronike duhet të jetë një gjë e qëndrueshme.

Progres i mirë mund të raportohet në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në veçanti në krijimin dhe zbatimin e agjencisë paguese dhe të administratës së integruar si dhe në sistemin e kontrollit dhe mbi organizimin e tregut të përbashkët. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme në këto fusha kyçe të Politikës së Përbashkët Bujqësore duhet të vazhdojnë. Kroacia gjithashtu duhet të harmonizojë në mënyrë të plotë sistemin për mbështetje të bujqësisë me *acquis* dhe për të rritur kapacitetet absorbuese për fondet e zhvillimit rural.

Progres i mirë është arritur në nënshtrimin ndaj fushës së sigurisë ushqimore, politikave veterinarë dhe fitosanitare, në mënyrë të veçantë me miratimin dhe zbatimin e legjislacionit sekondar. Transpozimi i *acquis* është avancuar në të gjithë sektorët. Progres i rëndësishëm është arritur me miratimin e programit kombëtar për përmirësimin e objekteve për ushqimin me origjinë shtazore dhe nënproduktet e kafshëve. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme në lidhje me zbatimin e programit, si dhe për forcimin e kapaciteteve administrative dhe të kontrollit, si dhe ngritjen e posteve të inspektimit kufitar.

Kroacia ka bërë përparim të mirë në përafrimin me *acquis* në fushën e rritjes së peshqve. Përgatitjet për zbatimin e politikave të rritjes së peshqve janë avancuar mirë. Kroacia duhet të përmirësojë zbatimin e legjislacionit, në veçanti në lidhje me menaxhimin, inspektimin dhe kontrollimin e flotave si dhe të politikave strukturore.

Progres i mëtëjshëm është arritur në fushën e transportit. Në përgjithësi, niveli i nënshtrimit është i mirë. Megjithatë nevojitet përfundimi i nënshtrimit në sektorin e aviacionit. Përpjekje shtesë ende janë të nevojshme për implementimin dhe zbatimin e *acquis*.

Progres i mëtëjshëm është arritur në kapitullin e energjisë, ku niveli i nënshtrimit është i lartë. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për rritjen e performancës së administratës dhe pavarësisë së autoriteteve rregullative në sektorin e energjisë.

Progres është arritur në tatueshmëri, në mënyrë të veçantë në kapacitetet operationale dhe të kompjuterizimit. Legjislacioni i Kroacisë në fushën e tatimeve direkte dhe indirekte është përgjithësisht në përputhje me *acquis*. Megjithatë, nënshtrim i mëtëjmë është i nevojshëm, sidomos në fushat e TVSH-së dhe akcizës. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për forcimin e kapaciteteve administrative, përfshirë në ndërlidhje me TI-në.

Ka pasur progres të mëtëjshëm në fushën e politikës ekonomike dhe monetare, ku, në përgjithësi, përafrimi me *acquis* është i plotë.

Sa i përket statistikave, progres i konsiderueshëm është arritur në modernizimin e infrastrukturës statistikore. Një nivel i mirë i nënshtrimit është arritur. Përpjekjet duhet të vazhdojnë për të lidhur statistikat Kroate tërësisht me kërkesat e BE-së.

Progres i mirë është arritur me politikat sociale dhe në punësim. Ekziston një nivel i mirë i nënshtrimit ndaj *acquis*. Megjithatë, disa boshllëqe mbetet të harmonizohen me legjislacionin, sidomos në transpozimin e direktivave të ligjit të punës, dhe në fushën e anti-diskriminimit dhe barazisë gjinore. Kapacitetet administrative kërkojnë forcim të mëtëjshëm.

Kroacia ka arritur përparim në politikat e ndërmarrjeve dhe ato industriale, posaçërisht në lidhje me parimet e politikës dhe të instrumenteve. Harmonizimi me *acquis* është shumë i avancuar. Përpjekje të vazhdueshme të mëtëjshme duhet të përqendrohen në përmirësimin e mjedisit biznesor. Përpjekjet për ristrukturimin e industrive të çelikut dhe në veçanti të ndërtimit të anijeve duhet të ndiqen.

Kroacia ka arritur përparim të mëtëjshëm në zhvillimin e rrjeteve trans-Evropiane. Harmonizimi me *acquis* ka përfunduar.

Progres i mirë është arritur në politikat rajonale dhe koordinim të instrumenteve strukturore, sidomos në përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe përcaktim të institucioneve dhe mekanizmave për zbatimin e politikës së kohezionit të BE-së, si dhe rekrutimin dhe trajnimin e mëtëjmë të stafit. Përgatitjet e Kroacisë për zbatimin e politikës së kohezionit të BE-së janë relativisht të avancuara. Kroacia ka nevojë për të përfunduar përgatitjet e saj duke u fokusuar në krijimin e një linje të pjekur projektsh dhe thithje të fondeve.

Kroacia ka arritur përparim të mirë në gjyqësor dhe të drejtat themelore. Reforma në sistemin gjyqësor ka vazhduar me miratimin e legjislacionit të ri, forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe uljen e mëtëjshme të rasteve të prapambetura. Megjithatë, reforma gjyqësore mbetet një punë e madhe dhe sfida të mëdha kanë mbetur, sidomos në lidhje me pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Përpjekjet kundër korrupsionit janë rritur me disa rezultate pozitive, por korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha. Mbetet të krijohet një prapavijë e hulumtimeve, ndjekjeve penale dhe vendimeve gjyqësore

efikase, veçanërisht për korrupsionin e nivelit të lartë. Masat parandaluese të tilla si transparenca e përmirësuar e shpenzimeve publike duhet të forcohen. Mbrojtja e të drejtave themelore është forcuar, por duhet të përmirësohet në praktikë, sidomos për pakicat dhe refugjatët.

Kroacia ka arritur përparim thelbësor në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Sistemi i azilit është përmirësuar dukshëm, por vëmendja duhet t'i kushtohet integritetit të personave që i është dhënë mbrojtje në Kroaci dhe për mbrojtjen e të miturve në mesin e migruesve të parregullt. Progres i mirë është arritur në fushën e vizave. Megjithatë, harmonizimi me *acquis* për vizat duhet të vazhdojë. Është arritur progres në fushën e kufijve të jashtëm. Megjithatë, disa aspekte të planit të veprimit për menaxhim të integruar të kufijve duhet të ndryshohen dhe duhet të përshpejtohet përmirësimi i pajisjeve. Përparim i rëndësishëm është arritur në fushën e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale. Progresi ka vazhduar edhe në politikën e vazhdueshme kundër narkotikëve.

Përparimi në fushat e shkencës dhe të hulumtimit ka vazhduar, por është ngadalësuar si pasojë e krizës ekonomike dhe financiare. Nevojiten përpjekje për të forcuar më tej kapacitetet hulumtuese, për të siguruar trajnime, dhe për të rritur investimet në kërkime nga ana e industrisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Progres i mëtëjshëm është arritur në lidhje me *acquis* në fushën e arsimit dhe kulturës. Ekziston një nivel i mirë i nënshtrimit. Kroacia ka nevojë të vazhdojë përpjekjet e saj për t'u përgatitur për menaxhimin e programeve të mësimi gjatë tërë jetës si dhe të rinjve në veprim.

Progres i mirë është arritur në kapitullin e mjedisit sa i përket nënshtrimit dhe zbatimit të legjislacionit. Duhet të përfundohet nënshtrimi ndaj legjislacionit në fushën e cilësisë së ujit dhe gjithashtu në një masë të caktuar ndaj legjislacionit për ndryshimin e klimës. Zbatimi i *acquis* horizontale dhe bashkëpunimi me organizatat joqeveritare aktive në fushën e mjedisit duhet të përmirësohet. Në përgjithësi, përgatitjet e Kroacisë janë afër përfundimit. Kroacia ka nevojë për të vazhduar forcimin e kapaciteteve administrative, sidomos në nivelin lokal.

Ka pasur progres të mirë në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve dhe të shëndetit. Një nivel i mirë i nënshtrimit është arritur. Përpjekje të vazhdueshme janë të domosdoshme për të forcuar më tej kapacitetet administrative.

Progres i mirë është arritur në lidhje me unionin doganor. Legjislacioni doganor i Kroacisë është në përputhje me *acquis* në një masë të madhe. Kroacia ka vazhduar të arrijë progres në fushën e TI-së, sidomos në ndërlidhshmëri. Është i nevojshëm progres i mëtëjshëm në drejtim të heqjes së mospërputhjeve të fundit në legjislacionin e Kroacisë, zbatimin e Strategjisë Anti-Korrupsion dhe përgatitjen për ndërlidhshmëri të TI-së.

Disa përparime janë arritur në fushën e marrëdhënieve të jashtme. Kroacia ka arritur një nivel të avancuar të nënshtrimit dhe po vazhdon të koordinojë dhe t'i përafrojë qëndrimet e saj në forumet ndërkombëtare. Megjithatë, Kroacia ka nevojë për t'i kushtuar vëmendje të plotë nënshtrimit ndaj detyrimeve të veta ndërkombëtare kur t'i qaset masave mbrojtëse. Burime të mëtëjme duhet të ndahen për politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare.

Kroacia ka arritur përparim të mëtëjshëm në fushën e sigurisë së jashtme, dhe të politikës së mbrojtjes. Ajo ka vazhduar të marrë pjesë në disa misione ushtarake dhe civile të BE-së. Në përgjithësi, Kroacia ka

arritur një nivel të lartë të nënshtimit. Kroacia ka nevojë të vazhdojë zbatimin e forcimit dhe fuqizimit të kontrollit të armëve, duke përfshirë transparencën e informacionit që lidhen me armët.

Progres mund të raportohet në fushën e kontrollit financiar. Pavarësia e Zyrës shtetërore të auditimit është përforcuar. Përpjekjet tani duhet të fokusohen në qëndrueshmërinë e reformave. Organet e përfshira në strukturën e Koordinimit kundër mashtrimit duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për zbatimin efikas të strategjisë kundër mashtrimit.

Është arritur progres i mëtëjshëm në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore. Kapacitetet institucionale për zbatimin e rregullave mbi resurset vetanake janë zhvilluar më tej. Kroacia ka arritur një nivel të mirë të përafrimit me *acquis* dhe kapaciteteve për zbatimin e *acquis*, përveç në rastin e tarifave të sheqerit. Kroacia ka nevojë për të rritur më tej aftësinë e saj të koordinimit.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdon të përmbushë në masë të mjaftueshme kriteret politike. Pas reformave të konsiderueshme të përparimit të vitit 2009 progres i mëtëjshëm është arritur edhe pse me një ritëm të pabarabartë. Në përgjithësi, koalicioni qeverisës është stabil dhe nuk ka bashkëpunim mes forcave politike. Disa përparime janë arritur sa i përket reformës së parlamentit, policisë, gjyqësisë, administratës publike dhe respektimit si dhe mbrojtjes së minoriteteve. Megjithatë, përpjekje të mëtëjshme janë të nevojshme në shumicën e fushave të lidhura me kriterin politik, në veçanti shqetësimet e rëndësishme të vazhdueshme sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, reformës së administratës publike dhe lirisë së të shprehurit në media. Dialogu politik duhet të forcohet.

Marrëveshja kornizë e Ohrit mbetet një element thelbësor për demokracinë dhe sundimin e ligjit në vend. Ka pasur pak progres në zbatimin e ligjit për gjuhët si dhe në decentralizimin dhe përfaqësimin e barabartë. Përpjekje të vazhdueshme, nëpërmjet dialogut janë të nevojshme për të përmbushur objektivat e Marrëveshjes dhe për të siguruar zbatimin e saj të plotë.

Ka pasur progres të mëtëjshëm në reformën e parlamentit. Ndryshimet në rregullat e procedurës për të mbrojtur të drejtat e opozitës janë miratuar. Parlamenti mori masa për forcimin e kapaciteteve institucionale, në mënyrë të veçantë nëpërmjet krijimit të Institutit parlamentar. Megjithatë, dialogu për marrëdhëniet ndër-etnike u pengua nga dështimi i komisionit përkatës parlamentar që të takohet rregullisht.

Partnerët në koalicionin qeveritar kanë ruajtur bashkëpunimin konstruktiv. Ata janë të angazhuar për reforma në përgatitjen e vendit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Megjithatë, më shumë dialog nevojitet për çështjet që lidhen me marrëdhëniet ndër-etnike. Përpjekje shtesë janë të nevojshme për të çuar përpara procesin e decentralizimit në përputhje me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Korniza financiare për pushtetin vendor duhet të jetë më transparente dhe e barabartë. Bashkëpunimi i qeverisë me Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian duhet të zhvillohet më tej.

Ka pasur pak progres në lidhje me funksionimin e administratës publike. Ligji për nëpunësit publik është miratuar. Ligji për punët e brendshme lidhur me reformën e policisë ka hyrë në fuqi dhe legjislacioni për zbatim është miratuar. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme të mëtëjshme janë të nevojshme për të siguruar profesionalizëm, transparencë dhe pavarësi të shërbimit civil. Nuk ka pasur ndërhyrje të

panevojshme politike në rekrutimet dhe promovimet në të gjitha nivelet e administratës publike. Korniza ligjore duhet të përmirësohet më tej, në veçanti sa i përket rekrutimit të stafit të bazuar në merita. Procesi i konvertimit të një numri të madh të posteve të përkohshme në të përhershme në shumë raste nuk ka përfshirë rekrutimin konkurrues dhe të bazuar në merita.

Është arritur progres i kufizuar në reformën gjyqësore. Efikasiteti i gjykatave është përforcuar përmes menaxhimit të përmirësuar buxhetor. Megjithatë, ka shqetësime në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit: nuk ka pasur progres të mëtijshëm për të siguruar që dispozitat ekzistuese ligjore zbatohen në praktikë. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të diplomuarit nga Akademia për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve të kenë përparësi në rekrutime të reja.

Progres është arritur në fushën e politikave kundër korrupsionit. Janë kryer operacione të mëdha të policisë duke shfrytëzuar masa të posaçme hulumtuese. Përderisa korniza legjislative dhe institucionale është vendosur në përgjithësi, duhet të përforcohet prapavija e dënimeve të suksesshme për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Dispozitat ekzistuese të deklarimit të pasurisë, konfliktit të interesit dhe të financimit të partive politike nuk janë zbatuar në mënyrë efikase. Baza e burimeve të Komisionit Shtetëror kundër korrupsionit duhet të sigurohet. Korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të paraqesë një problem serioz.

Korniza ligjore dhe institucionale për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e pakicave është vendosur dhe të drejtat civile dhe politike janë respektuar gjerësisht. Megjithatë, garancitë ekzistuese ligjore duhet të zbatohen plotësisht.

Reparti gjysmë i hapur i burgut Idrizovë, ku kushtet kanë qenë degraduese dhe çnjerëzore është mbyllur. Megjithatë, strategjia për adresimin e mangësive të mbetura serioze lidhur me kushtet e burgut po ecën ngadalë. Mbikëqyrja e agjencive për zbatimin e ligjit mbetet e paplotë. Në lidhje me lirinë e të shprehurit ekzistojnë shqetësime që janë duke u ngritur për ndërhyrje politike në media dhe presion të padrejtë mbi gazetarët. Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të politikave mbetet e kufizuar.

Ombudspersoni ka vazhduar të jetë pika kryesore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Ngarkesa e tij është rritur gjatë periudhës raportuese. Megjithatë, përbindja e rekomandimeve të pranuar nga organet publike ka rënë. Autoriteti dhe burimet e Ombudspersonit duhet të forcohen.

Dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike kryesisht janë vendosur. Zbatimi i strategjisë kundër dhunës në familje ka vazhduar. Është arritur marrëveshja mbi anëtarësinë e Këshillit Ekonomik dhe Social, duke lehtësuar kështu një dialog social. Është miratuar një draft ligj kundër diskriminimit. Megjithatë, orientimi seksual si bazë për diskriminim është lënë jashtë. Një qasje strategjike për mundësi të barabarta duhet të zhvillohet. Përpjekje shtesë janë të nevojshme për të zbatuar kodin penal për të miturit dhe Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve.

Progres është arritur në fushën e respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve dhe të drejtave kulturore. Ka pasur pak progres lidhur me përfaqësimin e barabartë dhe qeveria ka ndërmarrë hapa për të nxitur integrimin ndër-etnik në sistemin e arsimit. Megjithatë, integrimi i bashkësive etnike mbetet i kufizuar dhe dialogu është shumë i nevojshëm për të nxitur besimin sidomos në fushat e kulturës dhe gjuhës. Sa i përket të drejtave të romëve, numri i personave që nuk kanë dokumente personale është reduktuar. Janë

miratuar masa për të shmangur vendosjen e panevojshme të fëmijëve në shkolla speciale. Megjithatë, Romët vazhdojnë të përballen me kushte shumë të vështira të jetesës dhe të diskriminimit.

Lidhur me çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bashkëpunim të plotë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY). Sistemi i brendshëm juridik është duke përpunuar rastet e referuara nga ICTY prapa tek autoritetet kombëtare.

Sa i përket Gjykatës Ndërkombëtare Penale, marrëveshja dypalëshe mbi imunitetin me Shtetet e Bashkuara nuk përputhet me qëndrimet e përbashkëta të BE-së dhe parimet udhëzuese. Vendi ka nevojë t'i nënshtrohet qëndrimit të BE-së.

Vendi ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në nismat për bashkëpunim rajonal, duke përfshirë Procesin e Evropës Juglindore (SEECP), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR) dhe Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA).

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë është një partner aktiv në rajon dhe marrëdhëniet e saj bilaterale me fqinjët janë përgjithësisht të mira. Me përfundimin e demarkacionit të kufirit të saj me Kosovën, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk ka çështje të pazgjidhura kufitare. Megjithatë, marrëdhëniet me Greqinë vazhdojnë të ndikohen negativisht për shkak të çështjes së pazgjidhur të emrit. Vendi është i angazhuar në bisedime për zgjidhjen e tij nën patronazhin e OKB-së. Veprimet dhe deklaratat të cilat mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet e mira fqinjësore duhet të shmangen. Mbledhjet e drejtpërdrejta në nivelet më të larta politike janë hapa pozitivë, edhe pse ky vrull nuk ka shpie ende në rezultate konkrete. Ruajtja e marrëdhënieve të mira fqinjësore, duke përfshirë një zgjidhje të negociuar dhe të pranueshme për çështjen e emrit nën patronazhin e OKB-së mbetet çështje thelbësore.

Ekonomia e Republikës ish-Jugosllave të Maqedonisë është ndikuar negativisht vetëm pak për shkak të ekspozimit të ulët të sektorit financiar ndaj pasurive të dëmshme ndërkombëtare, gjithashtu edhe për shkak të hyrjes së kapitalit të qëndrueshëm privat dhe një sektori të qëndrueshëm publik. Reformat strukturore kanë vazhduar. Megjithatë, papunësia e lartë strukturore, në veçanti në mesin e të rinjve dhe të të paarsimuarve mbetet shkak kryesor i shqetësimeve. Disa përmirësime të vogla janë arritur në lidhje me trajtimin e dobësive institucionale, por mangësitë në sundimin e ligjit vazhdojnë të kenë ndikim negativ në klimën e biznesit.

Sa i përket kriterëve ekonomike, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë vazhdon të arrijë progres të mirë. Në disa zona, ajo ka arritur progres të mëtjshëm për t'u bërë një ekonomi funksionale e tregut, sidomos duke zvogëluar barrierat e hyrjes dhe daljes nga tregu dhe duke përmirësuar kapacitetet e gjykatave për të trajtuar rastet e ndërlidhura me ekonominë. Ajo duhet të jetë në gjendje të përballlet me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në aspektin afat- mesëm, me kusht që fuqishëm të zbatojë programin e saj të reformave për të zvogëluar dobësitë e thella strukturore.

Vendi ka arritur të mbajë një konsensus të gjerë mbi bazat e politikave ekonomike. Politika monetare, faktikisht për shkak të lidhjes së drejtë të regjimit të këmbimit me Euron ka kontribuar në stabilitet makro-ekonomik. Pas një qasjeje zgjëruese në vitin 2008, politika fiskale është orientuar më shumë në stabilitet gjatë vitit 2009. Bilancet e jashtme të vendit janë përmirësuar, duke reflektuar një rikuperim të lehtë të eksporteve, një rënie të importeve për shkak të kërkesës së dobët të brendshme si dhe hyrjes së kapitalit privat të fuqishëm. Privatizimi ka përfunduar në masë të madhe. Liberalizimi i çmimeve dhe

tregtisë është realizuar në përgjithësi. Një përparim i mëtjshëm është arritur në përmirësimin e hyrjes dhe regjistrim në treg si dhe në thjeshtëzimin e kornizës ligjore. Kohëzgjatja e procedurave të falimentimit është ulur më tej dhe regjistrimi i pronës është përfunduar në masë të konsiderueshme. Sektori financiar ka kaluar krizën mirë dhe pavarësia e disa prej agjencive të veta mbikëqyrëse dhe rregulluese është forcuar.

Si rezultat i zgjerimit të deficiteve fiskale, borxhi i sektorit publik është rritur. Cilësia e shpenzimeve publike është përkeqësuar, pjesërisht për shkak të një rënie të shpenzimeve afat-mesme me orientim kapital. Papunësia mbetet shumë e lartë. IHD-të kanë vazhduar të ulen nga një nivel i ulët paraprak. Funksionimi i ekonomisë së tregut mbetet i penguar nga dobësitë institucionale, nga mungesa e stabilitetit në administratë dhe dobësitë në sundimin e ligjit. Mungesa e konsultimeve me palët e interesuara para vendimeve të qeverisë pengon parashikueshmërinë e mjedisit të biznesit. Gjyqësia është ende një agjenci që paraqet pengesë dhe agjencitë rregulluese dhe mbikëqyrëse nganjëherë vazhdojnë të kenë mungesë të pavarësisë dhe burimeve të nevojshme për të përmbushur funksionet e tyre në mënyrë efikase. Shkalla e sigurisë ligjore mbetet e ulët, gjë që ka ndikim negativ në atraktivitetin e vendit për investimet e huaja. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka arritur progres në përmirësimin e aftësisë së saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në veçanti sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, ligjit të shoqërive tregtare, shërbimeve financiare si dhe drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Më pak përparim është arritur në disa fusha tjera të tilla si prokurimi publike, shoqëria e informacionit dhe mediet, si dhe në politikën sociale dhe të punësimit. Në përgjithësi, është arritur përparim i mëtjshëm në përmbushjen e prioriteteve të Partneritetit për Anëtarësim. Megjithatë, përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për forcimin e kapaciteteve administrative për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit. Angazhimet e ndërmarra në procesin e Stabilizim-Asociimit janë zbatuar.

Është arritur progres i mirë në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Një pjesë e *acquis* horizontale dhe sektoriale janë adoptuar. Kapacitetet administrative të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut janë të pamjaftueshme për të siguruar zbatimin e legjislacionit teknik. Progres i pakët mund të raportohet në fushën e lirisë së lëvizjes së punëtorëve. Ka pasur pak progres në fushën e së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime, në veçanti në fushën e shërbimeve postare. Përgatitjet për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale janë në një fazë të hershme. Ka pasur progres të përgjithshëm në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Mbeten kufizime në lëvizjet e kapitalit afat-shkurtër dhe mbi transferet ndërkufitare të pagesave. Korniza ligjore dhe kapacitetet administrative si dhe prapavija e zbatimit në luftën kundër pastrimit të parave janë avancuar në nivel të mesëm.

Progres është arritur në fushën e prokurimit publik. Zyra për Prokurim Publik miratoi një strategji për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik. Legjislacioni për koncesionet dhe partneritetin publiko-privat nuk është në përputhje me *acquis*. Kapaciteti administrativ për të aplikuar rregullat e prokurimit në nivel operacional ende nuk është i kënaqshëm. Progres i mirë është arritur në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare. Megjithatë, harmonizimi i auditimit me *acquis* mbetet në një fazë të hershme. Disa përparime janë arritur në përmirësimin e kornizës ligjore në fushën e pronësisë intelektuale. Strategjia Kombëtare e pronësisë intelektuale është duke u zbatuar. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtjshme sa i përket zbatimit.

Është arritur progres në fushën e konkurrencës. Në fushën e ndihmës shtetërore numri i vendimeve *ex-ante* ka pësuar rritje të moderuar. Megjithatë, burimet njerëzore dhe financiare të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës duhet të forcohen në sektorin e anti-trustit.

Është arritur progres i përgjithshëm i mirë në fushën e shërbimeve financiare. Janë bërë përpjekje për të siguruar rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të sigurimeve. Disa shërbime financiare, të tilla si lizingu, mbetet të rregullohen ose të mbikëqyren.

Është arritur progres i pabarabartë në fushën e shoqërisë së informacionit dhe të medie. Harmonizimi me *acquis* i BE-së dhe liberalizimi i tregut janë duke u përmirësuar. Megjithatë, qëndrueshmëria e transmetuesit të shërbimit publik ende mbetet për t'u siguruar. Legjislacioni për media akoma nuk është në përputhje me Direktivën për shërbimet audio-vizuale të medie.

Progres është arritur në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural. Politika e zhvillimit rural gradualisht është duke u përafëruar me kërkesat e BE-së. Ndërsa strukturat operacionale AFSARD dhe IPARD janë forcuar, kapaciteti i organeve tjera administrative në këtë sektor ka nevojë të përmirësohet. Harmonizimi me *acquis* kërkon përpjekje të vazhdueshme të mëtejshme. Ka pasur pak progres në fushën e sigurisë së ushqimit, politikave veterinarë dhe fitosanitare, në veçanti në lidhje me përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit nga operatorët e biznesit të ushqimit. Kapaciteti administrativ duhet të forcohet, në veçanti sa i përket efektivitetit të sistemeve të monitorimit dhe kontrollit.

Disa përparime mund të raportohen në fushën e politikës së transportit. Procesi i hapjes së tregut për transportin hekurudhor është përballur me sfida. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar funksionimin e autoriteteve të sigurisë, në mënyrë të veçantë të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore.

Disa përparime janë arritur në sektorin e energjisë. Strategji të reja të energjisë janë miratuar. Megjithatë, ligji i ri gjithëpërfshirës i energjisë mbetet për t'u miratuar. Tarifat e energjisë elektrike nuk pasqyrojnë plotësisht shpenzimet. Përderisa ka pasur progres të mirë, mbetet e pazgjidhur përfundimisht çështja e mosmarrëveshjeve me operatorin e sistemit të shpërndarjes me një investitor të madh nga BE-ja. Rregullatori i energjisë dhe Rregullatori i mbrojtjes nga rrezatimi duhet të bëhen funksionalisht të pavarur.

Nuk është arritur përparim në harmonizimin e legjislacionit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë tatimor me *acquis*. Disa përparime mund të raportohen në fushën e kapaciteteve operative për administratën tatimore sa i përket shërbimeve të tatimpaguesve dhe efikasitetit të auditimit. Kapacitetet e auditimit dhe të hetimit tatimor për të luftuar evazionin fiskal mbeten të dobëta.

Progres i kufizuar është arritur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Harmonizimi me *acquis* është i paplotë dhe kapacitetet administrative për zbatimin e politikës dallojnë gjerësisht. Ka pasur progres të mirë në fushën e statistikave. Sidoqoftë, gjendja e burimeve të Entit Statistikor Shtetëror mbetet e dobët dhe duhet të sigurohet përfaqësim i barabartë. Është thelbësor sigurimi i fondeve për regjistrimin e popullsisë dhe banesave për vitin 2011. Përpjekjet për përmirësimin e sektorit të statistikave duhet të vazhdojnë, në mënyrë të veçantë për statistikatat ekonomike.

Pak progres është arritur në nënshtrimin ndaj *acquis* në fushën e politikës sociale dhe të punësimit. Një draft ligj kundër diskriminimit është miratuar, por me disa boshllëqe të konsiderueshme dhe pa mbështetje të grupeve relevante të shoqërisë civile. Dialogu social trepalësh dhe dypalësh vazhdon të mbetet i dobët. Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara dhe njerëzve të tjerë të marginalizuar nga shoqëria është i ngadalshëm.

Është arritur pak progres në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale. Progres i mirë është arritur në reduktimin e barrierave administrative dhe shpenzimeve për funksionimin e bizneseve. Organe të reja janë themeluar dhe burime të rëndësishme kanë qenë të përkushtuara për funksionimin e tyre. Megjithatë, strategjia për mbështetjen e ndërmarrjeve dhe sektorit të NVM-ve ka nevojë për më shumë mbështetje financiare.

Është arritur progres në fushën e rrjeteve trans-Evropiane. Vendi është duke vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në Observatorin e Evropës Jug-Lindore të Transportit dhe në Komunitetin e Energjisë. Megjithatë, progresi në korridorin X është vonuar në mënyrë të konsiderueshme.

Progres i pabarabartë është arritur në fushën e zhvillimit rajonal dhe të koordinimit të fondeve strukturore. Zbatimi i programit operativ për zhvillimin rajonal është vonuar në mënyrë të konsiderueshme. Duhet të forcohen kapacitetet administrative në ministritë e linjës, në veçanti ekspertiza teknike. Kjo gjithashtu është e nevojshme për të forcuar përgatitjet dhe zbatimin e projektit për të siguruar thithjen e ardhme të fondeve IPA. Në përgjithësi, harmonizimi ndaj *acquis* në fushën e politikës rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore është në një fazë të hershme.

Është arritur progres i kufizuar në reformën e gjyqësorit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore si dhe përparim në adresimin e korrupsionit. Këshilli Gjyqësor dhe i Këshillit të prokurorëve publik duhet të sigurojë standarde të larta të pavarësisë dhe paanshmëri të gjyqësorit në praktikë. Operacione të mëdha kundër korrupsionit janë kryer nga policia duke përdorur masa të posaçme hetuese. Megjithatë, prapavija e një niveli të lartë të rasteve të korrupsionit mbetet të forcohet. Legjislacioni i ri për konfliktin e interesave dhe të financimit të partive politike duhet të zbatohet në mënyrë efikase. Sa i përket të drejtave themelore të njeriut, përderisa korniza ligjore dhe institucionale është në përgjithësi e vendosur, garancitë ligjore ekzistuese duhet të zbatohen në tërësi.

Në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përparim i mirë mund të raportohet në çështjet e azilit, politikës së vizave, kufijve të jashtëm dhe të Shengenit. Rritja e azil-kërkuesve në BE që u ngrit në periudhën e parë të zbatimit të regjimit të vizave është adresuar. Megjithatë, një rritje e re e aplikimeve për azil është regjistruar në gusht dhe shtator. Autoritetet duhet të vazhdojnë të trajtojnë këtë çështje dhe të informojnë qytetarët për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga mundësia e udhëtimit pa viza. Zbatimi i reformës policore ka vazhduar dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë është përmirësuar. Megjithatë, roli i Ministrisë së punëve të brendshme për të autorizuar urdhrat e zënieve duhet të trajtohen si edhe efikasiteti i mekanizmit të jashtëm të mbikëqyrjes.

Disa përparime mund të raportohen në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor. Shkalla e pjesëmarrjes në Programin e shtatë të BE-së të kornizës së hulumtimit është rritur. Disa përparime janë arritur në nënshtrimin ndaj *acquis* në fushat e arsimit, trajnimit të të rinjve, dhe kulturës. Megjithatë, menaxhimi i mësimit të përjetshëm dhe të Rinjve në programet e veprimit mbetet i dobët.

Progres i mëtejshëm është arritur sa i përket mjedisit. Nënshtrimi i legjislacionit kombëtar ka përparuar në mënyrë të veçantë në sektorët e cilësisë së ajrit dhe të mbeturinave. Megjithatë, përpjekjet për të lidhur sektorin e ujit me *acquis* të BE-së duhet të forcohen në mënyrë të konsiderueshme. Kapacitetet administrative dhe investimet duhet të rriten ndjeshëm. Disa përparime janë arritur në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit. Sa i përket shëndetit publik, është arritur progres i mirë në fushën e kontrollit të duhanit.

Ka pasur pak progres në fushën e unionit doganor, në veçanti sa i përket kapaciteteve administrative dhe operative. Edhe harmonizimi i legjislacionit doganor ndaj *acquis* është avancuar, përveç në rastin e transitit. Kapacitetet administrative të administratës doganore për zbatimin e legjislacionit dhe për të luftuar krimin ndërkufitar dhe korrupsionin duhet të forcohen.

Progres është arritur në fushën e marrëdhënieve të jashtme, në veçanti sa i përket politikës së përbashkët komerciale. Ka pasur progres në fushën e politikës së sigurisë së jashtme, dhe të mbrojtjes. Vendi është më tepër tani në linjë me deklaratat e Bashkimit Evropian dhe qëndrimet e përbashkëta dhe tregoi një angazhim të vazhdueshëm për të marrë pjesë në operacionet PPSM. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të zvogëluar numrin e armëve të paligjshme.

Sa i përket kontrollit financiar, është arritur një përparim i caktuar. Pavarësia funksionale dhe financiare e SAO-së është forcuar, megjithatë, ankorimi i saj kushtetues është zhdukur. Nevojiten përpjekje për krijimin e Menaxhmentit Financiar dhe sistemeve të kontrollit. Në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore është arritur përparim drejt përmirësimit të kapaciteteve operationale të doganave dhe të autoriteteve tatimore, si dhe zyrave statistikore shtetërore. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të luftuar detyrimet doganore si dhe mashtrimin lidhur me TVSH-në.

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim të kufizuar në trajtimin e kritereve politike. Është arritur pak progres në lidhje me sundimin e ligjit, veçanërisht në fusha të tilla si menaxhimi i kufijve dhe politikave të migrimit përmes reformave që synojnë liberalizimin e kërkesave për viza. Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë edhe për të nxitur pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal, sidomos në aspektin e kthimit të refugjatëve. Megjithatë, zbatimi i përgjithshëm i reformave ka qenë i pamjaftueshëm dhe klima politike në vend gjatë periudhës para-zgjedhore ishte e dominuar nga retorika nacionaliste. Mungesa e një vizioni të përbashkët nga liderët politikë për drejtimin e vendit bllokoi reformat kryesore lidhur me BE-në dhe pengoi përparimin e mëtejshëm drejt BE-së.

Zgjedhjet e përgjithshme u vlerësuan nga OSBE / ODIHR-it si përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Megjithatë, ato përsëri janë mbajtur nën kufizime të ndërlidhura me etnicitetin dhe vendin e rezidencës sa i përket të drejtës së votimit për shkak të dispozitave të përcaktuara nga ana e Dejtonit / Marrëveshjes për Paqe të Parisit. Respekti për parimet demokratike dhe e drejta për trajtim të barabartë dhe pa diskriminim, të mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), përbën një element thelbësor të Marrëveshjes së Përkohshme (MP). Vonesat në harmonizimin e Kushtetutës me KEDNj-në, siç është kërkuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në dhjetor të vitit 2009, gjykimi i rastit Sejdić-Finçi kundër Bosnjës dhe Hercegovinës mbetet një çështje thelbësore për shqetësim.

Në lidhje me detyrimet ndërkombëtare, arritja e përparimit drejt përmbushjes së kushteve të cilat kanë qenë të vendosura për mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë (ZPL)⁵ mbeten thelbësore. Sistemi i qeverisjes në Bosnjë dhe Hercegovinë vazhdon të përfshijë një prani ndërkombëtare. Vendi ka bërë shumë pak përparimin e përmbushjes së kërkesave për mbylljen e ZPL-së. Nga këto çështje më primare është ndarja e pronës ndërmjet shtetit dhe niveleve tjera të qeverisë, çështjen e pronësisë së mbrojtjes si dhe përmbushja e detyrimeve mbi Vendimin përfundimtar të Brçkos. Mbi të gjitha këto çështje është nevoja për një mjedis të qëndrueshëm dhe konstruktiv politik në vend.

Sa i përket demokracisë dhe sundimin të ligjit është arritur pak progres në drejtim të reformës kushtetuese dhe në drejtim të krijimit të strukturave funksionale dhe efektive institucionale. Këshilli i Ministrave miratoi një Plan të Veprimit për zbatimin e vendimit të GjEDNj-së por pa rezultate.

Funksionimi i ekzekutivit në nivel shtetëror dhe i organeve legjislative ka vazhduar të ndikohet negativisht nga përhapja e pikëpamjeve të orientuara etnikisht. Kapacitetet administrative të Kuvendit janë përmirësuar, por koordinimi me Këshillin e Ministrave dhe me subjektet mbeten të dobëta. Funksionimi i institucioneve qeveritare, në nivele të ndryshme vazhdon të ndikohet nga politika të fragmentuara si dhe të pakoordinuara. Janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar kapacitetet administrative me rastin e emërimit të disa zyrtarëve të nivelit të lartë, duke përfshirë Drejtorinë për Integritet Evropian. Megjithatë, pozita tjera kyçe mbeten të lira. Ligji në nivel shtetëror mbi regjistrimin, që nevojitet për përparimin e mëtejshëm në agjendën e BE-së dhe për zhvillimin social dhe ekonomik të vendit mbetet të miratohet si një çështje urgjente.

Pak progres është arritur në fushën e administratës publike, ku strategjia e reformës është duke u zbatuar, edhe pse ngadalë. Koordinimi në mes të administratave të ndryshme mbetet i dobët. Përpjekje të vazhdueshme janë të nevojshme për të parandaluar ndërhyrjet politike dhe për të kufizuar rolin e luajtur nga përkatësia politike në emërimet. Përparimi drejt krijimit të një shërbimi profesional, të përgjegjshëm, transparent dhe efikas civil të bazuar në merita dhe kompetenca gjithashtu ka nevojë për vëmendje të mëtejshme. Ombudspersoni i vetëm në nivel shtetëror është duke funksionuar, por kufizimet buxhetore pengojnë efikasitetin e tij dhe duhet të adresohen.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur progres të kufizuar në përmirësimin e sistemit gjyqësor. Legjislacioni i ri është miratuar në kodin penal të procedurës, por pak është arritur për të zvogëluar ngarkesën e rasteve. Zbatimi i Strategjisë së Reformës së Sektorit të Drejtësisë dhe Strategjisë për Krime të Luftës ka mbetur minimal. Komplexiteti i kornizës ligjore, fragmentimi i sistemit gjyqësor dhe mungesa e një buxheti të vetëm vazhdon të vonojë përparimin drejt një gjyqësori të pavarur. Mandatet e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë që kanë të bëjnë me krimet e luftës janë vazhduar nga Përfaqësuesi i Lartë pas pamundësisë së autoriteteve për të arritur një marrëveshje. Ndjekja penale e krimeve të luftës nga Gjykata e Shtetit ka vazhduar të jetë e kënaqshme, por ka nevojë të përmirësohet në nivel të entiteteve dhe kantoneve.

⁵ Këto mbulojnë pesë objektiva: 1) zgjidhjen e pranueshme dhe të qëndrueshme të çështjes së ndarjes së pronave midis shtetit dhe niveleve tjera të qeverisë; 2) një rezolutë të pranueshme dhe për mbrojtje të qëndrueshme të pronës; 3) Plotësimin e Vendimit përfundimtar të Brçkos; 4) qëndrueshmërinë fiskale dhe 5) fortifikimin e sundimit të ligjit (demonstruar me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Krimeve të Luftës, të një Ligji për të huajt dhe azilin dhe të një Strategjie Kombëtare për Reformën në Sektorin e Drejtësisë), si edhe dy kushte të veçanta: 1) nënshkrimin e Stabilizim-Asociimit 2) një situatë e qëndrueshme politike.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim të kufizuar në luftën kundër korrupsionit, që mbetet problem serioz dhe është përhapur në shumë fusha. Zbatimi i strategjisë anti-korrupsion dhe i planit të veprimit ka filluar. Agjencia përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e saj është krijuar dhe një drejtori që vepron është emëruar. Disa përparime janë bërë në përmbushjen e rekomandimeve të formuluar nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO). Ndjekja e rasteve të korrupsionit nga sistemi gjyqësor ka mbetur çështje e ngadalshme dhe vetëm një numër i kufizuar i nivelit të lartë të rasteve arrijnë të ndiqen penalisht. Zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit dhe problemet e koordinimit ndërmjet entiteteve mbeten çështje shqetësuese. Bosnja dhe Hercegovina ka nevojë për forcim të angazhimit si dhe për veprime të vendosura kundër korrupsionit.

Është arritur progres i kufizuar në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Bosnja dhe Hercegovina ka ratifikuar konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, por nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të siguruar zbatim më të mirë. Ekzekutimi i vendimeve të brendshme, duke përfshirë edhe ato të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës duhet të forcohet.

Të drejtat civile dhe politike janë respektuar gjerësisht. Disa përparime janë arritur në drejtim të harmonizimit të sanksioneve penale në tërë vendin. Megjithatë, është në pritje miratimi i kornizës ligjore për ndihmë ligjore falas, që nevojitet sipas KEDNj-së. Duhet të sigurohet qasja në drejtësi në gjykime civile dhe penale. Kushtet e burgjeve janë përmirësuar, por mbipopullimi dhe keq-trajtimi i të burgosurve mbeten çështje shqetësuese.

Kushtetuta shtetërore dhe e entiteteve sigurojnë lirinë e shprehjes dhe të medieve, lirinë e tubimit dhe të organizimit si dhe lirinë e fesë. Megjithatë, legjislacioni ekzistues nuk është zbatuar plotësisht. Presioni politik mbi mediet është rritur, ashtu si edhe paragjykimet etnike të medieve. Rastet e kërcënimeve ndaj gazetarëve gjithashtu janë rritur. Zbatimi i reformave ndaj transmetimit publik janë vonuar. Pavarësia e Entit Rregullues të Telekomunikacionit vazhdon të jetë e dëmtuar. Qeveritë e njësive kanë miratuar marrëveshje të bashkëpunimit me shoqërinë civile. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të rritur dialogun me shoqërinë civile dhe për të mbështetur zhvillimin e saj.

Ka pasur pak progres në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Ato mbrohen nga korniza ekzistuese ligjore, por copëtimi vazhdon të ekzistojë kurse zbatimi i vazhdueshëm është i dobët. Një ligj gjithëpërfshirës në nivel shtetëror kundër diskriminimit është në fuqi, por fushëveprimi i tij mbetet i kufizuar. Mbrojtja e grave ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të përmirësohet, ashtu si edhe mbrojtja sociale e fëmijëve. Sistemi i bazuar kryesisht në të drejtat ndaj përfitimeve sociale ka ndikim të keq në kushtet e grupeve të cënueshme, duke përfshirë edhe personat me paaftësi mendore. Dialogu social dhe ushtrimi i të drejtave të punës pengohen nga mungesa e njohjes së partnerëve social në nivel të shtetit dhe një kornizë ligjore e fragmentuar.

Ka pasur pak progres në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave kulturore⁶. Sa i përket marrëdhënieve ndër-etnike, numri i shkollave të ndara ('2 shkolla nën 1 çati') ka rënë dhe një kurrikulë e përbashkët nëntë-vjeçare është futur në veprim në shumicën e shkollave. Megjithatë, ndarja e

⁶ Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare, ekzistojnë 17 pakica kombëtare në Bosnje dhe Hercegovinë. Tre popujt përbërës - boshnjakët, kroatët dhe serbët - nuk përfshihen në pakica kombëtare.

fëmijëve nëpër shkolla në baza etnike mbetet ende shqetësim. Pavarësisht nga një rritje e burimeve financiare për zbatimin e strategjisë së Romëve, kjo pakicë vazhdon të përballlet me kushte shumë të vështira të jetesës dhe të diskriminimit. Mungesa e regjistrimit të lindjeve vazhdon të pengojë pjesëmarrjen e tyre në të drejtat themelore sociale dhe ekonomike. Hapa të mëtejshëm janë të nevojshëm në mënyrë që të përmirësohet zbatimi i Ligjit për pakicat kombëtare.

Disa përparime janë arritur në lidhje me refugjatët dhe personat e zhvendosur. Është miratuar strategjia e tërë vendit që ka për qëllim mbështetjen e procesit të kthimit dhe për të siguruar zbatimin e duhur të Shtojcës VII të Marrëveshjes së Dejtonit/Parisit për Paqe (MPD). Sidoqoftë, pak progres është arritur në sigurimin e integritetit lokal dhe në qëndrueshmërinë e kthimit.

Sa i përket çështjeve rajonale dhe detyrimeve ndërkombëtare, zbatimi i MPD-së ka vazhduar. Bashkëpunimi me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë ka mbetur i kënaqshëm. Megjithatë, gjatë periudhës para-zgjedhore, Republika Srpska shpesh ka sfiduar integritetin territorial të vendit. Për më tepër, kanë vazhduar deklaratat nga lidhshipi politik i Republika Srpskës i cili ka mohuar rëndësinë e masakrave të luftës që kanë përfshirë popullsinë civile.

Bashkëpunimi ndërmjet gjykatave dhe prokurorëve nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia është përmirësuar. Marrëveshjet dypalëshe u nënshkruan mbi njohjen e ndërsjellë dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në çështjet penale. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të forcuar kapacitetin për t'u marrë me rastet e krimeve të luftës, veçanërisht në gjykatat kantonale dhe të qarkut, si dhe për të siguruar burime të mjaftueshme financiare. Bashkëpunimi rajonal dhe mbrojtja adekuatë e dëshmitarëve do të jenë kyçe në këtë drejtim.

Sa i përket Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve, marrëveshja dypalëshe e imunitetit me Shtetet e Bashkuara nuk përputhet me qëndrimet e përbashkëta të BE-së dhe parimet udhëzuese. Vendi ka nevojë për t'iu nënshtruar qëndrimit të BE-së.

Nxitje e re i është dhënë procesit të deklarimit të Sarajevës, pas takimit të Ministrave të mbajtur në Beograd në mars të vitit 2010. Kjo sjellë së bashku Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi dhe Serbinë, që ranë dakord të bashkëpunojnë për të sqaruar statistikën e refugjatëve. Vendet janë angazhuar edhe vetë për të punuar në drejtim të gjetjes së zgjidhjeve për një numër të çështjeve të pazgjidhura deri në fund të vitit.

Bosnja dhe Hercegovina ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në nismat për bashkëpunim rajonal, duke përfshirë Procesin e Evropës Juglindore (SEECP), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR) dhe Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Marrëdhëniet e Bosnjës dhe Hercegovinës me fqinjët janë zhvilluar më tej për shkak të disa nismave të rëndësishme rajonale për nxitje të pajtimit. Megjithatë, disa çështje kufitare të lidhura me vendet fqinje mbeten të hapura. Mbajtësit e pasaportave të Kosovës vazhdojnë të përballen me vështirësi gjatë marrjes së vizave për të marrë pjesë në takime rajonale në Bosnje dhe Hercegovinë.

Ekonomia e Bosnjës dhe Hercegovinës ka shënuar një rikthim të moderuar në vitin 2010, pasi ka qenë në rënie në vitin 2009. Rikuperimi është nxitur kryesisht nga kërkesa e jashtme. Papunësia ka mbetur në nivele shumë të larta. Situata fiskale dukshëm është përqendruar në vitin 2009 përderisa financat publike ishin nën tension të rëndë për shkak që të ardhurat ishin në rënie dhe kishte zotime të larta të

shpenzimeve. Angazhimi për reformat strukturore dhe financat publike ka mbetur i pabarabartë në të gjithë vendin. Disa masa fiskale dhe të reformës strukturore janë miratuar kohëve të fundit nën presionin e pabarazisë buxhetore dhe të programit të FMN-së. Megjithatë, buxhetet ende nuk janë të vetë-qëndrueshme dhe cilësia e financave publike mbetet e dobët.

Sa i përket kriterëve ekonomike, Bosnja dhe Hercegovina ka arritur pak përparim drejt një ekonomie funksionale të tregut. Përpjekje të konsiderueshme të mëtejme të reformës duhet të ndiqen me vendosmëri për t'ia mundur vendit që të përballet në aspektin afat-gjatë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Implementimi i Marrëveshjes rezervë me Fondin Monetar Ndërkombëtar ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm. Është ruajtur stabiliteti financiar dhe monetar. Bordi i valutës me aranzhimin e vet vazhdon të gëzojë një shkallë të lartë të besueshmërisë. Besimi në bankat lokale është rikthyer dhe rrjedhimisht familjet kanë ridrejtuar kursimet e tyre në sektorin bankar gjatë gjithë vitit 2010. Prodhimi industrial u rrit pak në gjysmën e parë të vitit 2010. Është ndikuar kryesisht nga zhvillimet e çmimeve ndërkombëtare, inflacioni është kthyer në ritme pozitive dhe është ende i ulët në fillim të vitit 2010. Për shkak të rritjes së eksporteve, disbalancet e jashtme kanë rënë. Mund të raportohen disa përmirësime të kufizuara në mjedisin e biznesit, në veçanti në lidhje me regjistrimin e bizneseve.

Megjithatë, situata fiskale në Bosnje dhe Hercegovinë mbetet e vështirë, sidomos në Federatë. Zotimi ndaj përshtatjeve të dakorduara fiskale dhe masave të reformës strukturore si dhe zbatimi i tyre ka qenë i pabarabartë në tërë vendin. Cilësia e financave publike mbetet e ulët me norma të larta të shpenzimeve rrjedhëse kundrejt BPV-së. Privatizimi, ristrukturimi i ndërmarrjeve publike dhe liberalizimi i industrive të rrejtit nuk ka avancuar. Përmirësimi i infrastrukturës ka vazhduar, ndonëse me ritëm të ngadaltë. Kapacitetet prodhuese dhe konkurruese të ekonomisë mbeten të dobëta dhe si burimet e brendshme të zhvillimit nuk janë shfrytëzuar në mënyrë adekuate. Ngurtësi strukturore të tilla si normat e larta të kontributeve shoqërore dhe lëvizshmëria e ulët e fuqisë punëtore vazhdojnë të pengojnë krijimin e vendeve të punës për pjesëmarrje në tregun e punës. Transferet e larta dhe të synuara në mënyrë të dobët sociale kanë reduktuar prirjen për të punuar, gjë që edhe më tej thekson nevojën për reformim të sistemit të përkrahjes sociale. Papunësia vazhdon të jetë shumë e lartë dhe sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme. Mjedisi i biznesit është i ndikuar nga joefikasiteti administrativ dhe sundimi i dobët i ligjit.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim të kufizuar në përafrimin e legjislacionit dhe politikave me standardet evropiane. Disa përparime janë arritur në fusha të tilla si lëvizja e lirë e kapitalit, në pronat intelektuale, në arsimim dhe kërkim shkencor, në fushat e transportit, të kontrollit financiar, si dhe në një sërë çështjesh të ndërlidhura me drejtësinë, lirinë dhe çështje që ndërlidhen me sigurinë. Përpjekje të veçanta janë të nevojshme sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, personave dhe shërbimeve, doganave dhe tatueshmërisë, konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, prokurimit publik, punësimit dhe politikave sociale, bujqësisë dhe peshkimit, mjedisit, energjisë dhe shoqërisë së informacionit dhe të medieve.

Në tërësi, zbatimi i Marrëveshjes së Përkohshme (MP) ka qenë i pabarabartë. Vendi është duke shkelur MP-në për shkak të mos-pajtueshmërisë me GjEDNj mbi të drejtën e trajtimit të barabartë pa diskriminim⁷, si dhe dështimi për të krijuar një autoritet ndihmës shtetërore. Forcimi i mëtejshëm i

⁷ Nenet 14 dhe 3 të Protokollit 1 të GjEDNj-së që parashikojnë ndalimin e diskriminimit në lidhje me të drejtën për zgjedhje të lira, dhe neni 1 i protokollit 12 të GjEDNj, i cili vendos të drejtën për trajtim të barabartë pa diskriminim.

kapaciteteve administrative është i nevojshëm në mënyrë që të arrihet një prapavijë e kënaqshme e zbatimit të MSA-së.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur progres në fushat e tregut të brendshëm. Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave, përgatitjet kanë avancuar në masë shumë të moderuar. Disa përparime janë arritur në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Përpjekje të vazhdueshme nevojiten në mënyrë që të përafrohet korniza ligjore me legjislacionin e BE-së dhe për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme administrative.

Është arritur përparim i kufizuar në fushën e lëvizjes së personave, shërbimeve dhe të drejtave të themelimit, duke përfshirë edhe të drejtën e krijimit të një hapësire të vetme ekonomike. Duhet të arrihet thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave të gjykatës dhe regjistrimit të kompanive.

Është arritur pak progres në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Harmonizimi i mëtejshëm ligjor ndaj *acquis* është thelbësor për të siguruar funksionimin e duhur të tregjeve të kapitalit në Bosnje dhe Hercegovinë. Progres i pakët mund të raportohet në fushën e doganave dhe tatimeve.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim sa i përket zbatimit të rregullave të konkurrencës. Megjithatë, nuk është arritur progres në fushën e ndihmës shtetërore për shkak të dështimit për të krijuar një autoritet shtetëror të ndihmës. Ka pasur progres të kufizuar në fushën e prokurimit publik. Është arritur një progres në miratimin e ligjeve për të drejtat e pronës intelektuale.

Është arritur pak progres në fushën e politikës shëndetësore, sociale dhe të punësimit si dhe politikave publike. Dokumentet strategjike në gjithë vendin janë në përgatitje por legjislacioni dhe politikat mbeten të fragmentuara. Progres i mirë është arritur në fushën e kërkimit shkencor. Ligjet kornizë dhe strategjitë janë siguruar në fushën e arsimit dhe të kulturës, por zbatimi është në pritje. Negociatat për t'u bashkuar me Organizatën Botërore të Tregtisë kanë vazhduar, por procesi nuk ka përfunduar.

Bosnja dhe Hercegovina ka arritur një progres të kufizuar në përmbushjen e standardeve evropiane në një sërë politikash sektoriale. Përgatitjet në fushën e industrisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), mbeten në një fazë të hershme. Një strategji gjithëpërfshirëse industriale mbetet për t'u zhvilluar, kurse duhet të zbatohet strategjia e NVM-ve në nivel shtetëror. Ka pasur pak progres në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, të sigurisë së ushqimit, veterinarisë, fitosanitarisë dhe politikave të peshkimit. Legjislacioni zbatues është miratuar, por nuk ka pasur asnjë progres në ngritjen e Ministrisë së Bujqësisë në nivel shtetëror. Zbatimi i pamjaftueshëm në nivel shtetëror i veterinarisë, sigurisë së ushqimit dhe legjislacionit fitosanitar parandalon Bosnjën dhe Hercegovinën nga përmbushja e standardeve të BE-së.

Përgatitjet e Bosnjës dhe Hercegovinës në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike mbeten në një fazë të hershme. Një kornizë ligjore e harmonizuar për mbrojtjen e mjedisit dhe një agjenci shtetërore mjedisore duhet të krijohen. Bosnja dhe Hercegovina ka arritur përparim të pabarabartë në sektorin e transportit. Ka pasur disa zhvillime lidhur me rrjetet trans-evropiane të transportit hekurudhor, dhe sektorë të rrugëve ujore brenda vendit, por progresi ka qenë i kufizuar në sektorin e rrugëve. Përmirësimi i infrastrukturës së transportit mbetet një çështje e pazgjidhur. Përgatitjet në fushën e energjisë nuk janë shumë të avancuara. Si palë në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Bosnja dhe Hercegovina ka nevojë për të zbatuar legjislacionin përkatës për energji të BE-së. Për të garantuar sigurinë e furnizimit me

energji elektrike, duhet të sigurohet një kompani plotësisht funksionale kombëtare e transmisionit dhe një strategji e përgjithshme e energjisë duhet të miratohet.

Progresi në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medieve ka qenë i kufizuar. Harmonizimi i kornizës ligjore për transmetimin publik mbetet i pazgjidhur. Sfidat e vazhdueshme për pavarësinë e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe ritmi i ngadalshëm i zbatimit të reformës së transmetimit publik mbeten çështje serioze dhe shqetësuese.

Disa përparime mund të raportohen në fushën e kontrollit financiar. Auditimi i brendshëm është duke u futur në veprim, por Menaxhimi Financiar dhe sistemet e kontrollit kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Pavarësia e auditimit të jashtëm mbetet për t'u siguruar. Disa përparime janë arritur në fushën e statistikave në lidhje me klasifikimin dhe regjistrat. Megjithatë, ligji në nivel shtetëror mbi popullsinë dhe regjistrimin e familjeve nuk është miratuar. Statistikat mbi llogaritë kombëtare, mbi biznesin dhe për bujqësi duhet të përmirësohen. Bashkëpunimi në mes të institucioneve statistikore të vendit në nivel shtetëror dhe të njëjësive mbetet i pamjaftueshëm.

Është arritur progres në fusha të ndryshme të drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, megjithëse i pabarabartë. Në kuadrin e dialogut për liberalizimin e vizave, janë ndërmarrë hapa për të përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në plan. Në fushën e politikës së vizave, mbesin për t'u adresuar prioritetet e vazhdueshme. Pasaportat biometrike janë duke u lëshuar. Marrëveshja e lehtësimit të vizave ndërmjet BE-së dhe Bosnjës dhe Hercegovinës dhe marrëveshja mbi riatdhesimin kanë vazhduar të zbatohen pa probleme.

Përgatitjet e vendit në fushat e menaxhimit të kufijve, azilit dhe migrimit kanë përparuar. Sistemi i azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare, monitorimit të flukseve migruese dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive janë përmirësuar. Megjithatë, infrastruktura në disa pika kufitare të kalimit kërkon përfundim. Progres i kufizuar është arritur në parandalimin e pastrimit të parave. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme, veçanërisht lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore. Ka pasur pak progres në luftën kundër drogës. Megjithatë, mungesa e veprimeve përcjellëse efikase nga gjyqësori pengon luftën kundër trafikut të drogës, e cila mbetet një problem serioz.

Përgatitjet e Bosnjës dhe Hercegovinës në fushën e policisë janë duke përparuar, megjithëse në mënyrë të pabarabartë. Fragmentimi i forcave policore të Bosnjës dhe Hercegovinës vazhdon të dëmtojë efikasitetin, rezultatet, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave. Lufta kundër krimit të organizuar mbetet e pamjaftueshme për shkak të mungesës së një kornize koherente institucionale. Krimi i organizuar mbetet një çështje serioze shqetësuese që ndikon në sundimin e ligjit dhe mjedisin e biznesit. Disa përparime janë arritur në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në lidhje me identifikimin e viktimave. Më shumë përpjekje janë të nevojshme në lidhje me mbështetjen për viktimat dhe mbrojtjen e dëshmitarëve. Bosnja dhe Hercegovina ka filluar të trajtojë çështjen e luftës kundër terrorizmit duke miratuar një strategji gjithëpërfshirëse.

Sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, përgatitjet për mbrojtjen e tyre kanë vazhduar, por përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në lidhje me zbatimin e ligjit. Funksionimi i mirë i mbrojtjes së të dhënave personale është vendimtar në mënyrë që Bosnja dhe Hercegovina të lidhë marrëveshje me Europol dhe Eurojust.

Serbia

SQ

SQ

Serbia ka arritur përparim drejt përmbushjes së kriterëve politike. Serbia ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2009. Marrëveshja e Përkohshme ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2010 dhe Serbia ka përparuar më tej në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Procesi i ratifikimit të MSA-së filloi në qershor të vitit 2010. Reforma gjyqësore ka vazhduar, por ka pasur mangësi serioze në procedurën e riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pavarësisht nga bashkëpunimi i vazhdueshëm i Serbisë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY), dy të kërkuarit e mbetur nga ICTY, Ratko Mlladiç dhe Goran Haxhiç janë ende të lirë.

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi më 9 shtator një rezolutë të përbashkët të paraqitur nga Serbia dhe të bashkë-financuar nga BE-ja si vazhdimësi e mendimit këshillues për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Rezoluta ka vërtetuar përmbajtjen e opinionit këshillimor të GJND-së dhe përhëndeti gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar një proces të dialogut ndërmjet palëve, procesi i dialogut në vetvete do të jetë një faktor për paqe, siguri dhe stabilitet në rajon, dhe se dialogu do të ishte për të nxitur bashkëpunim, arritur përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve. Përpjekje të vendosura janë të nevojshme nga të gjitha palët për funksionimin efektiv dhe gjithëpërfshirës në forumet rajonale.

Demokracia dhe sundimi i ligjit janë forcuar më tej. Zbatimi i dispozitave të reja kushtetuese, si ato që i referohen Statutit të Vojvodinës kanë përparuar. Përpjekje shtesë janë të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë e disa dispozitave kushtetuese me standardet evropiane, veçanërisht për gjyqësorin.

Hapa të mëtejshëm janë marrë për përmirësimin e funksionimit të parlamentit përmes miratimit të një ligji të ri për Asamblenë Kombëtare si dhe rregulla të reja të procedurës. Megjithatë, përpjekje janë të nevojshme për të përmirësuar më tej cilësinë e rezultateve të legjislativit. Legjislacioni zgjedhor duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet Evropiane.

Koalicioni qeveritar ka mbetur i qëndrueshëm dhe ka vazhduar të tregojë një shkallë të lartë të konsensusit për integrim në BE si një përparësi strategjike. Megjithatë, përgatitja dhe zbatimi i legjislativitetit të ri duhet të bëhet në mënyrë më efikase.

Kapaciteti i administratës publike është në përgjithësi i mirë, por reforma në këtë fushë po përparon me ritme të ngadalta dhe të pabarabarta. Nevojitet angazhim i fuqishëm për respektimin e mandatit të organeve të pavarura rregulluese dhe për të siguruar burime të mjaftueshme.

Ka pasur progres të mirë në drejtim të miratimit të legjislativitetit duke siguruar mbikëqyrjen civile të forcave të sigurisë dhe zbatim të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Megjithatë, mbikëqyrja civile, përfshirë edhe nga komisioni përkatës parlamentar, duhet të përforcohet.

Serbia vazhdoi reformën e sistemit të saj gjyqësor me procedura të riemërimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe futjen e një rrjeti të ri të gjykatës. Megjithatë, procedura e riemërimit kishte mangësi të mëdha dhe ishte jo-transparente. Të dy Këshillat përgjegjës u zgjodhën në bazë të një përbërjeje kalimtare dhe nuk u zbatuan kriteret objektive. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë dëgjuar gjatë procedurës dhe nuk kanë marrë shpjegime të mjaftueshme për vendimet. Kjo vë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqësorit dhe mund të japë hapësirë për ndikim politik. Të dy Këshillat ende duhet të zgjidhen në përbërjen e tyre përfundimtare. Numri i konsiderueshëm i rasteve të pazgjidhura mbeten çështje shqetësuese. Në përgjithësi, sistemi gjyqësor i Serbisë vetëm pjesërisht plotëson prioritetet e saj.

Progresi në luftën kundër korrupsionit ka vazhduar me Agjencinë Anti-Korrupsion që ka filluar punën e saj në janar të vitit 2010. Shumica e zyrtarëve publikë kanë dorëzuar deklaratat e pasurisë tek Agjencia e re siç edhe kërkohet. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të paraqesë një problem serioz. Në mungesë të një ligji të ri, kontrolli i financimit të partive politike dhe financimi i fushatave zgjedhore mbeten fusha të dobëta. Agjencia Anti-Korrupsion ende ka për të krijuar një prapavijë të verifikimit të deklaramit të pasurisë dhe të kryej rolin e saj në mënyrë efektive. Numri i dënimeve përfundimtare, sidomos në raste të nivelit të lartë, mbetet i ulët. Prokurimi publik, privatizimi dhe shpenzimet publike mbeten fusha me interes. Mbrojtja e denoncuesve duhet të përmirësohet.

Lidhur me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve, legjislacioni i nevojshëm është vendosur. Kushtetuta garanton të drejtat civile dhe politike, të cilat respektohen gjerësisht, por zbatimi i tyre ende nuk është plotësuar në mënyrë të plotë. Legjislacioni relevant mbetet për të përparuar më tej në përputhje me standardet Evropiane.

Ka pasur pak progres në lidhje me parandalimin e torturës, keqtrajtimit dhe mosndëshkimit, në këtë aspekt vazhdojnë të regjistrohen një sërë rastesh. Qasja në drejtësi është e siguruar në përgjithësi.

Megjithatë, legjislacioni dhe fondet për një sistem më efektiv të ndihmës ligjore falas ende mungojnë. Serbia ka arritur pak përparim në reformën e sistemit të saj të burgjeve. Një strategji për të parandaluar mbipopullimin është miratuar, por kushtet e këqija në burgje mbesin çështje shqetësuese.

Dispozitat kushtetuese dhe legjislative për mbrojtjen e lirisë së shprehjes janë siguruar. Legjislacioni që i lejon mediet të veprojnë lirshëm është siguruar. Megjithatë, kanë vazhduar incidente me gjuhën e urrejtjes, kërcënime dhe sulme në veçanti ndaj gazetarëve. Liria e tubimit dhe e organizimit është e garantuar me Kushtetutë dhe në përgjithësi respektohet.

Organizatat e shoqërisë civile vazhduan të jenë aktive në jetën sociale, ekonomike dhe politike të Serbisë dhe mbeten të rëndësishme për promovimin e vlerave demokratike. Zyra për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile është themeluar kohët e fundit.

Garancitë kushtetuese për të lejuar lirinë e fesë janë vendosur. Marrëdhëniet ndër-fetare janë përmirësuar. Megjithatë, mungesa e transparencës dhe konsistencës në procesin e regjistrimit mbeten pengesat kryesore për disa grupe më të vogla fetare gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre.

Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave sociale dhe ekonomike kryesisht është vendosur. Mbrojtja ndaj dhunës e grave dhe fëmijëve duhet të forcohet. Ligji mbi barazinë gjinore, duke synuar përmirësimin e pozitës së gruas është miratuar. Megjithatë, ndjekja e rasteve të dhunës në familje mbetet e pamjaftueshme. Në lidhje me të drejtat e fëmijëve ka pasur progres në forcimin e mbrojtjes së fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca. Është vendosur korniza legjislative që ndalon çdo lloj diskriminimi në vend të punës. Megjithatë, diskriminimi vazhdon në praktikë, veçanërisht kundër Romëve, komunitetit LGBT, grave, minoriteteve kombëtare dhe personave me aftësi të kufizuara.

Nuk ka pasur asnjë progres në lidhje me të drejtat e pronësisë, pasi baza adekuate ligjore për kthimin e pronës ende mungon.

Është siguruar legjislacioni që parasheh respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe të drejtave kulturore. Zgjedhjet për Këshillat nacional të 19 pakicave nacionale janë mbajtur në qershor të vitit 2010 dhe në tërësi janë organizuar mirë. Këshillat ende duhet të bëhen operativ.

Situata ndër-etnike në Vojvodinë ka qenë e qëndrueshme. Zbatimi i Statutit të ri të miratuar dhe i Ligjit për Përcaktimin e kompetencave, i cili parasheh një autonomi të gjerë të provincës në fushat e financave lokale dhe të zhvillimit ekonomik ka filluar. Ligje të mëtejshme duhet të miratohen. Situata në Serbinë jugore është në tërësi e qëndrueshme por e tensionuar. Përleshjet midis grupeve etnike dhe brenda bashkësisë myslimane në Sanxhak në përgjithësi janë zvogëluar. Megjithatë, tensionet vazhdojnë në veçanti në mes të dy organizatave ekzistuese islamike dhe në lidhje me konstituimin e Këshillit Kombëtar të pakicave boshnjake.

Është arritur një progres në adresimin e çështjes së statusit të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), por përpjekje të mëtejshme të konsiderueshme janë të nevojshme. Pavarësisht nga një numër i zhvillimeve pozitive, shumica e popullsisë Rome vazhdon të jetojë në varfëri të skajshme. Ata gjithashtu ballafaqohen me diskriminim, në veçanti sa i përket qasjes në arsimim, mbrojtje sociale, kujdes shëndetësor, punësim dhe strehim të përshtatshëm.

Sa i përket çështjeve rajonale dhe detyrimeve ndërkombëtare, Serbia ka demonstruar një qëndrim konstruktiv në lidhje me zhvillimet në Bosnje-Hercegovinë. Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (ICTY), vuri në dukje në raportin e saj të fundit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që përgjigjet e Serbisë ndaj kërkesave të Zyrës së Prokurorisë për qasje në dokumente, arkiva dhe dëshmitarë janë dhënë në kohë të duhur dhe të përshtatshme dhe se nuk ka kërkesa që kanë mbetur të pazgjidhura. Gjithashtu u theksua profesionalizmi dhe angazhimi i shërbimeve operationale të punës në kërkim të të arratisurve. Megjithatë, një sërë rekomandimesh operationale janë bërë. Pavarësisht nga bashkëpunimi aktiv dhe i vazhdueshëm i Serbisë me Tribunalin e Hagës, të dy të kërkuarit e mbetur nga ICTY-ja janë ende të lirë. Bashkëpunimi i plotë me ICTY-në mbetet kusht thelbësor për anëtarësim në BE, në përputhje me konkluzionet e Këshillit të datës 25 tetor të vitit 2010.

Bashkëpunim i mirë është krijuar me EULEX-in në lidhje me krimet e luftës në Kosovë. Megjithatë, problemet e ekstradimit dhe njohjes së dënimeve vazhdojnë të mbesin me disa vende të rajonit.

Një nxitje e re është dhënë në procesin e deklarimit të Sarajevës, pas takimit Ministror të mbajtur në Beograd në mars të vitit 2010 me nismën e Serbisë. Kjo nxitje ka sjellë së bashku Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi dhe Serbinë të cilat kanë rënë dakord të punojnë së bashku për të sqaruar statistikën e refugjatëve dhe çështjet që kanë mbetur të hapura. Vendet janë angazhuar edhe vetë për të punuar drejt zgjidhjes së një numri të çështjeve të pazgjidhura deri në fund të vitit.

Serbia ka vazhduar të marrë pjesë aktive në nismat rajonale si në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR) dhe në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Serbia ka mbajtur kryesimin e CEFTA-s në vitin 2010. Ajo ka qenë pjesëmarrëse aktive në përgatitjet për Strategjinë e ardhshme të Danubit. Serbia ka arritur përparim të rëndësishëm në marrëdhëniet e saj bilaterale me vendet kandidate të tjera, veçanërisht me Kroacinë dhe Bosnjën dhe Hercegovinën, dhe ka vazhduar të ketë marrëdhënie të mira me vendet fqinje që janë shtete anëtare të BE-së. Një marrëveshje ekstradimi për bashkëpunim në çështjet penale është nënshkruar me Kroacinë. Bashkëpunimi rajonal megjithatë ndikohet nga mungesa e marrëveshjes mes Serbisë dhe

Kosovës për pjesëmarrjen e kësaj të fundit në takimet rajonale. Një zgjidhje e pranueshme dhe e qëndrueshme për pjesëmarrjen e Serbisë dhe Kosovës në forumet rajonale duhet të akordohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo është esenciale për përfshirje dhe funksionim të bashkëpunimit rajonal. Serbia ende nuk i pranon pullat doganore të Kosovës të notifikuara nga UNMIK-u. Serbia në Kosovë mban strukturat paralele dhe ka organizuar zgjedhje plotësuese paralele komunale.

Pas një rënie të rëndë në prag të krizës globale, ekonomia e Serbisë gradualisht ka rivendosur stabilitetin si pasojë e një programi të përshtatjes të akorduar me FMN-në dhe të mbështetur edhe nga BE-ja dhe Banka Botërore. Që nga gjysma e parë e vitit 2010, aktiviteti ekonomik ka filluar të ngritet ngadalë, por rimëkëmbja mbetet e ngadalshme dhe e brishtë. Financat publike kanë vazhduar të përkeqësohen pavarësisht nga një numër masash për rregullim fiskal të vendosura për të përmbajtur dëmtimet buxhetore. Miratimi i ndryshimeve në ligjin për sistemin e buxhetit dhe në ligjin e pensioneve nga qeveria ishte një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së financave publike. Reforma të tjera strukturore, veçanërisht privatizimi dhe ristrukturimi i ndërmarrjeve, janë vonuar përsëri për shkak të kushteve të zgjatura të pafavorshme të tregut.

Sa i përket kritereve ekonomike, përparimi i mëtejshëm drejt krijimit të një ekonomie funksionale të tregut ka qenë i kufizuar. Serbia duhet të bëjë më shumë përpjekje për ristrukturimin e ekonomisë së saj në mënyrë që të përballet në periudhën afatmesme me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Ekziston një konsensus i gjerë mbi bazat e një ekonomie të tregut. Miratimi i masave të përshtatshme dhe në kohën e duhur në marrëveshje me FMN-në ka qenë çështje kyçe për ri-vendosjen e stabilitetit makroekonomik. Pozicioni i jashtëm i Serbisë është përmirësuar gjatë recesionit. Rritja e veprimtarisë ekonomike në vitin 2010 ka shpie në rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse që megjithatë ka qenë i kufizuar për shkak të eksportit të fuqishëm dhe të rritjes së dobësuar të importit. Rezervat valutore të këmbimit kanë mbetur relativisht të larta, pavarësisht ndërhyrjeve të rregullta nga banka qendrore për të zbutur paqëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Inflacioni është mbajtur në përgjithësi brenda kufijve të synuar pasi banka qendrore i është rikthyer politikës restriktive monetare. Bankat vazhdojnë të kenë kapital dhe likuiditet adekuat. Ndryshimi i ligjit të sistemit buxhetor dhe ligjit të pensioneve zoton qeverinë për konsolidim fiskal në një periudhë afatmesme.

Megjithatë, Serbia ka shtyrë më tej reformat për t'u marrë me të metat më të mëdha strukturore. Pavarësisht nga një rikuperim gradual ekonomik, tregu i punës ka vazhduar të përkeqësohet, me rënie të punësimit dhe rritje të papunësisë. Pavarësisht nga masat korrigjuese për të kufizuar dëmtimet fiskale gjatë krizës dhe ndryshimit të sistemit të buxhetit dhe legjislacionit pensional për të rritur disiplinën fiskale, qëndrueshmëria e financave publike në afat të mesëm duhet të forcohet me reforma në fushat e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe të administratës publike. Privatizimi i kompanive në pronësi shoqërore ka shkuar prapa pas shfuqizimit të kontratave të shumta të shitjes. Privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore është vonuar më tej. Mjedisi i biznesit vazhdon të pengohet nga procedura burokratike dhe parashikueshmëria e dobët ligjore, në veçanti në lidhje me zbatimin efektiv të të drejtave pronësore, të cilat pengojnë hyrjen dhe daljen nga tregu. Për më tepër, mangësitë në konkurrencë dhe pengesat në infrastrukturë mbeten barriera ndaj biznesit. Sektori joformal mbetet një sfidë e rëndësishme.

Serbia ka arritur përparim të mëtejshëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit të saj me Standardet Evropiane. Serbia ka vazhduar edhe me zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes së Përkohshme dhe ka

arritur përparim të mëtëjshëm drejt përputhjes me kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA). Kapaciteti administrativ është i mirë. Megjithatë, përpjekje të mëtëjshme janë të nevojshme për ta sjellë legjislacionin dhe politikat në linjë me *acquis*. Implementimi, si dhe zbatimi i legjislacionit të ndërlydhur me BE-në duhet të sigurohet.

Sa i përket tregut të brendshëm, Serbia ka arritur përparim në përmbushjen e standardeve të BE-së për lëvizjen e lirë të mallrave. Legjislacioni për metrologji dhe i disa direktivave të reja të caktuara të qasjes është miratuar. Megjithatë, një kornizë e re ligjore për mbikëqyrjen e tregut ende mungon. Kapacitetet administrative dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve të shtetit duhet të forcohet më tej. Përpjekje të mëtëjshme janë të nevojshme për të vazhduar transpozimin e *acquis* që janë specifike për disa produkte të caktuara në legjislacionin serb.

Serbia ka avancuar mesatarisht drejt plotësimit të standardeve të BE-së në fushat e lëvizjes së personave, shërbimeve, të drejtës së themelimit dhe të ligjit për shoqëritë tregtare. Një numër i akteve janë ende në pritje të miratimit. Në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit Serbia mbetet me një përparim të moderuar. Jo-rezidentët janë të lirë të bëjnë investime të drejtpërdrejta me kufizime të caktuara. Serbia duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të përmbushur kërkesat graduale të liberalizimit të përcaktuara në MSA.

Serbia është tashmë në rrugën e duhur për të përmbushur *acquis* të BE-së dhe mbetet e angazhuar për reforma në fushat e doganave dhe tatimeve. Detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Përkohshme janë respektuar. Përpjekje të mëtëjshme janë të nevojshme sa i përket procedurave dhe kapaciteteve administrative. Kapacitetet zbatuese të administratës tatimore dhe të mbledhjes së tatimeve janë përmirësuar, edhe pse progres i mëtëjshëm në këtë drejtim nevojitet. Serbia duhet të ndërmarrë veprime përcjellëse për të siguruar që legjislacioni i saj tatimor është në përputhje me Kodin e Sjelljes për tatimin e biznesit.

Serbia ka arritur disa përparime në përmbushjen e standardeve evropiane në fushën e konkurrencës. Legjislacioni për Zbatimin e ligjit të konkurrencës është miratuar. Për më tepër Serbia duhet të vazhdojë të punojë me të dhënat e saj të zbatimit. Njohuritë e gjyqësorit mbeten të dobëta sa i përket ligjit të konkurrencës dhe ekonomisë. Disa përparime janë arritur në fushën e ndihmës shtetërore. Një autoritet i ndihmës shtetërore është themeluar. Megjithatë, kapacitetet administrative të Autoritetit shtetëror të ndihmës duhet të forcohen. Duhet të sigurohet zbatimi efektiv i ligjit.

Përgatitjet e Serbisë për krijimin e një sistemi efektiv dhe plotësisht të pavarur për prokurim publik me procedura efikase të dhënies janë avancuar në masë shumë të moderuar. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për forcimin e kapacitetit për të zbatuar kërkesat e *acquis* të BE-së. Progres është arritur në fushën e pronësisë intelektuale, por nevojiten përpjekje të mëtëjshme në drejtim të nënshtrimit ndaj *acquis*. Në lidhje me zbatimin, është i nevojshëm një bashkërendim më i mirë ndërmjet agjencive relevante, si dhe investime të konsiderueshme në trajnimin e gjyqësorit.

Përgatitjet po vazhdojnë në drejtim të përmbushjes së standardeve evropiane në fushën e punësimit dhe politikave sociale. Progres është arritur në fushën e shëndetësisë publike. Strategjia " Plani zhvillimor për mbrojtjen e shëndetit" për vitet 2010-2015 është përgatitur nga Këshilli Shëndetësor Kombëtar i Serbisë që është përgatitur dhe miratuar nga Qeveria.

Serbia ka arritur progres lidhur me standardet evropiane në fushën e arsimit. Një strategji e përgjithshme që përfshinë të gjitha nivelet e arsimit, duke përfshirë të mësuarit gjatë gjithë jetës, mbetet për t'u zhvilluar. Progres i mirë është arritur me nënshtrimin në fushën e shkencës dhe hulumtimit. Megjithatë përpjekje të mëtejshme nevojiten për të lehtësuar integrimin e Serbisë në Zonën Evropiane të Kërkimit dhe për të forcuar kapacitetin e saj kombëtare të kërkimit.

Negociatat për anëtarësimin e Serbisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) janë afër mbarimit, bisedimet dypalëshe tanimë janë përfunduar me shumicën e partnerëve të OBT-së.

Në lidhje me politikat sektoriale, në fushën e industrisë dhe të NVM-ve, Serbia ka avancuar shumë drejt përmbushjes së standardeve evropiane. Përgatitja e një strategjie industriale është në një fazë shumë të hershme.

Serbia po përparon mirë në drejtim të përmbushjes së standardeve evropiane në fushën e politikave të bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitarisë. Korniza ligjore vazhdon të përmirësohet. Megjithatë, implementimi dhe zbatimi ka nevojë të përmirësohet, veçanërisht në fushën e sigurisë së ushqimit. Kapaciteti administrativ është i dobët dhe burimet duhet të shpërndahen në mënyrë më efektive. Shërbimet e inspektimit kanë nevojë për trajnim të mëtejshëm. Rekrutimi i stafit të kualifikuar duhet të ndodhë në organet e themeluara rishtazi. Progres është arritur në lidhje me kontrollin zyrtar të laboratorëve.

Në fushën e mjedisit, Serbia mbetet me avancim të moderuar drejt përmbushjes së standardeve evropiane. Programi Kombëtar për Mbrojtjen e Mjedisit 2010-2019 dhe një sërë ligjesh mbi ajrin dhe cilësinë e ujit si dhe për mbrojtjen e natyrës dhe të ndryshimeve klimatike janë miratuar. Agjencia e re mbi kimikatet është bërë operative. Megjithatë, kapacitetet për të zbatuar legjislacionin ende duhet të forcohen.

Serbia ka arritur disa përparime në fushën e transportit. Dispozitat mbi hyrjen në treg të Marrëveshjes Evropiane mbi Aviacionin Civil tani janë duke u zbatuar. Sidoqoftë, korniza ligjore mbetet për t'u miratuar në sektorin e hekurudhave. Kapaciteti administrativ duhet të forcohet.

Në sektorin e energjisë, Serbia ka arritur disa përparime në drejtim të harmonizimit me standardet evropiane. Megjithatë, progresi mbetet i pabarabartë. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të arritur shthurjen dhe hapjen e vërtetë të tregut së bashku me një politikë të caktimit të çmimeve gjë që ofron tarifa të qëndrueshme që pasqyrojnë kostot. Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të forcuar rregullatorin bërthamor.

Disa përparime janë arritur në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medieve. Korniza legjislative është forcuar, por zbatimi mbetet i ngadalshëm përderisa zhvillimet e papërshtatshme të tregut dhe rregullative në sektorin e komunikimeve elektronike paraqesin një shqetësim të veçantë. Përgatitjet në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit kanë avancuar në masë të moderuar. Në sektorin audio-vizual, legjislacioni i medieve duhet të jetë në linjë me *acquis*, dhe një sërë dispozitash të Ligjit për informimin publik vazhdojnë të rrisin shqetësimet.

Ndërsa Serbia është ende në fazat e hershme të futjes së praktikave të mira në kontrollin publik të brendshëm financiar dhe auditim të jashtëm, mund të raportohet një progres i caktuar me vendosjen e

kontrollit financiar përmes Njesisë Qendrore për Harmonizim dhe auditimit të parë të llogarive të shtetit nga ana e institucionit shtetëror për auditim.

Serbia ka arritur përparim të mirë në avancimin drejt përmbushjes së standardeve evropiane në fushën e statistikave duke miratuar ligje mbi statistikën dhe regjistrimet e popullsisë si dhe për bujqësi. Përgatitjet për regjistrimin e popullsisë kanë avancuar në masë të madhe por financimi i tij mbetet për t'u siguruar. Megjithatë, progres i mëtijshëm nevojitet në disa fusha statistikore dhe përpjekje të tjera janë të nevojshme për të forcuar kapacitetin e zyrës statistikore.

Progresi në fushën e lirisë, drejtësisë dhe sigurisë ka vazhduar. Udhëtimi pa viza hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2009 për qytetarët serbë që posedojnë pasaporta biometrike.

Ka pasur pak progres në fushën e menaxhimit të kufirit, kryesisht nëpërmjet përmirësimit të pajisjeve dhe infrastrukturës. Megjithatë, përpjekje të mëtijshme janë të nevojshme për të eliminuar dallimet ndërmjet pikave të veçanta të kalimit kufitar dhe për të përmirësuar kontrollin në kufi me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinë dhe Kroacinë dhe në veçanti në vijën e kufirit administrativ me Kosovën.

Pak progres është arritur në fushën e azilit. Një listë e vendeve të sigurta për azilkërkuesit u miratua. Megjithatë, Zyra për azil, organi i shkallës së parë për kërkesa të azilit nuk është themeluar. Shumë raste janë të mbyllura për shkak se kandidatët largohen nga territori serb apo zhduken. Serbia ka arritur disa përparime në fushën e migracionit. Zbatimi i marrëveshjes së riatdhesimit mes Serbisë dhe Bashkimit Evropian ka vazhduar pa probleme të mëdha. Megjithatë, zbatimi efektiv i strategjisë për menaxhimin e migracionit është e duke munguar. Përpjekje janë të nevojshme për të përmirësuar koordinimin mes organeve përgjegjëse dhe për të forcuar kapacitetet e tyre.

Disa përparime janë arritur për të parandaluar pastrimin e parave. Një plan veprimi u miratua dhe një trup koordinues është themeluar. Kanë vazhduar përpjekjet për të përmirësuar bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në hetimin dhe përpunimin e veprave penale. Megjithatë, rezultatet praktike kanë mbetur të dobëta. Administrata për Parandalimin e Pastrimit të Parave ka mungesë të kapaciteteve për të identifikuar sistematikisht rastet e dyshimta. Raportimi duhet të përmirësohet, në mënyrë të veçantë jashtë sektorit bankar. Shërbimet e gjyqësorit dhe të zbatimit të ligjit kanë ekspertizën e nevojshme në rastet e pastrimit të parave dhe të hetimeve financiare. Janë të rralla rastet që përfundojnë me dënime.

Progres i mirë mund të raportohet në fushën e luftës kundër drogës. Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë vazhduar hetimet dhe kanë përmirësuar bashkëpunimin ndërkombëtar, duke shpie drejt kapjes së sasive të mëdha të drogës së paligjshme. Megjithatë, dobësitë vazhdojnë të ekzistojnë në mbikëqyrjen e kufijve me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Kroacinë si dhe linjën kufitare administrative me Kosovën.

Ngritja e kapaciteteve në kuadër të policisë ka vazhduar me përmirësimin e shërbimeve të specializuara të policisë penale. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të ndryshme policore, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është përmirësuar. Megjithatë, planifikimi strategjik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të përmirësohen si dhe procedurat e punësimit duhet të bëhen më transparente. Kontrolli i brendshëm duhet të forcohet.

Progres i mirë është arritur në luftën kundër krimit të organizuar. Bashkëpunimi në mes të agjencive relevante është përmirësuar brenda vendit, në rajon dhe jashtë vendit dhe kjo dhënë rezultate të mira të hetimeve të profileve të larta dhe arrestimin e disa të dyshuarve. Konfiskimi i pasurisë filloi në një mënyrë më sistematike dhe konfiskimet janë kryer në një sërë rastesh. Megjithatë, një Kod i Procedurës Penale i ri dhe i rishikuar në masë të konsiderueshme ende nuk është miratuar. Kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit për përdorimin e teknikave moderne të hetimit, në veçanti në fushën e hetimeve financiare, duhet të forcohen më tej.

Procedurat për të identifikuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë miratuar dhe numri i viktimave të identifikuara vazhdon të rritet. Megjithatë, korniza strategjike duhet të ndryshohet për të mundësuar një përgjigje më të mirë politike ndaj trendeve të reja si dhe nevojitet përmirësim i bashkëpunimit në mes të policisë, prokurorisë dhe gjykatave. Serbia ka arritur progres në luftën kundër terrorizmit me miratimin e Ligjit për sigurinë ushtarake dhe agjencinë e inteligjencës ushtarake. Megjithatë, politikat e parandalimit duhet të përmirësohen. Një databazë për të dyshuarit terrorist ende nuk është themeluar.

Ka pasur pak progres në mbrojtjen e të dhënave personale. Strategjia për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale u miratua në gusht të vitit 2010. Pavarësisht nga disa përmirësime, zyra e Komisionarit për Informata publike dhe mbrojtja e të dhënave personale vazhdon të ketë mungesë të resurseve financiare dhe njerëzore. Mbrojtja e të dhënave personale është një parakusht kryesor për Serbinë në mënyrë që të arrijë një marrëveshje me Eurojust-in dhe një marrëveshje operationale me Europol-in.

Kosova

Kosova ka arritur progres sa i përket kriterëve politike. Ka forcuar angazhimin e saj për agjendën evropiane dhe reformat politike si dhe ka themeluar një Ministri për Integritet Evropian. Qeveria ka siguruar zbatimin e suksesshëm të Procesit të dialogut të Stabilizim-Asociimit (PSA) me Bashkimin Evropian. Autoritetet tani duhet të ngritin ritmin e reformës. Kapacitetet e administratës publike mbesin të dobëta dhe gjyqësori nuk është duke funksionuar në mënyrë efikase. Sundimi i ligjit mbetet një shqetësim serioz. Bashkëpunimi me misionin e BE-së për sundimin e ligjit (EULEX) është përmirësuar dhe autoritetet kanë nisur një sërë operacionesh kundër korrupsionit me mbështetjen e EULEX-it. Këto përpjekje duhet të vazhdojnë dhe të mbulojnë krimin e organizuar, drogën dhe pastrimin e parave. Zgjedhjet janë thirrur pas dorëheqjes së Presidentit të Kosovës.

Kosova ka arritur përparim të rëndësishëm në procesin e decentralizimit. Katër komuna të reja janë themeluar dhe tani janë operative. Zgjedhjet lokale janë mbajtur në fund të vitit 2009. Një mision i Parlamentit Evropian ka vlerësuar që procesi zgjedhor u zhvillua në një mjedis të qetë me pjesëmarrje të konsiderueshme të votuesve, përfshirë edhe votues nga komuniteti serb i Kosovës. Megjithatë, shqetësimet mbesin në lidhje me veriun e Kosovës. Kanë ndodhur një sërë incidentesh të dhunshme. Decentralizimi mund të përfundojë vetëm me pjesëmarrjen e popullatës lokale. Duhet të arrihet më tepër për të siguruar integritetin e të gjitha komuniteteve dhe ofrimin e shërbimeve publike në të gjitha komunat. Mbështetja nga komunitetet lokale është e rëndësishme në këtë drejtim, duke përfshirë një rol konstruktiv në konsolidimin e sundimit të ligjit. Strukturat paralele vazhdojnë të operojnë duke penguar procesin e decentralizimit.

Në korrik, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) lëshoi një opinion këshillues që arriti në përfundim që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare ose Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Pas rezolutës së Këshillit të Përgjithshëm të OKB-së të datës 9 shtator, BE-ja ka vërtetuar gatishmërinë e saj për të lehtësuar një proces të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për të nxitur bashkëpunim dhe arritur përparim në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe për të përmirësuar jetën e njerëzve. Përpjekje të vendosura janë të nevojshme nga të gjitha palët për përfshirje dhe funksionim efikas në forumet rajonale.

Lidhur me demokracinë dhe sundimin e ligjit, nuk ka pasur progres në forcimin e strukturave ekzekutive dhe parlamentare, në veçanti sa i përket integritimit evropian. Mirëpo, sundimi i ligjit ka nevojë për forcim të mëtejshëm dhe është një çështje shqetësuese.

Në shtator, Gjykata Kushtetuese vendosi që është jo-kushtetuese që në të njëjtën kohë të udhëhiqet zyra e Presidentit të Kosovës dhe e Kryetarit / Presidentit të një partie politike. Pas këtij vendimi Presidenti i Kosovës dha dorëheqje. LDK-ja pastaj u tërhoq nga koalicioni qeverisës. Zgjedhjet janë thirrur për 12 dhjetor të vitit 2010.

Asambleja ka themeluar një komision për llogaritë publike. Komisioni për Integritime Evropiane ka përshtatur rregullat dhe procedurat e veta. Megjithatë, kapacitetet për të shqyrtuar draft legjislacionin dhe për të monitoruar zbatimin pas miratimit mbeten të dobëta. Mbikëqyrja parlamentare dhe qeveritare duhet të forcohet më tej.

Strukturat kryesore të qeverisë janë vendosur dhe vazhdojnë të funksionojë në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese. Ministria për Integritime Evropiane ka pasur një fillim të mirë dhe tani ka nevojë për të forcuar kapacitetet e saj dhe për të konsoliduar rolin e saj në bashkërendimin e departamenteve të tjera qeveritare.

Reforma e administratës publike në Kosovë mbetet një sfidë e madhe. Korniza ligjore është zhvilluar më tej me miratimin e ligjeve të shërbimit civil dhe të pagave. Kapacitetet e administratës publike për të ofruar shërbimet e nevojshme për të gjithë personat në Kosovë duhet të fuqizohet ndjeshëm. Administrata publike në Kosovë mbetet e dobët.

Kosova ka arritur përparim lidhur me reformimin e sistemit gjyqësor. Reforma të mëdha gjyqësore janë filluar me miratimin e katër ligjeve të reformës për gjykatat, për ndjekjen penale, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Ligji mbi gjykatat fut në veprim një sistem të ri të pagave që përmirëson ndjeshëm gjendjen e gjyqtarëve. Shqyrtimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve gjithashtu është përfunduar. Mbi 340 gjyqtarë dhe prokurorë janë emëruar nga Presidenti për pozita në të gjitha nivelet e gjyqësorit. Kjo përfshin emërimin e anëtarëve vendor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të cilët kanë zgjedhur presidentin e Këshillit. Pas dhënies së provimit të jurispondencës, gjyqtarët dhe prokurorët e parë të ardhshëm kanë diplomuar në Institutin Gjyqësor të Kosovës në dhjetor të vitit 2009. Megjithatë, ka pasur raste të ndërhyrjes politike në sistemin gjyqësor, sidomos në procesin e riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ende ekziston një numër i konsiderueshëm i rasteve të grumbulluara, sidomos në çështjet civile, duke përfshirë të drejtat pronësore. Institucionet e Kosovës duhet t'i japin rëndësi të duhur mbështetjes së hetimeve dhe përkrahjes juridike për çështje të krimeve të luftës. Planet për të zbatuar reformat e gjyqësorit duhet të përgatiten dhe të ndahen mjetet. Kosova ende është në një fazë të hershme të adresimit të prioritetëve në fushën e drejtësisë.

Korniza ligjore kundër korrupsionit është përmirësuar me miratimin e ligjeve të agjencisë kundër korrupsionit dhe me deklarin e origjinës së pasurisë dhe dhuratave për zyrtarët e lartë publik. Ligji mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike është ndryshuar. Ligji për financimin e partive politike nuk është plotësisht në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, rezultatet në luftën kundër korrupsionit janë të kufizuara. Fushat kryesore me interes vazhdojnë të jenë të procesit të prokurimit dhe sistemit të gjykatave dhe të zbatimit të ligjit. EULEX-i ka pasur për të vazhduar ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv në raste të profileve të larta. Ekzistojnë një sërë hetimesh kundër korrupsionit. Në prill, kërkimet u ndërmorën në ministri të transportit, në korrik Policia e Kosovës arrestoi guvernatorin e bankës qendrore në bashkëpunim me EULEX-in. Qeveria ka bashkëpunuar me këto hetime. Korrupsioni mbetet i përhapur në Kosovë dhe paraqet problem shumë serioz. Korniza ligjore mbetet e pakompletuar dhe nuk përputhet plotësisht me standardet evropiane.

Kushtetuta garanton të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve dhe liston marrëveshjet kryesore ndërkombëtare dhe instrumentet e zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Megjithatë, struktura institucionale dhe mungesa e vullnetit politik pengojnë zbatimin efektiv të standardeve ligjore në këtë fushë. Procesi i integritetit të komunitetit serb është në vazhdim. Autoritetet duhet të bëjnë më shumë për të adresuar shqetësimet kryesore siç janë qasja në pronë, personat e zhdukur, kthimi dhe arsimimi.

Ka pasur pak progres në të drejtat civile dhe politike. Qeveria duhet të bëjë më tepër sa i përket parandalimit të torturës, dhe të bëjë më tepër lidhur me akuzat për keqtrajtim dhe përdorim të tepruar të forcës nga policia dhe punonjësit e burgut. Kushtet në burgje janë ende shqetësim. Ka pasur progres të kufizuar sa i përket qasjes në drejtësi.

Liria e shprehjes ende nuk është e garantuar në praktikë. Pavarësia dhe paanshmëria e transmetuesit publik duhet të forcohet. Gazetarët vazhdojnë të kërcënohen si përgjigje ndaj raportimeve të tyre. Ata gjithashtu ballafaqohen me vështirësi të qasjes në dokumente zyrtare. Legjislacioni për lirinë e anëtarësimit në sindikata nuk ka lehtësuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe financimin e organizatave jo-qeveritare. Kapaciteti i shoqërisë civile për të monitoruar dhe vlerësuar punën e qeverisë është në rritje. Megjithatë, shoqëria civile është ende e dobët dhe nuk konsultohet sistematikisht nga komunat dhe qeveria në kuadër të procesit legjislativ.

Të drejtat ekonomike dhe sociale ende nuk garantohen plotësisht. Korniza ligjore për mbrojtjen e grave është përforcuar. Ka pasur pak progres në fushën e drejtësisë për të miturit. Veç kësaj, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve mbetet e dobët. Qeveria duhet të merret në mënyrë më efektive me çështjen e fëmijëve që punojnë dhe trafikimin e fëmijëve. Integrimi social dhe mbrojtja e grupeve të cënueshme, në veçanti për fëmijët e braktisur, të kthyerit dhe personat me aftësi të kufizuara, duhet të përmirësohet. Kosova ka nisur një fushatë kundër diskriminimit për rritjen e ndërgjegjësimit me theks të veçantë në diskriminimin në bazë të moshës dhe orientimit seksual. Zbatimi i legjislacionit kundër diskriminimit mbetet i papërshtatshëm. Zbatimi i urdhrave të gjykatës që garantojnë ushtrimin e të drejtave të pronës është përmirësuar. Megjithatë, sasia e konsiderueshme e rasteve të mbledhura dhe çështjeve tjera të pazgjidhura seriozisht pengojnë ri-posedimin e pronave.

Ka pasur progres të kufizuar sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve dhe të drejtave kulturore. Ministria e Kulturës ka ngritur një drejtori për trashëgiminë kulturore. Rindërtimi i objekteve fetare ka vazhduar. Policia e Kosovës ka marrë përsipër përgjegjësinë nga KFOR-i për mbrojtjen e

vendeve të caktuara fetare dhe kulturore. Megjithatë, ligji mbi trashëgiminë kulturore nuk është zbatuar në tërësi. Këshilli për vëzhgim i parashikuar në ligjin e vitit 2008 për zonat e veçanta të mbrojtura është duhet të vendoset. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka shtuar përpjekjet e saj për të ndihmuar kthimin e pakicave të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit. Numri i të kthyerve vullnetare është në rritje në tërë Kosovën.

Në dhjetor të vitit 2009, Kosova ka miratuar një plan veprimi për zbatimin e strategjisë për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Qeveria ka krijuar strukturat për zbatimin e kësaj strategjie. Procesi i rivendosijes së familjeve nga zonat e ndotura me plumb në Kosovën veriore ka filluar, duke mundësuar mbylljen e kampit të Çeshmellugës. Ky proces duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur. Kushtet e jetesës për Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe qasja e tyre në arsim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje sociale janë ende çështje shumë shqetësuese. Pjesëmarrja e Kosovës në Dekadën e Romëve duhet të konsolidohet.

Lidhur me detyrimet rajonale dhe ndërkombëtare, gjatë periudhës raportuese Kosova ka vazhduar të bashkëpunojë me Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY). Më shumë se dhjetë vjet pas përfundimit të konfliktit të armatosur, 1.800 persona vlerësohen të jenë të zhdukur. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në këtë fushë. Kosova mori pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë në Sarajevë BE-Ballkan Perëndimor në qershor. Sidoqoftë, Kosova duhet të miratojë një qëndrim konstruktiv në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e saj efektive në iniciativat e bashkëpunimit, siç janë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA). Lidhur me CEFTA-n, Kosova duhet të jetë pragmatike dhe të kërkojë një mënyrë konstruktive për të ecur përpara në sigurimin e zbatimit efikas të kësaj marrëveshjeje. Pullat doganore të Kosovës, të cilat Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ka konfirmuar që janë në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244/99, nuk janë njohur nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Një zgjidhje e pranueshme dhe e qëndrueshme për pjesëmarrjen e Kosovës dhe Serbisë në forumet kryesore rajonale duhet të akordohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo është esenciale për gjithëpërfshirjen dhe funksionimin e bashkëpunimit rajonal.

Ndikimi i krizës ekonomike në ekonominë e Kosovës ka qenë i kufizuar. BPV-ja reale ka vazhduar rritjen e nxitur kryesisht nga shpenzimet publike. Ka rritje të rreziqeve për qëndrueshmërinë e këtij profili të rritjes. Papunësia mbetet shumë e lartë. Inflacioni ka qenë i paqëndrueshëm, duke reflektuar luhatjen e çmimeve të ushqimit dhe të karburanteve. Formulimi i politikave dhe zbatimi kanë vazhduar të kenë mungesë të parashikueshmërisë. Një marrëveshje është arritur me FMN-në për një program që synon të kufizojë rreziqet fiskale dhe të kthejë qëndrueshmërinë fiskale. Shoqëritë tregtare vazhdojnë të përballen me sundim të dobët të ligjit, me mungesë të furnizimit të energjisë elektrike, infrastrukturë të dobët dhe qasje të kufizuar në financim. Këto janë pengesa për biznes efektiv dhe zhvillimin ekonomik.

Sa i përket kritereve ekonomike, Kosova ka arritur progres të kufizuar në krijimin e një ekonomie funksionale të tregut. Reforma dhe investime të konsiderueshme janë të nevojshme për të mundësuar përballjen afat-gjate me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Një konsensus i gjerë është ruajtur mbi bazat e politikave të orientuara në tregun ekonomik. Përdorimi i euros, nivelet e ulëta të borxhit të jashtëm dhe baza e ulët e eksporteve kanë kufizuar ekspozimin e ekonomisë ndaj goditjeve të jashtme financiare dhe të kërkesës. Sektori bankar ka vazhduar të zgjerohet dhe të mbetet i qëndrueshëm dhe fitimprurës. Agjencia Kosovare e Privatizimit ka vazhduar privatizimin

e ndërmarrjeve shoqërore. Projekti i parë i suksesshëm i partneritetit publiko-privat është përfunduar dhe një konzorcium ndërkombëtar është zgjedhur për zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës me një koncesion për njëzet vjet.

Megjithatë, përzierja e politikave është gjithnjë e më e cenueshme si rezultat i rritjes së fuqishme të shpenzimeve qeveritare. Në mënyrë të veçantë, ndërtimi i një autostrade të re peshon rëndë mbi financat publike. Mangësitë në formulimin e politikave dhe zbatimin kanë rritur pasigurinë tashmë të lartë në ekonomi. Statistikat ekonomike janë përmirësuar disi, por ende në masë të pamjaftueshme. Papunësia mbetet shumë e lartë sidomos tek të rinjtë. Deficiti i llogarisë rrjedhëse është zgjeruar për shkak të kërkesës së brendshme dhe një baze të pazhvilluar të prodhimit. Kompania publike e energjisë elektrike ka vazhduar të marrë subvencione të konsiderueshme nga buxheti i shtetit për importin e energjisë elektrike dhe kredi për financimin e programit të saj për investime. Sundimi i dobët i ligjit, pasiguria mbi të drejtat pronësore dhe normat e larta të interesit vazhdojnë të ndikojnë negativisht në mjedisin e biznesit dhe në zhvillim ekonomik. Sektori joformal mbetet sfidë e rëndësishme.

Përparimi në përfrimin e legjislacionit dhe politikave të Kosovës me standardet evropiane vazhdon të jetë i përzier. Korniza ligjore është zhvilluar më tej në fushën e doganave, tatimeve, lëvizjes së lirë të mallrave, statistikave, migrimit, arsimit dhe anti-terrorizmit. Përfrimi është në një fazë të hershme sa i përket konkurrencës, pronësisë intelektuale, mjedisit, bujqësisë dhe sigurisë së ushqimit, gjithashtu edhe sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve, azilit, pastrimit të parave dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Përputhshmëria me standardet evropiane mbetet e kufizuar në fushat e punësimit dhe politikave sociale, kontrollit financiar, trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore dhe krimit të organizuar.

Në fushën e tregut të brendshëm të BE-së ka pasur pak progres, në zhvillimin e kornizës ligjore për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë edhe mbrojtjen e konsumatorëve. Megjithatë, korniza ligjore në përgjithësi duhet të përforcohet. Përputhshmëria me standardet evropiane në fushën e lëvizjes së lirë të personave, si dhe liria për të ofruar shërbime dhe e drejtën e themelimit janë të kufizuara. Fusha e lëvizjes së lirë të kapitalit tashmë është avancuar. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme sa i përket rregullores në fuqi.

Dispozitat ligjore për dogana janë përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane dhe përpjekje për të luftuar korrupsionin janë ndërmarrë. Përpjekjet për të ndaluar kontrabandën duhet të rriten. Kontrollat doganore duhet të forcohen në veri të Kosovës. Kapaciteti administrativ është përmirësuar, por mbetet i pamjaftueshëm. Ka pasur zhvillime pozitive sa i përket legjislacionit dhe ndërtimit të kapaciteteve në fushën e tatimeve. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të ligjeve në fuqi, për të zbatuar pagimin e tatimeve, për të zgjeruar bazën tatimore dhe, si rrjedhojë, për të reduktuar ekonominë joformale në masë të konsiderueshme. Numri i rasteve kundër vendimeve të Shërbimit Doganor dhe Administratës Tatimore është rritur.

Në fushën e konkurrencës, nuk ka pasur asnjë përparim në politikën anti-trust ose në rregullat e ndihmës shtetërore. Kapaciteti administrativ është përmirësuar, por zbatimi i politikës së konkurrencës është në përgjithësi në një fazë të hershme. Bashkëpunimi në mes institucioneve të përfshira në çështjet e konkurrencës duhet të forcohet. Komisioni i Konkurrencës duhet të jetë në mënyrë më të përafërt i përfshirë në privatizime të mëdha dhe iniciativa të ristrukturimit.

Kosova mbetet të miratojë një ligj të ri të prokurimit. Qeveria ka bërë përpjekje në këtë drejtim. Zbatimi në praktikë i ligjit ekzistues shkakton shqetësime. Roli i zyrtarëve të prokurimit publik duhet të forcohet me qëllim për të përforcuar monitorimin e zbatimit të kontratave të prokurimit. Pavarësia dhe profesionalizmi në sistemin e prokurimit publik duhet të rritet. Autoritetet duhet të bëjnë më shumë për të luftuar korrupsionin në këtë fushë. Dispozitat e Kosovës për koncesione ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga standardet evropiane.

Legjislacioni kryesor ende ka nevojë për t'u siguruar për të drejtat e pronësisë intelektuale. Përpjekje të mëdha janë të nevojshme për zbatimin dhe ngritjen e vetëdijes. Regjimi i Kosovës për të drejtat e pronësisë intelektuale është në një fazë të hershme dhe zbatimi është shumë i dobët.

Ka pasur progres të kufizuar në nënshtrimin ndaj fushave të punësimit dhe shëndetit publik. Kapaciteti i dobët administrativ dhe një kornizë ligjore e përshtatshme janë çështje shqetësuese. Mbrojtja sociale dhe përfshirja në Kosovë, si dhe dialogu social, duhet të përmirësohen. Korniza ligjore në fushën e arsimit është më afër standardeve evropiane; rritja e kapaciteteve administrative është e nevojshme për të zbatuar reformat. Kosova ka zhvilluar një program pesëvjeçar kërkimi dhe pritet të përmirësojë kapacitetet në këtë sektor. Kjo zonë është caktuar si prioritet.

Sa i përket politikave sektoriale, zhvillimi dhe NVM-të duhet të promovohen në mënyrë më efektive dhe strategjitet e ndryshme që ndikojnë në këtë fushë duhet të bashkërendohen më mirë. Përpjekjet duhet të përshejtohen në fushat e bujqësisë dhe të sigurisë së ushqimit, në veçanti sa i përket zbatimit të legjislacionit të miratuar dhe përmirësimit të impianteve agro-ushqimore. Një numër i ligjeve mjedisore janë miratuar. Megjithatë, zbatimi i standardeve të BE-së për mjedisin është ende në një fazë të hershme.

Infrastruktura e transportit mbetet e pazhvilluar. Kosova ka ndërmarrë një program të ndërtimit të rrugëve që nuk pasqyron rrjedhat e planifikuara të trafikut, si dhe madhësia e programit ka lënë pas dore investimet në mjete tjera të transportit, veçanërisht hekurudhat. Përputhshmëria me standardet evropiane në fushën e aviacionit është përmirësuar. Në dhjetor të vitit 2009, Kosova ka miratuar programet e sigurisë së aviacionit dhe të kontrollit të cilësisë.

Në sektorin e energjisë, ka sfida të mëdha në lidhje me zbatimin e pagesës së energjisë elektrike dhe menaxhimin e një rritjeje të paqëndrueshme të kërkesës për energji. Në prill Kosova ka miratuar një strategji energjetike që mbulon periudhën 2009-2018. Në tetor të vitit 2010, pas një vonese të konsiderueshme, u miratua paketa e ligjeve kyçe në këtë fushë (për energji, energji elektrike dhe për Rregullatorin e energjisë).

Ka pasur progres të kufizuar në fushën e shoqërisë së informacionit dhe të medieve. Pavarësia dhe burimet e Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit duhet të përforcohen si dhe pavarësia e Këshillit të Pavarur për Media të garantohet në rishikimin e tanishëm të ligjit të KPM-së. Një zgjidhje afat-gjatë duhet të gjendet për financimin e shërbimit të transmetuesit të publik.

Nuk ka pasur progres sa i përket kontrollit financiar. Megjithatë, Kosova ende është në një fazë të hershme të futjes në veprim të standardeve ndërkombëtare. Mungesa e pavarësisë financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ende paraqet shqetësim. Në korrik, Kosova ka miratuar ligjin për statistikën zyrtare. Megjithatë, kapacitetet administrative mbeten të dobëta dhe përpjekje të mëtejshme janë të

nevojshme për të përmirësuar statistikat sektoriale dhe në veçanti statistikat biznesore dhe makro-ekonomike.

Ka pasur progres të përzier në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Kosova ka arritur progres sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve. Kosova ka marrë përsipër përgjegjësitë nga KFOR-i për menaxhimin e kufirit me Shqipërinë. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për të siguruar menaxhimin e kufijve në përputhje me standardet e BE-së. Veriu mbetet një sfidë e veçantë. EULEX-i ka intensifikuar aktivitetet e veta në Portat 1 dhe 31. Kosova ka arritur përparim të kufizuar në fushën e azilit. Numri i kërkesave për azil është rritur ndjeshëm, por në përgjithësi ka mbetur i ulët. Shumica e azil-kërkuesve që dalin nga Kosova për destinacione tjera nuk kanë pasur kontroll të mjaftueshëm nga ana e autoriteteve të Kosovës.

Ka pasur progres drejt përafrimit me standardet evropiane në fushën e migrimit. Kosova ka miratuar një ligj të riadhesimit që në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e BE-së. Kosova ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh dypalëshe të riadhesimit. Autoritetet kanë vazhduar të merren në mënyrë efektive me kërkesat e riadhesimit nga vendet evropiane. Kjo duhet të vazhdojë. Një strategji e rishikuar për integrimin e personave të riadhesuar është miratuar, si dhe një plan veprimi për zbatimin e saj.

Pastrimi i parave mbetet një çështje shqetësuese. Kosova ka miratuar një ligj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Bashkëpunimi në mes të Shërbimit Doganor dhe Qendrës së Inteligjencës Financiare është përmirësuar. Qendra ka përmirësuar edhe bashkëpunimin e saj me bankat. Megjithatë, Kosova është ende në një fazë të hershme të miratimit dhe zbatimit të standardeve evropiane në këtë fushë. Kapacitetet për të hetuar dhe ndjekur penalisht pastrimin e parave janë ende të dobëta. Autoritetet e Kosovës nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të marrë përgjegjësi për menaxhimin e pastrimit të parave. Në përgjithësi, progres i kufizuar është arritur në trajtimin e krimit ekonomik dhe financiar.

Ka pasur progres të kufizuar në parandalimin e trafikut të drogës. Siguria e dhomave për ruajtjen e drogës së kapur është përmirësuar. Autoritetet kanë kryer një sërë operacionesh të suksesshme. Megjithatë, konfiskimet, arrestimet dhe ndjekjet penale mbeten në nivel të ulët. Përpjekjet për adresimin e trafikut të drogës janë ende në një fazë të hershme.

Kosova ka arritur progres në aspektin e policisë. Rendi publik është ruajtur. Ceremonia e kurorëzimit të patriarkut të Kishës ortodokse serbe u zhvillua në një atmosferë të qetë. Struktura e re organizative e Policisë së Kosovës është miratuar, duke përfshirë edhe përkrahimin e punës për menaxhmentin e lartë. Është miratuar strategjia dhe plani i veprimit për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta si dhe strategjia e mbledhjes së tyre. Grumbullimi i armëve ilegale është rritur. Megjithatë, Policia e Kosovës ka nevojë për të zhvilluar një shërbim informativ të zbulimit të udhëhequr nga policia në mënyrë që të adresojë krimet e rënda në mënyrë më efektive.

Ka pasur progres të kufizuar në luftën kundër krimit të organizuar. Kosova ka miratuar një strategji për parandalimin e krimit. Prokurorë special janë emëruar për t'u marrë me krim të organizuar. Një sërë marrëveshjesh bilaterale me vende të treta janë nënshkruar në këtë fushë. Megjithatë, Kosova ka nevojë për të siguruar një kornizë për mbrojtjen efektive të dëshmitarëve. Nuk ka pasur dënime të nivelit të lartë. Ka pasur raste të frikësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Krimi i organizuar vazhdon të mbetet një shqetësim shumë serioz. Autoritetet duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të luftuar krimin e organizuar që

vepron në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë, sidomos nëpërmjet hetimeve, arrestimeve, konfiskimit të aseteve dhe dënimeve. Kosova ka nevojë për të dhënë rezultate konkrete në këtë fushë.

Ka pasur progres të kufizuar sa i përket çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Janë kryer një sërë arrestimesh në një rast të kontrabandimit të qenieve njerëzore. Kosova ka miratuar standardet ndërkombëtare të kujdesit për viktimat e trafikimit. Megjithatë, numri i rasteve të zbuluara dhe i viktimave të identifikuara të trafikimit mbetet i ulët dhe nuk pasqyron plotësisht shkallën e fenomenit. Niveli i ndëshkimit të kryesve nuk është gjithmonë i përshtatshëm. Kapacitetet e institucioneve të Kosovës për të hetuar, ndjekur penalisht dhe dënuar trafikimin e qenieve njerëzore duhet të forcohen. Sa i përket masave të anti-terrorizmit është arritur përparim. Kapacitetet e njesisë kundër terrorizmit në kuadër të Policisë së Kosovës janë përmirësuar.

Kosova ka arritur progres të kufizuar në mbrojtjen e të dhënave personale. Është miratuar një ligj për mbrojtjen e të dhënave personale. Autoriteti mbikëqyrës për mbrojtje të të dhënave ende duhet të vendoset. Individët në Kosovë nuk janë mjaft të informuar për të drejtat e tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Përparimi në këtë fushë është mjaft i rëndësishëm për bashkëpunimin ndërkombëtar të Kosovës në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

Turqia

Turqia vazhdon të përmbushë në masë të mjaftueshme kriteret politike. Reformat e fundit kushtetuese kanë krijuar kushte për përparim në një sërë fushash, siç janë gjyqësia dhe të drejtat themelore. Ato tani duhet të zbatohen në përputhje me standardet evropiane. Hapja demokratike, që synon veçanërisht trajtimin e çështjes Kurde, ende nuk ka përmbushur pritjet.

Pakoja e amendamenteve kushtetuese të miratuara në një referendum më 12 shtator është një hap në drejtimin e duhur. Ajo trajton një sërë prioritetesh të Partneritetit të Anëtarësimit në fushën e gjyqësisë, të drejtave themelore dhe të administratës publike. Megjithatë, hartimi dhe miratimi i reformës kushtetuese nuk u parapri nga një proces konsultimi që përfshinë partitë politike dhe shoqërinë civile në përgjithësi. Është kyç zbatimi i paketës, në përputhje me standardet evropiane dhe në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Përpjekje të mëdha janë ende të nevojshme për të drejtat themelore. Sasia e veprimeve ligjore kundër gazetarëve dhe presioni i panevojshëm në media dëmtojnë lirinë e shtypit në praktikë. Hapja demokratike, e shpallur nga qeveria në gusht të vitit 2009 për të trajtuar sidomos çështjen Kurde përcillet vetëm pjesërisht nga qeveria. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të mbyllur Partinë e Shoqërisë Demokratike (DTP) dhe një rritje e sulmeve terroriste të PKK-së gjithashtu kanë dëmtuar edhe këtë politikë.

Sa i përket demokracisë dhe sundimit të ligjit në Turqi, hetimi i rrjeteve të supozuara kriminale Ergenekon ka vazhduar. Ky hetim dhe hetimi në disa plane të tjera grushteti mbeten një mundësi që Turqia të përforcojë besimin në funksionimin e duhur të institucioneve të saj demokratike dhe sundimin e ligjit. Megjithatë, ka shqetësime sa i përket garancive gjyqësore për të gjithë të dyshuarit. Turqia ende duhet të harmonizojë legjislacionin e saj sipas standardeve evropiane sa i përket procedurave dhe arsyeve për mbylljen e partive politike.

Sa i përket reformave në administratën publike, një përparim është arritur me miratimin e ndryshimeve kushtetuese, në mënyrë të veçantë drejt ngritjes së institucionit të Ombudspersonit, mbrojtjes së të

dhënave personale dhe qasjes në informata. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në mënyrë të veçantë për reformimin e shërbimit civil.

Progres është arritur sa i përket mbikëqyrjes civile të forcave të sigurisë. Pakoja kushtetuese kufizon kompetencat e gjykatave ushtarake dhe hap vendimet e Këshillit të Lartë Ushtarak për shqyrtim gjyqësor. Megjithatë, anëtarë të lartë të Forcave të Armatosura kanë vazhduar të japin deklaratat që janë përtej përgjegjësisë të tyre, në mënyrë të veçantë për çështje gjyqësore. Nuk ka përparim në drejtim të mbikëqyrjes parlamentare të buxhetit të mbrojtjes.

Në fushën e gjyqësorit progres është arritur në zbatimin e strategjisë së reformës gjyqësore. Miratimi i amendamenteve kushtetuese në përbërjen e Këshillit të Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është një hap pozitiv. Megjithatë, Ministri i Drejtësisë ende kryeson Këshillin e Lartë dhe ka fjalën e fundit mbi hetimet. Gjatë procesit të përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të legjislacionit, krijimi i një dialogu efektiv me të gjitha palët do të jetë i nevojshëm. Kjo do të kontribuojë në implementimin e këtyre reformave në përputhje me standardet evropiane në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Progres është arritur në lidhje me zhvillimin e një Strategjie gjithëpërfshirëse anti-korrupsion dhe Plan të Veprimit. Megjithatë, korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha. Turqia ka nevojë të zhvillojë një histori të hetimeve, akuzave dhe dënimeve.

Sa i përket të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve është arritur një përparim në veçanti në aspekt të lirisë së mbledhjes, të drejtave të grave, fëmijëve dhe kulturore. Megjithatë, përpjekje të konsiderueshme janë ende të nevojshme veçanërisht për lirinë e shprehjes dhe lirinë e fesë.

Sa i përket respektimit të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, institucionet për të drejtat e njeriut duhet të jenë plotësisht në pajtim me parimet e OKB-së.

Trendet pozitive në parandalimin e torturës dhe të keqtrajtimit vazhdojnë. Disa raste të profileve të larta të shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë shpie në dënime. Megjithatë, përdorimi i tepruar i forcës nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit vazhdon të raportohet dhe është çështje shqetësuese.

Zbatimi i programit të reformës së burgjeve vazhdon. Megjithatë, përqindja e lartë e të burgosurve në paraburgim mbetet një nga problemet më të rëndësishme. Shërbimi shëndetësor në burg duhet të përmirësohet.

Ligji Turk nuk garanton lirinë e shprehjes në pajtim me KEDNj dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Numri i lartë i rasteve të iniciuara ndaj gazetarëve është shqetësues. Presionet e panevojshme politike ndaj medieve dhe paqartësitë ligjore kanë ndikim në ushtrimin e lirisë së shtypit në praktikë. Ndalimet e shpeshta të faqeve të internetit paraqesin burim shqetësimi.

Ka pasur një lloj përparimi sa i përket lirisë së tubimit. Demonstratat që kishin ngjallur trazira në të kaluarën, siç janë festimet Neuroz (viti i ri Kurd), ose 1 maji, janë zhvilluar në mënyrë paqësore dhe janë koordinuar mirë me autoritetet. Megjithatë, disa demonstrata në jug-lindje për çështjen Kurde vazhduan të shoqërohen me përdorim të tepruar të forcës nga ana e forcave të sigurisë.

Korniza ligjore për lirinë e Asociimit është në përgjithësi në përputhje me standardet e BE-së. Megjithatë, autoritetet ushtrojnë kontroll të tepërt dhe vazhdojnë të nisin raste të mbylljes kundër shoqatave LGBT.

Në lidhje me lirinë e fesë, liria e adhurimit vazhdon të respektohet në përgjithësi. Ligjit mbi fondacionet është zbatuar në vazhdimësi, edhe pse me disa vonesa dhe probleme procedurale. Dialogu me Alevitet dhe jo-muslimanët ka vazhduar, por ende nuk ka dhënë rezultate. Anëtarët e feve të pakicave vazhdojnë të jenë objekt i kërcënimeve nga ekstremistët. Një kornizë ligjore në përputhje me KEDNJ-në mbetet të vendoset në mënyrë që të gjitha komunitetet fetare jo-muslimane dhe komuniteti Alevitë të mund të funksionojnë pa pengesa të panevojshme, duke përfshirë trajnimin e klerikëve.

Korniza ligjore që garanton të drejtat e grave dhe barazinë gjinore është siguruar në përgjithësi. Kjo kornizë është forcuar përmes amendamentit kushtetues që ka lejuar miratimin e masave të diskriminimit pozitiv për gratë. Megjithatë, nevojiten përpjekje të qëndrueshme të mëtejshme për ta kthyer këtë kornizë ligjore në një realitet politik, social dhe ekonomik. Sigurimi i të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në praktikë mbeten sfidat kryesore për Turqinë. Vrasjet e nderit dhe martesat e detyruara si dhe dhuna në familje mbeten probleme serioze.

Legjislacioni duhet të implementohet në mënyrë konsistente në gjithë vendin. Arsimimi i mëtejshëm dhe përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore janë të nevojshme.

Ka pasur progres në lidhje me të drejtat e fëmijëve. Turqia ka përshtatur kornizën e vet ligjore për të miturit ndaj standardeve ndërkombëtare. Hendeku gjinor në arsimin fillor vazhdon të ulet, por ai ende vazhdon të ekzistojë në pjesë të caktuara të vendit. Braktisja e shkollimit nga fëmijët mbetet burim i shqetësimit. Përpjekjet duhet të forcohen më tej në të gjitha fushat, duke përfshirë arsimimin, punën e fëmijëve, shëndetësinë, kapacitetet administrative dhe koordinimin, për të ndërtuar një sistem efektiv të drejtësisë për të miturit në tërë vendin.

Amendamentet kushtetuese kanë zgjeruar të drejtat e sindikatave në Turqi, sidomos për shërbimin publik. Megjithatë, ka dispozita kufizuese në kornizën e tanishme ligjore të cilat nuk janë në përputhje me standardet e BE-së dhe ONP-së. Mungesa e konsensusit në mes të partnerëve socialë dhe qeverisë është një pengesë për miratimin e legjislacionit të ri.

Qasja e Turqisë ndaj respektimit dhe mbrojtjes së minoriteteve dhe të drejtave kulturore mbetet e kufizuar. Mbetet të arrihet respektimi i plotë dhe mbrojtja e gjuhës, kulturës dhe të drejtave themelore në përputhje me standardet evropiane. Turqia duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të rritur tolerancën dhe për të promovuar gjithëpërfshirjen kundrejt pakicave.

Disa hapa pozitiv u ndërmorën për të forcuar të drejtat kulturore, në veçanti në lidhje me politikën e Turqisë për transmetimin në gjuhë tjera përveç gjuhës Turke. Megjithatë, kufizimet mbeten, sidomos në përdorimin e gjuhëve të tilla në arsim, jetë politike dhe kontakte me shërbimet publike.

Çështja e romëve është debatuar më tepër në publik si dhe janë duke u zhvilluar masa konkrete për të adresuar disa nga shqetësimet e tyre. Megjithatë, në mungesë të një politike gjithëpërfshirëse për të çuar përpara përfshirjen sociale të romëve, kjo e fundit ende shpesh përballet me trajtim diskriminues për qasje në arsim, strehim, shërbime shëndetësore dhe shërbime publike.

Sa i përket pjesës lindore dhe juglindore, hapja demokratike e qeverisë nuk ka arritur pritjet pasi që vetëm disa masa janë zbatuar në praktikë. Është e rëndësishme që përpjekjet që adresojnë çështjen Kurde të jenë të qëndrueshme përmes konsultimeve të gjera. Legjislacioni anti-terrorist duhet të ndryshohet për të

shmangur kufizimet e panevojshme në ushtrimin e të drejtave themelore. Ekzistenca e minave tokësore të shumta vazhdon të ngritë shqetësimet e tyre. Sistemi i rojës së fshatit mbetet të mbyllet.

Prej qershorit ka pasur rritje të sulmeve terroriste të PKK-së që kanë marrë shumë jetë. PKK është në listën e organizatave terroriste të BE-së. Turqia dhe BE-ja kanë përmirësuar dialogun mbi anti-terrorizmin.

Kompensimi i personave të zhvendosur në vend (PZhBV), ka vazhduar. Megjithatë, zbatimi nuk është efektiv. Qeveria nuk ka zhvilluar një strategji të përgjithshme kombëtare për të trajtuar çështjen e PZhBV-ve dhe ka nevojë të shtojë përpjekjet për të adresuar nevojat e personave të zhvendosur. Korniza ligjore për refugjatët dhe azil-kërkuesit dhe zbatimi i qarkoreve lidhur me procedurat për aplikime duhet të forcohen. Përmirësimet e mëtejshme të kushteve të përgjithshme në qendra të paraburgimit për të huajt paraqesin një çështje të rëndësishme.

Në lidhje me çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare, Turqia vazhdoi të shprehë mbështetjen publike për negociatat midis krerëve të të dy komuniteteve nën zyrat e mira të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-për të gjetur një zgjidhje të plotë të problemit të Qipros. Megjithatë, pavarësisht thirrjeve të përsëritura nga Këshilli dhe Komisioni, Turqia ende nuk i ka respektuar detyrimet e saj siç është përshkruar në deklaratën e Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të saj të datës 21 shtator të vitit 2005 dhe konkluzionet e Këshillit, duke përfshirë edhe konkluzionet e dhjetorit të vitit 2006 dhe dhjetorit të vitit 2009. Ajo nuk i plotëson detyrimet e veta të zbatimit të plotë, jo-diskriminues të Protokollit Shtesë të Marrëveshjes së Asociimit dhe nuk i ka hequr të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, duke përfshirë kufizimet mbi lidhjet e transportit të drejtpërdrejtë me Qipron. Nuk ka progres në drejtim të normalizimit të marrëdhënieve dypalëshe me Republikën e Qipros.

Sa i përket marrëdhënieve me Greqinë, nuk është përtërirë nxitja për të përmirësuar marrëdhëniet dypalëshe. Kjo ka dhënë disa rezultate pozitive në fushën e tregtisë, arsimit, transportit, energjisë, kulturës dhe mjedisit. Bisedimet dypalëshe paraprake janë intensifikuar për kontestet kufitare. Një numër i konsiderueshëm ankesash zyrtare kanë arritur nga Greqia në lidhje me shkeljet e vazhdueshme të hapësirës së saj ajrore nga Turqia, duke përfshirë fluturimet mbi ishujt Grekë. Greqia gjithashtu ka ankesa për shkelje të ujërave territoriale të saj.

BE-ja dhe Turqia kanë mbajtur një dialog në fusha të interesit të përbashkët në Ballkanin Perëndimor. Turqia mori një numër të iniciativave në rajon, duke përfshirë bisedimet trepalëshe me Serbinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Marrëdhëniet me Bullgarinë mbeten pozitive.

Ekonomia turke u godit rëndë nga kriza globale financiare, por shpejt rivendosi humbjet e saj, pasi ajo ka filluar rritje të gjithanshme me ritme të fuqishme që prej tremujorit të dytë të vitit 2009. Buxheti i shtetit dhe banka qendrore kanë dhënë me sukses përkrahje të konsiderueshme për kërkesën e përgjithshme, veçanërisht me anë të një lehtësimi domethënës të qëndrimit fiskal dhe monetar. Normat e larta të rritjes janë të shoqëruara me shpejtësi të zgjerimit të tregtisë dhe deficite të llogarive rrjedhëse, papunësia ka rënë, edhe pse ende është më e lartë krahasuar me nivelet e para krizës, dhe ekziston rritje e presioneve inflacioniste. Strategjia e daljes nga politikat ndërhyrëse të krizës përqendrohet në arritje të rritjes së fuqishme, të qëndrueshme dhe të balancuar. Hartimi i një rregulli fiskal është përfunduar dhe ka mundësi të konsiderueshme për përmirësimin e performancës fiskale me kalimin e kohës. Megjithatë, miratimi i tij nga Kuvendi është vonuar. Progresi në lidhje me reformat strukturore ka qenë i përzier, por normat më të

ulëta reale të interesit dhe bazat më të forta ekonomike duhet të sigurojnë hapësirë për një përshpejtim të reformave strukturore.

Sa i përket kriterëve ekonomike, Turqia është një ekonomi funksionale e tregut. Ajo duhet të jetë në gjendje për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian në afat të mesëm, me kusht që ajo vazhdon zbatimin e plotë të programit të saj të reformës strukturore.

Si pasojë e krizës, konsensusi mbi bazat e politikës ekonomike është ruajtur. Masat kundër krizës kanë zbutur rënien ekonomike edhe pse kanë rritur deficitin fiskal të Turqisë dhe stokun e borxhit. Ato janë duke u ndarë në faza gradualisht. Një tërheqje me kohë, e synuar dhe e bazuar mirë e stimulimeve mbetet sfida për të maksimizuar përfitimet nga vitet e mëparshme të konsolidimit fiskal dhe të qëndrueshmërisë së përgjithshme afatmesme fiskale, si dhe për të arritur rritje të fortë, të qëndrueshme dhe të balancuar. Privatizimi ka përparuar, edhe pse me një ritëm më të ngadaltë për shkak të ambientit global ekonomik. Sektori financiar ka treguar forcë të jashtëzakonshme për shkak të reformave të mëparme. Investimet janë rritur fuqishëm dhe një përparim i kufizuar është arritur në përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe fizik të vendit. Turqia ishte në gjendje që pjesërisht të diversifikojë tregtinë e saj drejt tregjeve të reja, në këtë mënyrë është lehtësuar në një masë të caktuar ndikimi i krizës. Tregtia dhe integrimi ekonomik me BE-në kanë mbetur të larta.

Megjithatë, pabarazitë e jashtme dhe nevojat për financim janë rritur në masë të konsiderueshme pas vazhdimin të rritjes ekonomike, edhe pse qasja në financa të jashtme ka mbetur çështje jo-problematike. Presionet inflacioniste janë rritur në masë të konsiderueshme, kryesisht për shkak të presioneve që rrjedhin nga inputet e energjisë dhe aktivitetet e gjallëruara ekonomike. Arritja e një progresi më të madh të transparencës fiskale, forcimi i kornizës që synon inflacionin dhe ruajtja e stabilitetit financiar mbeten kushte kyçe për të minimizuar rrezikun e një skenari *bum-bust*. Shkalla e papunësisë mbetet më e lartë se nivelet e para-krizës, faktorët demografik pritet të mbajnë papunësinë lartë në vitet e ardhshme. Kapaciteti i ulët për të krijuar vende të reja pune është qartë i lidhur me mospërputhjen e aftësive ndërmjet kërkesës dhe furnizimit të vendeve të punës, si dhe mbi-rregullimin e tregut të punës. Ka pengesa për dalje nga tregu, dhe procedurat e falimentimit janë relativisht të rënda. Kriza ka komplikuar edhe më tej qasjen e NVM-ve në financa. Mjedisi ligjor, dhe në veçanti procedurat gjyqësore vazhdojnë të paraqesin sfida praktike dhe pengesa për një mjedis më të mirë të biznesit. Rregullimi i tanishëm i tregut të produktit dhe mungesa të vazhdueshme të transparencës në shpërndarjen e ndihmave shtetërore nuk janë të favorshme për përmirësimin e klimës së biznesit. Ekonomia joformale mbetet një sfida e rëndësishme.

Turqia ka vazhduar përmirësimin e aftësisë së saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Përparimi, në disa raste i pabarabartë, është arritur në shumë fusha. Nënshtrimi është avancuar në fusha të caktuara, të tilla si lëvizja e lirë e mallrave, të drejtat e pronës intelektuale, politika e anti-trustit, energjia, politikat e ndërmarrjeve dhe industriale, mbrojtja e konsumatorit, statistikat, rrjetet Trans-Evropiane, si dhe shkenca dhe hulumtimi. Përpjekjet duhet të vazhdojnë të ndjekin nënshtrimin në fusha të tilla si mjedisi, ligji i Shoqërive tregtare, prokurimi publik dhe e drejta e themelimit si dhe e lirisë për të ofruar shërbime. Sa i përket Bashkimit Doganor, nënshtrimi duhet të përfundojë. Disa pengesa të cilat kanë mbetur të pazgjdhura për një kohë të gjatë, siç janë kontrollet e vlerësimeve të konformitetit, importi dhe eksporti i kërkesave të licencimit, zbatimi efikas i DPI-ve, kërkesat për regjistrimin e produkteve të reja farmaceutike dhe trajtimi tatimor diskriminues. Është thelbësore që Turqia plotësisht të implementojë

Bashkimin Doganor dhe të heq një numër të madh të pengesave që ndikojnë në produktet e BE-së që janë në qarkullim të lirë. Për shumicën e fushave është e rëndësishme që Turqia të përmirësojë kapacitetin e saj administrativ për t'u përballuar me *acquis*.

Sa i përket lëvizjes së lirë të mallrave nënshtrimi legjislativ është mjaft i avancuar, por një përparim i kufizuar mund të raportohet. Barrierat teknike të tregtisë vazhdojnë të ekzistojnë dhe vështirësojnë qarkullimin e lirë të mallrave ndërsa janë shtuar barrierat e reja. Pak progres është arritur në fushën e lirisë së lëvizjes për punëtorët, gjë për të cilën nënshtrimi është në një fazë të hershme. Nënshtrimi në fusha të së drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime është në një fazë të hershme. Progres shumë i kufizuar mund të raportohet sa i përket njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale. Progres nuk është shënuar fare në fushat e shërbimeve dhe të themelimit. Për lëvizjen e lirë të kapitalit është arritur progres, në veçanti për nënshtrimin ndaj *acquis* në fushën e luftës kundër pastrimit të parave. Korniza ligjore kundër financimit të terrorizmit është ende e paplotë. Turqia nuk ka arritur përparim në lëvizjen e kapitalit dhe të pagesave ose në sistemet e pagesave.

Disa përparime mund të raportohen në fushën e prokurimit publik, në veçanti në kapacitetet institucionale dhe administrative. Strategjia e hyrjes duhet të miratohet dhe Turqia duhet të harmonizojë legjislacionin e saj të mëtejshëm, veçanërisht në shërbimet komunale, koncesionet dhe partneritetet publiko-private. Progres i kufizuar mund të vërehet në ligjin e shoqërive tregtare. Kodi i ri ekonomik nuk është miratuar. Kapaciteti administrativ ka nevojë për përfundim të mëtejshëm dhe ende nuk është vendosur korniza ligjore dhe institucionale për auditim. Nënshtrimi ndaj të drejtës së pronës intelektuale është relativisht i përparuar. Marrëveshja e Turqisë për të krijuar dialog mbi të Drejtat e Pronës Intelektuale (DPI) me Komisionin adreson një element kyç të negociatave për anëtarësim. Megjithatë, është në pritje miratimi i legjislacionit të nevojshëm të DPI-së, duke përfshirë dënimet penale zhbindëse. Koordinimi dhe bashkëpunimi mbi DPI-në duhet të përmirësohet.

Sa i përket politikës së konkurrencës, nënshtrimi në fushën e anti-trustit është në një nivel të lartë. Turqia zbaton rregullat e konkurrencës në mënyrë efektive. Në fushën e ndihmës shtetërore, miratimi i një ligji të ndihmës shtetërore përmes krijimit të një autoriteti monitorimi është një hap i rëndësishëm përpara. Tani, ky autoritet monitorimi duhet të bëhet operacional sa më shpejt që është e mundur.

Ka pasur pak progres në shërbimet financiare, përderisa autoritetet mbikëqyrëse kanë prezantuar masa tjera të kujdesshme. Në përgjithësi, nënshtrimi i Turqisë ndaj *acquis* mbetet i pjesshëm. Në lidhje me shoqërinë e informacionit dhe mediet në fushën e komunikimit elektronik dhe teknologjive të informacionit punë të rëndësishme janë kryer nga rregullatori i Telekomunikacionit lidhur me zbatimin e rregulloreve. Në fushën e politikës audio-vizuale mund të raportohet progres i caktuar. Megjithatë, disa pengesa për zhvillimin e tregut mbeten për t'u siguruar. Legjislacioni mbi komunikimin elektronik, shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe politikat audio-vizuale kërkojnë rregullim të mëtejshëm.

Në bujqësi dhe zhvillim rural ka pasur progres të kufizuar. Mbështetja e politikave bujqësore ka rezultuar në tranzicion të kufizuar në drejtim të Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB). Hapat fillestarë janë ndërmarrë për zhvillimin e një Administrimi të Integruar dhe të Sistemit të Kontrollit. Megjithatë, Turqia arriti të heqë pengesat tërësisht teknike të tregtisë në produktet e gjedhit. Vonesat në afatet kohore për akreditimin e strukturave IPARD gjithashtu paraqesin një mangësi. Progres i mëtejshëm është i nevojshëm për statistikën bujqësore, rrjetin e të dhënave mbi llogarimbajtjen e fermave, politika të cilësisë dhe bujqësi organike. Sa i përket sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare, përparimet në politika

janë arritur sidomos përmes miratimit të legjislacionit të kuadrit kryesor. Strategjia e re e nënshtrimit duhet të lehtësojë transpozimin dhe zbatimin e *acquis* përkatëse. Sa i përket peshkimit, një progres i caktuar është arritur në menaxhimin, inspektimin dhe kontrollimin e resurseve dhe flotave, si dhe në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Progres i mëtëjshëm duhet arritur në nënshtrimet ligjore, strukturat administrative dhe të politikave të tregut, veprime strukturore dhe të ndihmës shtetërore.

Disa përparime janë arritur në drejtimin e sektorit të transportit. Nënshtrimi ligjor ka arritur një nivel të përparuar në sektorët e detarisë, aviacionit dhe të rrugëve. Asnjë progres nuk është arritur në lidhje me hapjen dhe sigurinë e tregut hekurudhor. Mungesa e komunikimit midis qendrave të trafikut ajror në Turqi dhe Republikën e Qipros vazhdon të komprometojë rëndë sigurinë ajrore. Në sektorin detar nuk është arritur përparim për t'u bërë palë në konventat ndërkombëtare. Kapacitetet administrative dhe të zbatimit mbeten të kufizuara.

Në sektorin e energjisë ka pasur progres të mirë në nënshtrimin ndaj energjisë, energjisë ripërtëritëse dhe efikasitetit të energjisë, si dhe në sigurinë e furnizimit. Përpjekje të mëtëjshme janë të nevojshme në fushën e gazit natyror, energjisë bërthamore, sigurisë bërthamore, mbrojtjes nga rrezatimi dhe ndihmës shtetërore.

Sa i përket tatueshmërisë, ka pasur pak progres në nënshtrim, veçanërisht në drejtim të eliminimit të praktikave diskriminuese mbi duhanin. Megjithatë, rritja e akcizës për pijet alkoolike është në kundërshtim me planin e veprimit të akorduar me Komisionin, një kërkesë kyçe për të arritur progres të mëtëjshëm në negociatat e pranimit. Përpjekjet për përforcimin e administratës tatimore, luftën kundër ekonomisë joformale dhe rritjen e nënshtrimit vullnetar janë ndjekur. Vështirë se ndonjë përparim mund të raportohet për tatimet direkte dhe indirekte.

Në politikën ekonomike dhe monetare përgatitjet janë në rrugë të duhur. Përpjekje janë të nevojshme për nënshtrim të mëtëjshëm. Kjo në veçanti ka të bëjë me pavarësinë e plotë të Bankës Qendrore dhe ndalimin e qasjes së privilegjuar të sektorit publik për institucionet financiare.

Ka pasur progres të mirë në fushën e statistikave, ku niveli i përgjithshëm i nënshtrimit është avancuar. TurkStat ka përmirësuar më tej koordinimin e sistemit statistikor. Progres i mirë është arritur në regjistrin e bizneseve dhe në statistikave të sektorit. Nevojitet më tepër harmonizim në llogari kombëtare dhe në statistikave bujqësore.

Turqia ka arritur disa përparime në përafrim me *acquis* në fushën e politikës sociale dhe të punësimit. Pakoja e ndryshimeve kushtetuese ka sjell përmirësime të rëndësishme në fushën e dialogut social në sektorin publik dhe hap rrugën për diskriminim pozitiv ndaj grave, fëmijëve, personave të moshuar dhe me aftësi të kufizuara. Megjithatë, nënshtrimi i përgjithshëm mbetet i kufizuar dhe kapacitetet administrative duhet të forcohen. Një reformë për të arritur të drejta të plota sindikale në përputhje me standardet e BE-së dhe konventat e ONP-së është ende në pritje. Ekzistojnë një sërë shqetësimesh në lidhje me punën e padeklaruar, normat e ulëta të punësimit të femrave, zbatimin e legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë. Gjithashtu mungon një kornizë e përgjithshme politike për luftimin e varfërisë.

Progres i mëtëjshëm është arritur në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale në të cilat niveli i nënshtrimit është i mjaftueshëm. Ky progres ka të bëjë me Strategjinë dhe Planin e Veprimit Industrial, disponueshmërinë më të gjerë të ndërmarrjeve dhe të instrumenteve të politikës industriale si dhe

miratimin e strategjive sektoriale dhe udhërrëfyesit. Përmirësime të kufizuara mund të raportohen në mjedisin e biznesit dhe përpjekjeve të vazhdueshme për monitorim dhe vlerësim.

Progres është arritur në rrjetet trans-evropiane. Në veçanti Turqia ka arritur në një fazë të avancuar në negociatat për të ardhmen e Rrjetit Trans-Evropian të Transportit. Disa përpajime mund të raportohen në rrjetet e energjisë.

Progres, megjithëse i pabarabartë, është arritur në fushën e politikës rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore. Në veçanti, korniza legislative dhe institucionale për zbatimin e komponentëve III dhe IV të IPA-së është finalizuar. Përfshirja e aktorëve nën-nacional në përgatitjen e projektit të tubacionit është përmirësuar. Në nivel kombëtar ka ende nevojë për përmirësim të kapacitetit administrativ të institucioneve të përfshira në zbatimin e fondeve të para-pranimit në mënyrë që të arrihet një përdorim më efikas për të përgatitur edhe Turqinë për përdorimin e fondeve strukturore.

Në përgjithësi, është arritur progres në fushën e gjyqësorit. Miratimi i amendamenteve kushtetuese në përbërjen e Këshillit të Lartë të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është një hap pozitiv. Kjo është gjithashtu e vërtetë për kufizimin e kompetencave të gjykatave ushtarake. Gjatë procesit të përgatitjes dhe miratimit të legjislacionit të aktgjykimit, krijimi i një dialogu efektiv me të gjitha palët e interesuara dhe shoqërinë civile në përgjithësi do të jetë i nevojshëm. Zbatimi i këtyre reformave, në përputhje me standardet evropiane do të jetë vendimtar. Në lidhje me anti-korrupsionin, është arritur progres sa i përket zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit si dhe i një plani të veprimit. Zhvillimi i një organi për të mbikëqyrur dhe monitoruar zbatimin e tyre gjithashtu ka përparuar. Megjithatë, implementimi efektiv është i nevojshëm dhe Turqia duhet të zhvillojë një prapavijë të hetimeve, akuzave dhe dënimeve.

Progresi, megjithëse i pabarabartë, është arritur në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Progres thelbësor është arritur në drejtim të finalizimit të negociatave mbi një marrëveshje të riatdhesimit BE-Turqi. Nevojitet një marrëveshje e qartë institucionale dhe burime të mjaftueshme për migracion dhe azil. Disa përpajime mund të raportohen në fushën e drogës dhe të bashkëpunimit të doganave. Progres i kufizuar mund të raportohet në fushën e kufijve të jashtëm dhe të Shengenit si dhe kimit të organizuar dhe terrorizmit. Pak progres është arritur në fushën e politikës së vizave. Nuk është raportuar progres mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështje penale dhe civile. Në përgjithësi, miratimi urgjent i projektligjeve dhe ratifikimi i marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare është i rëndësishëm.

Turqia është e përgatitur mirë në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor si dhe përparim i mirë është arritur drejt integritit në Zonën Evropiane të Kërkimit. Në përgjithësi, pjesëmarrja e Turqisë dhe shkalla e suksesit në Programet kornizë janë në rritje. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të mbajtur këto ritme nëpërmjet Programit kornizë 7 për Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik (PK7).

Në arsim dhe kulturë ka pasur pak progres, në veçanti në fushën e arsimit. Regjistrimi i përgjithshëm shkollor ka vazhduar të rritet me përmirësime të vogla në lidhje me çështje gjinore, dhe Turqia ka vazhduar të përmirësojë punën e saj kundër standardeve të përbashkëta të BE-së. Ka pasur pak progres në fushën e kulturës, por nuk ka përparim në përafrimin legjislativ.

Lidhur me mjedisin, është shënuar progres në përafrimin e mëtejshëm. Turqia ka arritur përparim të mirë në menaxhimin e mbeturinave, ndërsa një përparim i kufizuar mund të raportohet për legjislacionin horizontal, cilësinë e ajrit dhe të ujit, ndotjen industriale, kimike dhe kapacitetet administrative.

Megjithatë, Turqia ka arritur progres shumë të kufizuar sa i përket ndryshimit të klimës dhe nuk ka përparim në fushën e mbrojtjes së natyrës. Turqia ka arritur përparim në kapacitete administrative duke vendosur mekanizma koordinues. Investimet duhet të rriten.

Është arritur progres në përafrimin me *acquis* të mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit. Megjithatë, kapacitetet administrative duhet të rriten. Më shumë përpjekje janë të nevojshme për mbrojtjen e konsumatorit, për të forcuar lëvizjen e konsumatorit dhe për të siguruar zbatimin e duhur. Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve mbetet i dobët. Ka progres të mirë në nivelin e nënshtrimit sa i përket shëndetit publik. Megjithatë, zbatimi mbetet i pamjaftueshëm.

Në dogana niveli i nënshtrimit është i lartë, si në lidhje me legjislacionin ashtu edhe me kapacitetet administrative. Megjithatë, dyqanet pa taksa në pikat e hyrjes dhe kërkesat për paraqitje të informatave mbi origjinën para dhënies së lejes nga doganat për importuesit e produkteve që i nënshtrohen qarkullimit të lirë në BE janë në kundërshtim me *acquis*. Legjislacioni mbi zonat e lira, mbikëqyrja dhe kuotat e tarifave edhe më tej kanë nevojë për nënshtrim. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për përmirësimin e kontrolleve të bazuara në rrezik dhe të procedurave të thjeshtuara për të lehtësuar tregtinë e ligjshme dhe për të reduktuar kontrollet fizike. Zotimet për të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë intelektuale dhe luftën kundër mallrave të falsifikuara duhet të respektohen.

Turqia ka arritur një nivel të lartë të nënshtrimit në fushën e marrëdhënieve të jashtme. Megjithatë, mbetet punë për t'u bërë në shumë fusha, në veçanti në sistemin e përgjithshëm të preferencave në lidhje me mbulimin e saj gjeografik.

Nënshtrimi ndaj politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së ka vazhduar. Turqia ka kërkuar dialog dhe konsultim me BE-në për çështje të politikës së jashtme. Ajo nuk është rreshtuar me BE-në në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për sanksione të tjera kundër Iranit. Turqia ka bërë përpjekje për përmirësimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me vendet fqinje të tilla si Iraku, duke përfshirë qeverinë rajonale Kurde, dhe Sirinë. Marrëdhëniet me Izraelin në mënyrë të konsiderueshme janë përkeqësuar pas incidentit me flotën e anijeve të Gazës. Protokollet e nënshkruara me Armeninë për të normalizuar marrëdhëniet ende nuk janë ratifikuar.

Turqia është duke kontribuar në masë substanciale për Politikën e Përbashkët për Siguri dhe Mbrojtje (PPSM) dhe është duke kërkuar përfshirje më të madhe në aktivitete të PPSM-së. Çështja e bashkëpunimit BE-NATO që përfshin të gjitha shtetet anëtare të BE-së përtej 'aranzhimeve Berlin plus' mbetet për t'u zgjidhur. Turqia nuk i nënshtrohet qëndrimit të BE për anëtarësimin e marrëveshjes Uassenaar.

Progres i kufizuar mund të raportohet në fushën e kontrollit financiar që tashmë tregon një nivel mjaft të avancuar të nënshtrimit. Legjislacioni për implementimin e Ligjit të PFMC-së është vendosur, ndërsa dokumenti i politikave të KBFP-së dhe plani i veprimit kanë nevojë për rishikim. Ende nuk është miratuar ligji i rishikuar mbi Gjykatën Turke të llogarive, që duhet të përshtatë auditimin e jashtëm në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare. AFCOS-i Turk nuk ka evoluar akoma në rrjet operativ. Struktura të përhershme janë të nevojshme për kontakte me Komisionin lidhur me mbrojtjen e euros kundër falsifikimit. Nënshtrimi i Turqisë ndaj parimeve dhe institucioneve bazë të *acquis* në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore është avancuar mirë edhe pse gatishmëria në fushën e *acquis* mbi resurset vetanake është në një fazë të hershme.

Islanda

Raporti i parë i progresit në Islandë konfirmon vlerësimin e opinionit të Komisionit të shkurtit të vitit 2010 që Islanda plotëson kriteret politike. Islanda është një demokraci funksionale dhe me institucione të fuqishme që kanë tradita të rrënjosura thellë të demokracisë përfaqësuese. Sistemi gjyqësor i vendit është mirë i vendosur dhe gjyqësori është i një standardi të lartë. Sa i përket të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së pakicave, Islanda vazhdon të mbrojë të drejtat themelore dhe për të siguruar një nivel të lartë të bashkëpunimit me mekanizmat ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, edhe opinionit ka identifikuar një sërë të metash. Raporti konfirmon se Islanda ka marrë disa masa për t'i adresuar ato.

Sa i përket kriterëve politike, qeveria e koalicionit ka mbetur stabile gjatë periudhës raportuese përkundër sfondit të vështirë ekonomik dhe pikëpamjeve të papajtueshme midis forcave politike dhe popullsisë Islandeze lidhur me perspektivën e pranimit në BE. Megjithatë, mbështetja për procesin e pranimit është rritur në fund të periudhës raportuese me një shumicë në favor të ndërmarrjes së negociatave për anëtarësim.

Progres i caktuar është arritur në identifikimin e aktorëve përgjegjës për rrëzimin e sistemit bankar Islandez dhe në trajtimin e pasojave të saja politike dhe administrative. Ky është një tipar i dukshëm i funksionimit të institucioneve demokratike Islandeze. Raporti i Komisionit të Posaçëm të pavarur për hetime, i botuar në prill të vitit 2010, ka shpie në një sërë rekomandimesh për të stabilizuar sistemin financiar dhe për të rritur mbikëqyrjen e tij. Paralelisht, Zyra e Prokurorit Special ka vazhduar të kryej një numër të hetimeve si pasojë e krizës financiare.

Progres i mirë është arritur për të përmirësuar më tej kornizën ligjore në lidhje me konfliktin e interesave dhe financimin e partive politike. Akti gjyqësor është amenduar në mënyrë që të ndryshohen rregullat për emërimin e gjyqtarëve me qëllim të forcimit të mëtejshëm të pavarësisë së gjyqësorit. Është duke u zhvilluar zbatimi i rekomandimeve të Komisionit të Hetimeve Speciale, është duke u zhvilluar korniza ligjore e ndryshuar lidhur me konfliktin e interesave, si dhe procedurat e rishikuara për emërimet në gjyqësor. Ndikimi i këtyre masave duhet të rishikohet në një fazë të mëvonshme.

Si qeveria ashtu edhe parlamenti kanë vazhduar të funksionojnë mirë. Qeveria ndërmori hapa për forcimin e mëtejshëm të administratës publike. Komitetet e bisedimeve janë ngarkuar me koordinimin e përgjithshëm të procesit të punës së pranimit pa probleme.

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e Këshillit të Evropës mbetet për t'u ratifikuar.

Ekonomia e Islandës ka hyrë në një rënie të thellë dhe të gjatë, rrjedhimisht mbetet e pasigurt perspektiva madje edhe për ndonjë rikuperim të kufizuar. Papunësia është rritur dhe financat publike kanë pësuar një rënie të theksuar me deficite të larta fiskale dhe një rritje të ndjeshme të borxhit tashmë të lartë publik. Nga ana tjetër, inflacioni ka qenë gradual dhe është duke u ulur në mënyrë të qëndrueshme. Një përzierje e kujdesshme e politikës makroekonomike fokusohet në një normë të stabilizimit të këmbimit dhe të konsolidimit fiskal. Një sektor financiar ende jofunksional dhe disbalancet e përhapura të bilanceve të gjendjes së sektorit privat si dhe borxhet shumë të larta të jashtme paraqesin sfidat kryesore. Programi i FMN-së ka qenë në rrugë të mbarë.

Sa i përket kriterëve ekonomike, Islanda mund të konsiderohet një ekonomi tregu funksionale. Megjithatë, dobësitë e sektorit financiar dhe kufizimet e lëvizjes së kapitalit ende pengojnë ndarjen efikase të burimeve. Islanda mund të rifitojë aftësinë për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda tregut të vetëm në afatin e mesëm, me kusht që ajo të vazhdojë të adresojë dobësitë aktuale strukturore nëpërmjet politikave të përshtatshme makroekonomike dhe reformave strukturore.

Përgjigja përmes politikave kryesisht ka qenë e përshtatshme dhe mbështetëse për të rivendosur një shkallë më të lartë të stabilitetit makroekonomik, megjithëse perspektiva për një rifillim të shpejtë të rritjes ekonomike mbetet e pasigurt. Konsolidimi fiskal ka vazhduar; deficitet fiskale kanë filluar të bien dhe borxhi publik është ristrukturuar me qëllim të zbutjes së profilit të saj dhe reduktimit të rreziqeve të kursit të këmbimit. Inflacioni ka rënë dhe normat kyçe të interesit të politikës janë ulur gradualisht. Një suficit paksa më i lartë tregtar ka mbështetur një mirënjohjen të lehtë të valutës vendore. Rezervat valutore të këmbimit janë rritur, por kjo është arritur kryesisht në bazë të financimit të jashtëm zyrtar. Tregu i punës ka mbetur me norma fleksibile dhe pjesëmarrje relativisht të lartë. Vendi gëzon infrastrukturë të mirë bazë, burime të bollshme natyrore, dhe një popullatë të arsimuar mirë.

Sidoqoftë, ekonomia është ende duke luftuar me pasojat e rënies ekonomike. Financat publike mbeten të ballafaquara me sfidën për të zbatuar ulje të rënda të shpenzimeve dhe përballjeve me detyrime të konsiderueshme kontingjente të ndërlidhura me vështirësitë e sektorit financiar, me një nivel të përgjithshëm bruto të borxhit të qeverisë prej pothuajse 90% të BPV-së. Pa marrë parasysh korrigjimet e pagave reale, papunësia është rritur dukshëm. Rindërtimi i sektorit bankar ka përparuar, por bankat janë duke vuajtur nga cilësia e dobët e aseteve e cila cenon aftësinë e tyre për të financuar ekonominë. Disbalancet e përhapura të bilanceve të gjendjes së sektorit privat paraqesin kërcënim për stabilitetin financiar. Përveç kësaj, Vendimet e gjykatës supreme përmes së cilit janë shpallur të paligjshme kreditë e indeksuara me kurse të huaja valutore kanë krijuar pasiguri, kryesisht në trajtimin e kredive të sektorit të korporatave. Kjo mund të dëmtojë më tej situatën financiare të bankave vendore pasi ato do të duhet të marrin përsipër barrën shtesë për të siguruar huamarrësit. Procesi i ristrukturimit të borxhit të sektorit të përbashkët ka përparuar ngadalë dhe barra e borxhit është duke kufizuar fushëveprimin për investime të reja, gjë që pengon rikuperimin. Investimet në projektet madhore të infrastrukturës aktualisht ende janë nën shqyrtim për shkak të diskutimeve politike dhe mungesës së fondeve. Mjedisi i biznesit ka mbetur i penguar nga kontrollet e kapitalit, norma relativisht të larta të interesit dhe qasje të vështirë në financim, sidomos për NVM-të.

Në këtë raport të parë të progresit, aftësia e Islandës për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit është vlerësuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen e saj në Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE) dhe duke marrë parasysh përjashtimet e dhëna në bazë të ZEE-së. Niveli i përgjithshëm i gatishmërisë për të përmbushur kërkesat e *acquis* së BE-së mbetet i mirë, në veçanti për shkak të pjesëmarrjes së Islandës në Zonën Ekonomike Evropiane.

Mosmarrëveshja *Icesave* mbetet e pazgjidhur. Projekt-ligji që autorizon një garanci shtetërore mbi kreditë e dhëna nga qeveritë e Mbretërisë së Bashkuar dhe Holandës për kompensim që kanë dhënë për qytetarët e tyre që kanë mbajtur llogari të kursimit në *Icesave* u refuzua me referendumin e marsit të vitit 2010. Autoriteti mbikëqyrës EFTA (ESA), i ka dërguar një letër njoftimi zyrtare qeverisë së Islandës në maj të vitit 2010, duke ndërmarrë hapin e parë në një procedurë shkeljeje kundër Islandës, kjo është duke argumentuar që Islanda ka shkelur Direktivën mbi garantimin e skemave të depozitave duke i lënë

depozituesit në degët e Holandës dhe të Mbretërisë së Bashkuar të Icesave pa garanci minimale. Komisioni Evropian ndanë analizën ligjore të ESA-së. Përpjekjet e negociatave në mes të përfaqësuesve të tri qeverive ende nuk kanë dhënë ndonjë rezultat.

Përgatitjet për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në afat të mesëm kanë vazhduar në zonat e mbuluara pjesërisht nga ZEE, si dhe në kapituj që nuk mbulohen nga ZEE. Islanda vazhdon t'i nënshtrohet në masë të madhe dhe të zbatohet një pjesë të konsiderueshme të *acquis* në fushat e mbuluara nga ZEE siç janë lëvizja e lirë e mallrave, liria e lëvizjes së punëtorëve, e drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime, lëvizja e lirë e kapitalit, prokurimi publik, ligji i shoqërive tregtare, ligji i pronësisë intelektuale, konkurrenca, shërbimet financiare dhe të shoqërisë së informacionit dhe të medieeve.

Megjithatë, duhet të vazhdojnë përpjekjet për lidhje të mëtejme me *acquis* të BE-së, në veçanti në zonat që nuk mbulohen nga ZEE, dhe për të siguruar zbatimin. Gjithashtu duhet të theksohet që fushat vijuese kanë mundësi të paraqesin sfida në procesin e pranimit: shërbimet financiare, bujqësia dhe zhvillimi rural, peshkimi, lëvizja e lirë e kapitalit si dhe mjedisi.

Përpjekjet e qeverisë për të trajtuar pasojat e krizës ekonomike dhe financiare kanë shpie në shkurtime të konsiderueshme buxhetore. Vëmendje duhet të kushtohet që të mbeten në dispozicion resurse për përgatitje të nevojshme lidhur me procesin e pranimit në BE.

Islanda vazhdon të jetë kryesisht në përputhje me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Megjithatë, disa elemente ende nuk janë siguruar plotësisht sa i përket masave horizontale dhe legjislacionit që është produkt i qasjes së vjetër.

Një nivel i kënaqshëm i nënshtimit është arritur në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve. Përgatitjet për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore mbeten për t'u përfunduar. Legjislacioni për të drejtën e vendosjes së lirisë për të ofruar shërbime është në përgjithësi në përputhje me përjashtimin e shërbimeve postare dhe të direktivave.

Islanda zbaton *acquis* mbi lëvizjen e lirë të kapitalit, me disa përjashtime. Në bashkëpunim të ngushtë me FMN-në, autoritetet islandeze janë angazhuar për të hequr gradualisht kufizimet mbi lëvizjet e kapitalit dhe pagesave. Megjithatë, kufizimet mbi rrjedhën e kapitalit janë vazhduar ndërkohë deri në gusht të vitit 2011; shuma maksimale e valutës së huaj që mund të blihet për të udhëtuar është reduktuar. Ende nevojiten përpjekje të qëndrueshme për të hequr kufizimet ekzistuese në lëvizjet e kapitalit, duke përfshirë investimet e huaja në peshkim.

Islanda ka implementuar pjesën kryesore të *acquis* lidhur me prokurimin publik dhe nënshtimi në përgjithësi është shumë i mirë. Megjithatë, kapacitetet administrative mbetet për t'u zgjeruar më tej për të siguruar zbatimin e duhur të politikave të prokurimit publik.

Progres i mirë është arritur me ligjin mbi shoqëritë tregtare. Megjithatë, përafrimi i plotë me standardet e kontabilitetit nuk është arritur. Islanda vazhdon të jetë kryesisht në përputhje me *acquis* në fushën e së drejtës së pronës intelektuale, por një politikë gjithëpërfshirëse e zbatimit është e nevojshme.

Islanda ka arritur një nivel të lartë të nënshtimit në lidhje me *acquis* të konkurrencës dhe strukturat përkatëse administrative janë vendosur. Masat e ndihmës shtetërore të marra si përgjigje ndaj krizës financiare mbeten për t'u vlerësuar.

Zbatimi i plotë i *acquis* në shërbimet financiare, së bashku me një kuadër të përforcuar mbikëqyrës mbetet për t'u siguruar. Zbatimit nuk është i plotë në disa fusha kyçe, duke përfshirë tregjet e sigurimeve dhe të letrave me vlerë.

Islanda ka arritur tashmë një nivel të lartë të nënshtrimit dhe zbatimit të një pjesë të konsiderueshme të *acquis* në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medieve. Megjithatë, mbeten për t'u zbatuar dispozitat e reformës së telekomit, direktiva mbi shërbimet e medieve audio-vizuale dhe politikat që rrjedhin nga miratimi i fundit i Agjendës digjitale Evropiane.

Përgatitjet në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural ende nuk kanë filluar. Krijimi i strukturave për të adresuar ndryshimet në administratë, në veçanti në ngritjen e një agjencie paguese në përputhje me BE-në si dhe sistemi i integruar i administratës dhe kontrollit (IACS) mbeten për t'u adresuar.

Disa përparime janë arritur në sigurinë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare, në veçanti në transpozimin e legjislacionit të sigurisë së përgjithshme të ushqimit. Megjithatë, nevojiten përpjekje për të forcuar kapacitetet administrative dhe të laboratorëve. Dallime të konsiderueshme nga sistemi i BE-së mbeten sa i përket pakos higjienike, produktet për mbrojtjen e bimëve, ushqimit të ri dhe ushqimit të modifikuar gjenetikisht.

Asnjë zhvillim i ri nuk mund të raportohet në përafrimin me politikën e përbashkët të BE-së lidhur me peshkimin. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar tregut të brendshëm të *acquis* në lidhje me të drejtën e vendosjes, të lirisë për të ofruar shërbime, si dhe lëvizjen e lirë të kapitalit në sektorin e peshkimit dhe të përpunimit të produkteve, ku kufizimet nuk janë në përputhje me *acquis*. Mekanizmat për zbatimin dhe kontrollin që mbështesin masat e Komunitetit ende duhet ngritur.

Sa i përket transportit, kufizimet për investime të huaja në transport ajror dhe detar mbeten në fuqi. Islanda ka arritur tashmë një nivel të lartë të nënshtrimit dhe zbatimit të një pjesë të konsiderueshme të *acquis* në fushën e energjisë. Harmonizimi ndaj *acquis* në fushën e rezervave të naftës, pavarësisë së autoritetit rregullativ dhe efikasitetit të energjisë është avancuar mesatarisht.

Ka zhvillime legjislative që mund të raportohen në fushën e tatimeve. Islanda ka arritur tashmë një nivel të mirë të kapaciteteve administrative. Megjithatë, zyrat ndërlidhëse dhe ndërlidhshmëria e TI-së ende duhet të vendosen.

Islanda tashmë është në përputhje të konsiderueshme me *acquis* në politikën ekonomike dhe monetare. Megjithatë, ende ekzistojnë disa mangësi, në veçanti lidhur me pavarësinë e plotë të bankës qendrore dhe ndalimin e financimit monetar të sektorit publik.

Sa i përket statistikave, disponueshmëria e të dhënave statistikore në përputhje me metodologjinë e BE-së ka nevojë të përmirësohet veçanërisht lidhur me statistikat biznesore, makroekonomike dhe bujqësore. Zbatimi i operacioneve të mëdha të planifikuara statistikore siç është studimi i strukturës së fermave si dhe regjistrimi i popullsisë dhe banesave nuk garantohen pasi që resurset njerëzore dhe financiare janë zvogëluar.

Islanda tashmë zbaton pjesë të konsiderueshme të *acquis* në lidhje me politikat sociale dhe punësimin. Megjithatë, një strategji gjithëpërfshirëse e punësimit mbetet për t'u përpunuar.

Kundrejt prapavijës së vështirë ekonomike, përgatitjet në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale janë në rrugë të duhur. Qasja më e mirë në financa për NVM-të paraqet shqetësim. Përputhshmëria me standardet e BE-së për rrjetet trans-evropiane është e lartë.

Sa i përket politikave rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore, Islanda është në një fazë të hershme të përgatitjeve për zbatimin e instrumenteve të politikës së kohezionit. Një analizë e duhur e nevojave, përfshirë edhe identifikimin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e politikës së kohezionit, mbeten për t'u kryer.

Gjyqësori i Islandës është i një standardi të lartë dhe Islanda siguron një nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave themelore. Islanda ka marrë disa masa për të adresuar mangësitë e identifikuara në Opinionin e shkurtit të vitit 2010 në veçanti në lidhje me procedurën e emërimeve gjyqësore dhe konfliktin e interesit. Megjithatë, zbatimi i këtyre rekomandimeve duhet të vlerësohet më tej. Legjislacioni për të drejtat e qytetarëve dhe mbrojtjen e të dhënave nuk është ende në përputhje me *acquis*.

Islanda i nënshtrohet Marrëveshjes së Shengenit dhe ka arritur një nivel të avancuar të përafrimit me *acquis* në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë. Legjislacioni në disa zona mbetet plotësisht në përputhje me *acquis* dhe instrumentet relevante ndërkombëtare duhet të nënshkruhen apo ratifikohen.

Islanda është avancuar mirë për pranim në BE dhe integrim në Zonën Evropiane të Kërkimit. Përputhshmëria me standardet e BE-së në fushën e arsimit dhe të kulturës është e lartë. Islanda ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive në Metodën e Hapur të Koordinimit në arsim, si dhe në programet e komunitetit, duke përfshirë programet e mësimit gjatë tërë jetës, Rinisë në veprim dhe Erasmus Mundus.

Politika Mjedisore në Islandë në një masë të madhe është në linjë me *acquis* të BE-së nëpërmjet marrëveshjes së ZEE-së kurse përparim i mëtejshëm mund të raportohet në fushën e cilësisë së ajrit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, përputhja me ndryshimin e klimës, si dhe *acquis* për mbrojtje të natyrës, në veçanti sa i përket mbrojtjes së balenave, fokave dhe shpezëve të egra, si dhe ruajtja e habitateve natyrore si dhe e faunës dhe florës së egër mbeten për t'u arritur. Ratifikimi i marrëveshjeve kryesore shumëpalëshe mjedisore është në pritje.

Islanda ka implementuar një pjesë të rëndësishme të *acquis* në fushën e shëndetit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Megjithatë, transpozimi i *acquis* të reja në fushën e mbrojtjes së konsumatorit mbetet për t'u përfunduar dhe procesimi i njoftimeve RAPEX duhet të përputhet edhe më tej.

Legjislacionin doganor i Islandës është në një masë të madhe në përputhje me *acquis*. Përafrim i rëndësishëm i mëtejshëm është i nevojshëm në legjislacionin dhe praktikën e dyqaneve të liruar nga tatimet. Ndërlidhshmëria me sistemet e TI-së të BE-së duhet të sigurohet.

Disa përparime janë arritur në fushën e marrëdhënieve të jashtme. Islanda ka filluar përgatitjet për të vlerësuar detyrimet e saj në lidhje me nevojën për të ndryshuar ose hequr dorë nga marrëveshjet e veta ndërkombëtare, por kanë filluar përgatitjet në lidhje me politikën e përbashkët tregtare. Mbetet që të ndërmerren masa për t'u siguruar që Ndihma Zyrtare Zhvillimore e Islandës të mos zvogëlohet më tej. Islanda ka arritur përparim të mirë dhe një nivel të përgjithshëm të mirë të nënshtrimit në fushën e sigurisë së jashtme, dhe politikës së mbrojtjes.

Sa i përket kontrollit financiar, një vlerësim *gap* duhet të kryhet në fushat e menaxhimit financiar dhe të

sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për të marrë parasysh standardet e pranuar ndërkombëtare në fuqi në BE. Përgatitjet në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së mbeten për t'u rritur. Ka pasur pak progres në fushën e dispozitave financiare dhe buxhetore pasi Islanda ka filluar të identifikojë nënshtimet e kërkuara sipas *acquis*.